

Shtator 2018
Numri: 126
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro



*O Zot, mos na i
verbëro zemrat!..*



revistaetika



progresibotime

TË
RINJ

*Shtëpia botuese Progresi
vjen me 6 libra të rinj, të cilët
do të ushqejnë botën tonë shpirtërore
dhe do t'i japin drejtim jetës sonë
individuale dhe shoqërore.*


Një këshillë
1001 mësimë
350 Lekë
3 Euro



Si edukonte
Ai (s.a.v.s.)
150 Lekë
1 Euro



101 Parime
në shërbim
200 Lekë
1.5 Euro



Shoqetësimi
për brezat
200 Lekë
1.5 Euro



Udhëtimi
drejt Zotit
200 Lekë
1.5 Euro



Shërbimi
200 Lekë
1.5 Euro

Shtator 2018

VITI: XII

NUMRI: 126

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardan Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 45 639 143

Prishtinë; Kosovë

Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Maqedonija

Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Nëse zemra juaj është e shëndetshme, ju do të keni kujdes ndaj "haramëve", të cilat janë "vendi i mbrojtur i Allahut". Pra, nuk do ta ngacmoni atë zonë, duke u përpjekur të nxirrni ndonjë "hallall" dhe nuk do të mundoheni të kullotni nefsin tuaj në afërsi të haramëve. Është e qartë se, nëse nefsin e kullotni aty me syrin, veshin, gjuhën-shijen, dorën dhe këmbën tuaj, zemra juaj do të rrëshqasë në zonat e mjegullta dhe do të fillojë t'i zbehet gjallëria, ndjesia dhe kujdesi. Në këtë mënyrë, ajo fillon të mos e shohë haramin si haram dhe nuk përpiket më të tregohet e kujdesshme në lidhje me hallallet. Për rrjedhojë, edhe harmonia e fesë në jetën tuaj do të prishet.

Fakti që Zoti ynë ka lejuar ekzistencën e një zone të tillë, është për shkak që ta bëjë njeriun të jetë gjithmonë vigjilent. Zemra, e cila është epiqendra e besimit, është edhe qendra e personalitetit e cila mund të marrë drejtime të ndryshme. Besimi nuk pranon vajtje-ardhje, por është një lidhje e cila duhet të jetë në vigjilencë çdo moment. Po filloi njëherë rrëshqitja, nuk dihet se ku do të ndalet.

Nëse vihet re me kujdes, në ajet urdhërohet: "...Mos lejo që zemrat tona të devijojnë (nga e vërteta), pasi na ke udhëzuar në rrugën e drejtë!..". Kjo do të thotë se, devijimi apo rrëshqitja e zemrës, është një rrezik për besimtarin. Besimi është një çështje e orientimit të zemrës. Pra, do të thotë se, në besim, koordinatat e zemrës duhet të qartësohen plotësisht. Për këtë arsye, formula e shehadetit fillon me një "mohim të përgjithshëm", duke thënë, "La ilahe / nuk ka zot". Pra, para se zemra të arrijë në fazën "il-lallah / përveç Allahut", duhet të eliminojë çdo gjë që tjetër që i paraqitet si zot. Jo, jo, jo... "Vetëm Allahu është!" Në fakt, mbase të gjitha "ato që nuk janë", duhet të shihen me vetëdije. Për këtë arsye, në Islam ka lindur një shkollë e veçantë që jep mësimin "e pastrimit të zemrës prej çdo gjëje tjetër jashtë Allahut".

Mbase në këtë kapitull, duhet të kujtojmë kujdesin që duhet të tregojmë në lidhje me "orientimin e rrugës", e cila na përsëritet çdo ditë me dhjetëra herë në suren Fatiha: "Udhëzoni në rrugën e drejtë. Në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi e jo në të atyre që kanë shkaktuar zemërimin Tënd, e as në të atyre që janë të humbur!"

Përpara besimtarit qëndron një rrugë, që cilësohet si "rrugë e drejtë". Ajo është "rruga muhkem/e qartë". Ajo është një rrugë ndryshe nga rrugët e atyre që "kanë shkaktuar zemërimin hyjnor" dhe "atyre që kanë devijuar". Vallë cila rrugë shkakton zemërimin hyjnor dhe cila rrugë është e devijuar? Komentuesit tanë të Kuranit, e kanë konsideruar këtë, si "rrugën e ithtarëve të librit".

Është me dobi t'i hedhim një sy edhe këtij interpretimi, sepse, kur themi "ithtarët e librit", e kemi fjalën për librat hyjnorë që u kanë zbritur njerëzve para Kuranit dhe sipas këtij ajeti, animi për nga ata, kuptohet si "largim prej rrugës së drejtë". Pse? Sepse ato (libra) me vërtetë i ishin zbritur "të dërguarve të Allahut", si "ajete të Allahut", por për një fitim të pakët ato ishin manipuluar dhe, Allahu i Madhëruar, me anë të Kuranit Fisnik, vuri në vend ajetet e vërteta që ishin zbritur më parë. Prandaj, zemra e besimtarit nuk duhet të vij vërdallë në këto fusha të transformuara por duhet të marrë frymë në atmosferën e pastër të shpalljes që erdhi me Kuranin.

Në mënyrë të njëjtë, kur bëhet fjalë për kujdesin ndaj orientimit, në fushën e kujdesit të besimtarit nuk duhet të jenë vetëm "devijimet e ithtarëve të librit", por të gjitha "devijimet" që janë në kundërshtim me shpalljen.

Përmbajtja

Vera dhe qyteti
Edison Çeraj

15



8

Nacionalizmi dhe racizmi
Ismail Lutfi Çakan



Personaliteti që siguron
shpëtimin e përjetshëm
Osman Nuri Topbash

34



12



42

Rregullat e arta të suksesit
në Administrim / Udhëheqje
Ahmet Zijlan

5 Zoti ynë, mos na i devijo zemrat!

Ahmet Tashgetiren

10 Karvani i pafundësisë

Idris Arpat

12 Ekspozimi mirësive

Nuredin Nazarko

16 Përgjithmonë vëllazëri

Xhafer Durmush

18 Një ndarje e tillë

Ali Riza Temel

20 Ç'illoj bote!

Ali Byjyqçapar

21 Fol me zemër jo me gjuhë


Mehmet Dinç

22 Shoku i udhës

Doç. dr. Kerim Bulladë

24 Njeriu i mirë dhe urtësia

Azmir Jusufi



46

Zhvillimi mendor përtej përpjekjes për të mbijetuar...

Mesut Kaja

Mendime të pastorizuara

Xhihan Tashtan

Një Ajet-Një Hadith

El-Hafid - Er-Rafi

Ilir Hoxha

Mos të të zotërojnë ato që i zotëron!

Ali Khan

Komunikojë mesazhin e Zotit

Ferit Piku

Modeli i Aishes dhe Ummu Sherik

në predikimin e Islamit

Shefika Kaja Meriç

Kjo pjatë do të mbarojë(!)

Psik. Tuba Sëkmën


30

Bota e misterhme e Saturnit
Muaz Erdem



Familja bërthamë dhe ajo tradicionale
Dr. Hysejn Jëllmaz

56





Zoti ynë, mos na i devijoj zemrat!

— Ahmet Tashgetiren —

Në Kuranin Fisnik, përdoret fjala “Zejg”, e cila ka kuptimet, “*shtrembërim, rrëshqitje dhe devijim*”. Allahu i Madhëruar na paralajmëron prej “*rrëshqitjes së zemrës*”, duke na mësuar një lutje të tillë në ajetin 8 të sures Al-i Imran:

“Thuaj! “O Zoti ynë! Mos lejo që zemrat tona të devijojnë (nga e vërteta), pasi na ke udhëzuar në rrugën e drejtë dhe, jepna mëshirë prej Teje; vërtet, Ti je Dhuruesi i Madh!””

Nga ky ajet, kuptojmë edhe se “mos rrëshqitja e zemrave”, është diçka që mund të arrihet vetëm në sajë të “mëshirës së Allahut”. Pra, njeriu duhet të jetë i kujdesshëm, por përsëri ai duhet të strehohet edhe tek “mëshira e Allahut”. Njësoj si i Dërguari i Allahut (a.s.), i cili u strehua tek Zoti me këtë lutje:

“O Zoti im që i kthen dhe i rrotullon zemrat! Bëje zemrën time të qëndrueshme në fenë Tënde!” (Tirmidhi, Deauat, 89, 124.)

Në fakt, edhe lutja që Zoti ynë na mësoi me Fatihanë, të cilën e përsërisim në çdo namaz, ka të bëjë po me të njëjtën ndjesi të zemrës. Aty, Zoti ynë na tregon edhe për “Sirat-i mustakijm/Rrugën e drejtë”, edhe për fushat e devijimit:

“Udhëzona në rrugën e drejtë! Në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi e jo në të atyre që kanë shkaktuar zemërimin Tënd, as në të atyre që janë të humbur!” (Fatiha, 6-7)

Ndërsa në ajetin paraardhës (Fatiha, 5), Allahu na tregon se çfarë dëshiron prej nesh, duke na mësuar të themi, **“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë!”**, me qëllim që zemrat tona të jenë të mbrojtura vazhdimisht ndaj fushave ku mund të rrëshqitet apo devijohet.

Zoti ynë i Madhëruar, i Cili na mëson të lutemi për t’u ruajtur nga “rrëshqitja e zemrës”, na jep edhe të dhënat në lidhje me fushat ku mund të ndodh ajo. Kjo, na jepet pikërisht në ajetin para kësaj lutjeje:

“Është Ai që të ka shpallur ty (Muhamed) Librin, disa vargje të të cilat janë të qarta e me kuptim të drejtpërdrejtë. Ato janë themelet e Librit. Kurse disa (vargje) të tjera janë jo krejtësisht të qarta (me kuptime alegorike). Ata, zemrat e të cilëve priren nga e pavërteta, ndjekin vargjet më pak të qarta, duke kërkuar të krijojnë pështjellim dhe duke kërkuar t’i komentojnë sipas dëshirës së vet. Por, kuptimin e tyre të vërtetë e di vetëm Allahu. Ndërsa ata që janë thelluar në dije, thonë: “Ne i besojmë (Kuranit). Të gjitha këto (vargje të qarta e alegorike) janë nga Zoti ynë!” Këtë e kuptojnë vetëm mendarët.” (Al-i Imran, 7)

Termat “*muhkem*” dhe “*muteshabih*”, që përdoren në këtë ajet, janë prej temave kryesore të shkencës së metodologjisë së tefsirit. Në përgjithësi, termi “*muhkem*”, përdoret për ajetet që kanë gjykim të prerë

Nëse zemra juaj është e shëndetshme, ju do të keni kujdes ndaj “haramëve”, të cilat janë “vendi i mbrojtur i Allahut”. Pra, nuk do ta ngacmoni atë zonë, duke u përpjekur të nxirrni ndonjë “hallall” dhe nuk do të mundoheni të kullotni nefsin tuaj në afërsi të haramëve.

e të qartë. Ndërsa termi “*muteshabih*”, përdoret për ajetet që mund të kenë kuptime të ndryshme, alegorike ose të fshehta. Mirëpo, në lidhje me faktin se cilët prej ajeteve të Kuranit janë “*muhkem/të qarta*” dhe cilët janë “*muteshabih/alegorikë*”, ka mendime të ndryshme.

Përfundimi që duhet nxjerrë prej kësaj, është se, për t’u ruajtur prej një rreziku shumë jetik siç është “devijimi apo rrëshqitja e zemrës”, ka nevojë për një “ndjesi zemre” shumë të thellë. Prandaj, është e domosdoshme që këtë ajet ta lexojmë me shumë kujdes duke marrë mësim prej tij.

Zoti ynë i Madhëruar, “hetimin e ajeteve muteshabih”, e konsideron si një synim për “të nxjerrë ngatërresa” dhe për “të bërë interpretime të paqena”. Pasi theksohet se, “**Kuptimin e vërtetë të ajeteve e di vetëm Allahu**”, tregohet qartë se si duhet të veprohet me ato ajete, duke thënë se: “**Ata që janë thelluar në dije, thonë: “Ne i besojmë (Kuranit). Të gjitha këto (vargje të qarta e alegorike) janë nga Zoti ynë!”**”.

Kujdesi që duhet treguar në lidhje me çështjen e ajeteve “muteshabih”, na bëhet i ditur edhe në një hadith të Profetit tonë (a.s.):

Numan b. Beshir ((r.a.)), transmeton se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Padyshim se hallalli dhe harami janë të qartë. Midis këtyre të dyjave ka disa gjëra të dyshimta, të cilat shumë njerëz nuk i dinë. Kush ruhet nga gjërat e dyshimta, ka ruajtur fenë dhe nderin e vet. Ndërsa ai që zhytet në gjëra të dyshimta, bie në haram. Nëse cobani i kullot bagëtitë afër një vendi të mbrojtur (ku është e ndaluar të hyhet), ato mund të hyjnë aty në çdo moment. Dijeni se çdo sundimtar ka një vend të mbrojtur (vetëm për veten). Bëni kujdes! Vendi i mbrojtur i Allahut janë gjërat që ai ka bërë haram. Tregohuni vigjilentë! Në trup ndodhet një copë mishi, e cila nëse është mirë, i gjithë trupi është mirë. Por, nëse ajo prishet, i gjithë trupi prishet. Bëni kujdes! Ajo (copë mishi) është zemra.” (Buhari, Iman, 39, Muslim, Musakat, 2996.)

Nëse përpikemi ta lexojmë dhe ta kuptojmë këtë hadith fisnik nga fillimi deri në fund, do të vëmë re se i Dërguari i Allahut (a.s.), duke thënë: “Tregohuni vigjilentë!”, na tërheq vëmendjen në “vetëdijen e zemrës”. Pra, bëni kujdes, forcojeni zemrën tuaj!.. Sepse nëse zemra juaj nuk është e shëndetshme, e gjithë qenia ju mund të shkatërrohet.

Nëse zemra juaj është e shëndetshme, ju do të keni kujdes ndaj “hameve”, të cilat janë “vendi i mbrojtur i Allahut”. Pra, nuk do ta ngacmoni atë zonë, duke u përpjekur të nxirrni ndonjë “hallall” dhe nuk do të mundoheni të kullotni nefsën tuaj në afërsi të hameve. Është e qartë se, nëse nefsën e kullotni aty me syrin, veshin, gjuhën-shijen, dorën dhe këmbën tuaj, zemra juaj do të rrëshqasë në zonat e mjegullta dhe do të fillojë t’i zbehet gjallëria, ndjesia dhe kujdesi. Në këtë mënyrë, ajo fillon të mos e shohë

haramin si haram dhe nuk përpiket më të tregohet e kujdesshme në lidhje me hallallet. Për rrjedhojë, edhe harmonia e fesë në jetën tuaj do të prishet.

Fakti që Zoti ynë ka lejuar ekzistencën e një zone të tillë, është për shkak që ta bëjë njeriun të jetë gjithmonë vigjilent. Zemra, e cila është epiqendra e besimit, është edhe qendra e personalitetit e cila mund të marrë drejtime të ndryshme. Besimi nuk pranon vajtje-ardhje, por është një lidhje e cila duhet të jetë në vigjilencë çdo moment. Po filloi njëherë rrëshqitja, nuk dihet se ku do të ndalet.

Nëse vihet re me kujdes, në ajet urdhërohet: “**...Mos lejo që zemrat tona të devijojnë (nga e vërteta), pasi na ke udhëzuar në rrugën e drejtë!..**”. Kjo do të thotë se, devijimi apo rrëshqitja e zemrës, është një rrezik për besimtarin. Besimi është një çështje e orientimit të zemrës. Pra, do të thotë se, në besim, koordinatat e zemrës duhet të qartësohen plotësisht. Për këtë arsye, formula e shehadeetit fillon me një “mohim të përgjithshëm”, duke thënë, “La ilahe / nuk ka zot”. Pra, para se zemra të arrijë në fazën “il-lallah / përveç Allahut”, duhet të eliminojë çdo gjë tjetër që i paraqitet si zot. Jo, jo, jo... “Vetëm Allahu është!” Në fakt, mbase të gjitha “ato që nuk janë”, duhet të shihen me vetëdije. Për këtë arsye, në Islam ka lindur një shkollë e veçantë që jep mësimin “e pastrimit të zemrës prej çdo gjëje tjetër jashtë Allahut”.

Mbase këtu, duhet të kujtojmë kujdesin që duhet të tregojmë në lidhje me “orientimin e rrugës”, e cila na përsëritet çdo ditë me dhjetëra herë në suren Fatiha: “**Udhëzona në rrugën e drejtë. Në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi e jo në të atyre që kanë shkaktuar zemërimin Tënd, e as në të atyre që janë të humbur!**”

Përpara besimtarit qëndron një rrugë, që cilësohet si “rrugë e drejtë”. Ajo është “rruga muhkem/e qartë”. Ajo është një rrugë ndryshe nga rrugët e atyre që “kanë shkaktuar zemërimin hyjnor” dhe “atyre që kanë devijuar”. Vallë cila rrugë shkakton zemërimin hyjnor dhe cila rrugë është e devijuar? Komentuesit tanë të Kuranit, e kanë konsideruar këtë, si “rrugën e ithtarëve të librit”.

Është me dobi t’i hedhim një sy edhe këtij interpretimi, sepse, kur themi “ithtarët e librit”, e kemi fjalën për librat hyjnorë që u kanë zbritur njerëzve para Kuranit dhe sipas këtij ajeti, animi për nga ata, kuptohet si “largim prej rrugës së drejtë”. Pse? Sepse ato (libra) me të vërtetë i ishin zbritur “të dërguarve të Allahut”, si “ajete të Allahut”, por për një fitim të pakët ishin manipuluar dhe, Allahu i Madhëruar, me anë të Kuranit Fisnik, vuri në vend ajetet e vërteta që ishin zbritur më parë. Prandaj, zemra e besimtarit nuk duhet të vijë vërdallë në këto fusha të transformuara por duhet të marrë frymë në atmosferën e pastër të shpalljes që erdhi me Kuranin.

Në mënyrë të njëjtë, kur bëhet fjalë për kujdesin ndaj orientimit, në fushën e kujdesit të besimtarit nuk duhet të jenë vetëm “devijimet e ithtarëve të librit”, por të gjitha “devijimet” që janë në kundër-

shtim me shpalljen.

Transmetohet se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë, “*Mua më ka plakur surja Beni Hud*”, me të cilën ka pasur për qëllim urdhrin hyjnor që zë vend në ajetin 112 të sures Hud: **“Qëndro i patundur në udhën e drejtë, ashtu siç je i urdhëruar!..”**

Le ta lexojmë edhe njëherë kuptimin e atyre ajeteve:

“Prandaj qëndro i patundur në udhën e drejtë, ashtu siç je i urdhëruar. Ashtu le të veprojnë edhe besimtarët që janë me ty, e mos i kaloni kufijtë, se Ai, me të vërtetë, i sheh mirë ato që punoni ju. Dhe mos anoni nga ata që bëjnë të këqija, përndryshe do t’ju përcëllojë Zjarri. Ju nuk do të keni mbrojtës tjetër përveç Allahut dhe nuk do të ndihmoheni.” (Hud, 112-113)

Në lidhje me shprehjen, **“Qëndro i patundur në udhën e drejtë!..”**, që përdoret në këtë ajet dhe mesazhet e tjera të ajeteve, komentuesi i Kuranit, Elmallëllë Hamdi Jazër, në veprën e tij të tefsirit me titull, “*Feja e Vërtetë, Gjuha e Kuranit*”, shënon:

“Pra, ashtu siç nuk ka rrugë tjetër përveç asaj të drejtës për të arritur tek Allahu, në të njëjtën kohë, në asnjë çështje nuk ka pozitë më të lartë se rruga e drejtë dhe urdhër më të vështirë se ajo. Çfarëdo pune të jetë, çfarëdo synimi të ketë, rruga më e shkurtër për ta arritur, është e drejta. Megjithatë, para së gjithash, është shumë e vështirë të përcaktosh se në cilën vijë ndodhet e drejta në një çështje. Përveç kësaj, është më e vështirë të ecës pa u lëkundur mbi atë vijë të drejtë kur i pret marrëdhëniet në pika të ndryshme me atë çështje. Por përsëri, është edhe më e vështirë të vazhdosh të ecësh dhe të qëndrosh në atë vijë të drejtë pa u lëkundur aspak, pasi të kesh arritur synimin e dëshiruar.

Gjithsesi, duhet të kujtojmë edhe se, pika e vështirë e këtij ajeti, që e bëri Profetin të thotë “*më ka plakur*”, më tepër se pjesa në lidhje me veten e tij në urdhrin e rrugës së drejtë, duhet të jetë pjesa në lidhje me umetin e tij. Kjo, sepse në Kuran urdhërohet: “*edhe ata që pendohen së bashku me ty.*” Pra, të gjithë ata që janë myslimanë, që pendohen nga idhujtaria dhe që gjenden në besim bashkë me ty, duhet të jenë në rrugë të drejtë njësoj si ti. Dhe mos u rebeloni! Pra, mos i kaloni kufijtë që ka caktuar Allahu, mos u largoni nga e drejta, duke devijuar në ekstreme dhe mos e teproni o myslimanë! Sepse patjetër që Ai (pra Zoti yt), sheh gjithçka që do të veproni. Asgjë nuk i ikën syrit të Tij. Ai sheh dhe në bazë të saj jep edhe atë që meriton. Dënim apo shpërblim qoftë, ai nuk e lë pa e dhënë.”

Gjithashtu, në një hadith tjetër, në lidhje me çështjen e plotësimit të njëri-tjetrit, të besimit dhe rrugës së drejtë, tregohet:

Njëherë, një sahab me emrin Abdullah bin Amr ((r.a.)), i tha të Dërguarit të Allahut (a.s.):

“O i Dërguari i Allahut! Më thuaj diçka në lidhje me Islamin, që të mos kem nevojë të pyes dikë tjetër

përveç teje në këtë çështje!”

I Dërguari i Allahut (a.s.), u përgjigj: “*Thuaj! Besova Allahun dhe bëhu plotësisht i drejtë!*”

Këtu, duhet të shtojmë edhe këtë transmetim që gjendet tek Kurtubiu:

“Gjatë ditëve të ndodhisë së “riddes”, pra largimit nga feja, e cila ndodhi për herë të parë në mes të umetit të Muhammedit (a.s.), Ebu Bekri ((r.a.)), në mënyrë të veçantë në namazet e akshamit, këndonte ajetin: “*...Mos lejo që zemrat tona të devijojnë (nga e vërteta), pasi na ke udhëzuar në rrugën e drejtë!..*”. Kjo, tregon qartë se në cilin aspekt i shikonte ngjarjet atë kohë halifja dhe se si i vlerësonte ato.” (Kurtubi, Xhami, IV, 120.)

Po ashtu, na duhet të vlerësojmë me kujdes edhe këtë paralajmërim të Profetit (a.s.), të cilin e bëri me rastin e “ngjarjes së Fitenit”. Në hadithin e transmetuar prej Ebu Hurejres ((r.a.)) dhe të shënuar nga Daudi dhe Tirmidhiu, i Dërguari i Allahut (a.s.), thotë:

“Forcojeni jetën tuaj me vepra të mira për t’i bërë ballë fitneve/ngatërresave që i ngajjnë errësirës totale të natës, sepse në atë kohë, njeriu do ta fillojë ditën si besimtar dhe do ta përfundojë në aksham si mohues. Ose, do ta fillojë natën si besimtar dhe do ta përfundojë në sabah si mohues. Ai do ta shesë fenë e vet në këmbim të një përfitimi të kësaj bote.” (Ebu Daud, Fiten 2, Tirmidhi, Fiten 33.)

Ky hadith ka disa versione të ndryshme. Për shembull, në një transmetim tjetër thuhet:

“Pak para Kiametit, do të ndodhin fitne si copat e natës së errët. Gjatë atyre fitneve, njeriu do të gdhiet në sabah si besimtar, e do të ngriset në aksham si mohues, ose do të ngriset në aksham si besimtar, e në mëngjes gdhiet mohues. Gjatë atyre fitneve, ai që rri ulur, është më i mirë se ai që rri në këmbë dhe ai që ecën, është më i mirë se ai që vrapon. Prandaj, thyejini harqet, copëtojini kordhëzat e tyre dhe përplasini shpatat pas gurit. Nëse hyjnë në shtëpinë e ndonjërit prej jush, bëhuni si djali më i mirë prej dy djemve të Ademit (të jetë ai që vritet, jo ai që vret).”

A ndodhemi në kohë të tillë?

Si reflektohet rrëshqitja/devijimi i zemrës në sjelljet e njeriut në kohë të tilla?

Mund të themi se:

Neve na duhet t’i ruajmë zemrat tona. Në ajet, përdoret shprehja “zemrat tona”, që do thotë se, për të ruajtur zemrën tonë, është i domosdoshëm bashkimi me zemrat e umetit. Të gjithë si umet, duhet ta ruajmë gjuhën, dorën, lapsin dhe qëndrimin tonë. Kur të caktojmë marrëdhëniet me njerëzit, me miqtë, e me armiqtë tanë, duhet të bëjmë kujdes në kriteret që ka vendosur Allahu. Zemra rrëshqet dhe rrugët fillojnë të shtrembërohen. Duhet të strehohemi tek Allahut. Duhet të strehohemi tek Allahut!

NACIONALIZMI DHE RACIZMI

— Ismail Lutfi Çakan —

REALITETI AKTUAL

Si myslimanë, kemi një kohë të gjatë që vuajmë probleme serioze duke filluar me kryet dhe në shumë pjesë të rëndësishme si zemra, në trupin e umetit. Kjo është një e vërtetë. Gjithashtu, në të njëjtën mënyrë, umeti i Muhammedit (a.s.), është nxitur brenda një kaosi në mënyrë të vetëdijshme dhe të planifikuar nga ana e jahudive dhe të krishterëve (sionistëve dhe kryqtarëve), për të cilët Kurani Fisnik, na paralajmëron duke thënë se: **“ata nuk do të jenë të kënaqur me ty, derisa të pranosh besimin e tyre!”** (Bekare, 120) Dhe, për këtë arsye, umeti duket sikur ndjen gjithmonë e më pak. Madje, në nivelin e udhëheqjes duket se gjendja është edhe më e rëndë. Kjo është një tjetër e vërtetë e hidhur.

Për shkak të mos reagimit ose të reagimit të dobët e të vonuar që tregojmë si umet, na është dobësuar mjaft edhe lidhja midis organeve, gjë e cila të sjell në mendje një trup që e ka humbur ndjesinë në një masë të madhe. Për t’u kundërvënë jo që jo, por ne arrijmë të paraqesim në sytë e myslimanëve si një

aftësi të madhe apo nivel të lartë politik edhe poshtërimin e pritjes së lejes nga ana e fuqive armike për të dërguar qoftë edhe një ndihmë mjekësore apo humanitare. Ndërkohë që ata përdorin një fuqi në masën “dhjetë me një”,

ne arrijmë ta shohim “në kundërshtim me vlerat globale” edhe kundërvënien me një fuqi në masën “një me dhjetë”.

Tragjeditë që po përjetohen prej vitesh pothuajse në çdo pjesë të botës Islame, e bën më të qartë qëndrimin dhe sjelljen tonë për të ardhur keq. Për fat të keq, për një kohë shumë të gjatë, në vend të bashkimit/ittiha-dit që kërkon besimi Islam, në trupin e umetit kanë zënë rrënjë thellë ndjenjat dhe parullat e tribalizmit/racizmit/nacionalizmit që janë burimi i ndarjeve të pariparueshme.

Historiani anglez Arnold Toynbee, ka thënë se Islami është kundërhelmi i Racizmit dhe Alkoolizmit, të cilat ai i sheh si dy rreziqe të mëdha. Ai pohon se ndalimi i racizmit dhe i alkoolit tregon se Qytetërimi Islam në këtë dy pika është më i lartë se Qytetërimi Perëndimor. Gjithashtu, edhe ky mendim është i tij: **“Në fakt, racizmi/nacionalizmi, është një lojë në të cilën myslimanët kanë rënë brenda.”**

REALITETI HISTORIK

Në fakt, ashtu si çdo sistem tjetër, edhe Islami e ka ndërtuar umetin dhe qytetërimin e vet mbi disa parime të caktuara. Në besim ka si parim teuhidin/monoteizmin, ndërsa në shoqëri ka si parim vëllazërinë dhe unitetin. Për rrjedhojë, umeti Islam, është bashkësia e vëllazërve, kufijtë e së cilës janë përcaktuar me besimin Islam. Kufijtë e kësaj strukture, përveç besimit, nuk mund t’i përcaktojë asgjë tjetër, si për shembull, raca, ngjyra apo territori. Parakushti i vetëm përcaktues i vëllazërisë Islame, është thënia: **“La ilahe il-lallah Muhammedur’r-resulullah/Përveç Allahut s’ka zot tjetër dhe Muhammedi është i Dërguari i Tij.”** Kjo, është parulla/shprehja e teuhidit, të cilën kushdo që e thotë, është mysliman dhe vëllai i fesë së çdo myslimani tjetër.

Kjo e vërtetë, në Librin tonë të shenjtë, në Kuran, është përcaktuar dhe deklaruar në një mënyrë shumë të qartë me këtë ajet: **“Në të vërtetë, besimtarët janë vëllazër!”** (Huxhurat, 10) Po ashtu, edhe Profeti ynë i dashur (a.s.), ka thënë se: **“Myslimani është vëllai i myslimanit!”**, duke ia shpallur të gjithë botës se në çfarëdo vendi të botës qofshin dhe në çfarëdo kohe të jetojnë, të gjithë myslimanët janë vëllazër feje të njëritjetrit. Madje, kur ai vet nderoi Medinën me vajtjen e tij

atje, shpalli si vëllezër çdonjërin prej muhaxhirëve që kishte emigruar prej Mekës, me një prej myslimanëve të Medinës, duke i dhënë start shoqërisë së parë Islame të ndërtuar mbi parimin e vëllazërisë fetare.

Formën e “solidaritetit shoqëror”, të cilën është duke e kërkuar bota moderne, i Dërguari i Allahut (a.s.), e realizoi që me shoqërinë e parë Islame në sajë të parimit të vëllazërisë, e cila do të jetë shembulli më i mirë për umetin e tij, që do të jetojë deri në Ditën e Kiametit. Për këtë arsye, vëllazëria Islame, është një umet i shpallur me Libër dhe me Sunet, i cili ka filluar ta jetojë atë vëllazëri me bashkësinë Islame të Medinës.

Për këtë arsye, edhe i Dërguari i Allahut (a.s.), i ka porositur myslimanët të marrin si kriter veten e tyre në çdo marrëdhënie me vëllezërit e tjerë, duke thënë:

“Asnjë prej jush nuk mund të jetë besimtar i vërtetë pa dashur për vëllain mysliman atë që do edhe për veten e tij.”

REALITETI PARIMOR

Islami është feja e vërtetë. Ai ka shpallur më të saktën dhe më të natyrshmen e çdo gjëje. I Dërguari i Allahut (a.s.), e ka bërë të qartë se sa të dëmshme e të panevojshme janë grindjet ndër fise, popuj dhe raca.

Në një transmetim të shënuar nga Ahmed bin Hanbeli, tregohet se Uasile b. el-Eska (r.anha), e ka pyetur të Dërguarin e Allahut (a.s.):

“O i Dërguar i Allahut! A konsiderohet racizëm (nacionalizëm) dashuria e njeriut për fisin dhe gjakun e vet?” I Dërguari i Allahut (a.s.), u përgjigj:

“Jo! Racizëm (nacionalizëm) është kur njeriu e ndihmon popullin e vet në padrejtësi!” (Ahmed b. Hanbel, Musned, IV, 107,160; Ibn Maxhe, Fiten 7.)

Nga kjo kuptojmë se, nacionalizëm ose racizëm, nuk është kur njeriu e do popullin apo fisin e tij, por kur u shkon në ndihmë atyre edhe në padrejtësitë që bëjnë.

Këtu duhet theksuar edhe njëherë se, Islami është një fe dhe një sistem që mbështet të natyrshmen, të arsyeshmen dhe të drejtën. Dhe fakti që njeriu do fisin, popullin dhe racën e vet, që ndjehet i afërt me ta dhe e konsideron veten prej tyre, është një ndjenjë shumë e natyrshme, sepse ai në atë rreth “e ka ndjerë” vetveten për herë të parë. Mirëpo, nëse ky rreth ndikon tek ai njeri në atë masë sa të tolerojë edhe padrejtësitë e tyre duke anashkaluar vlerat e besimit, kjo nuk është aspak e natyrshme. Kjo është në kundërshtim me drejtësinë dhe me idealin e së drejtës në Islam.

Injorantët, pra njerëzit të cilëve u ka humbur ndjenja e drejtësisë thonë: “Unë, fisi, gjaku dhe populli im kemi gjithmonë të drejtë dhe çfarëdo që të ndodhë, unë mbështes popullin tim.” Ky botëkuptim, është nacionalizëm, është ndarje dhe e ndaluar. Pikërisht

këtë e kundërshton me forcë Islami. Lidhur me këtë, i Dërguari i Allahut (a.s.), thotë:

“Ndihmojeni vëllain tuaj, edhe nëse është në gabim, edhe nëse është në të drejtë!” Sahabët e pyetën: “Ndihmën ndaj vëllait në të drejtë e kuptojmë, por si ta ndihmojmë atë që është në gabim?”

I Dërguari i Allahut (a.s.), u përgjigj:

“Atë do ta ndihmoni duke e bërë të heqë dorë nga gabimi. Kjo është ndihmë për të!” (Buhârî, Mezalim 4, ikrah 7; Tirmizi, Fiten 68.)

Gjatë një hutbeje, i Dërguari i Allahut (a.s.), tha:

“Më i miri ndër ju, është ai që e ndihmon popullin dhe fisin e tij pa hyrë në gjynah!” (Ebu Davud, Edeb 112.)

Në betejën e Uhudit, një sahabë i cili ishte duke vrarë një idhujtar, po thërriste: “Na!.. Unë jam djalë Persie!” Kur i Dërguari i Allahut (a.s.), e dëgjoi këtë thënie, iu drejtua atij dhe e paralajmëroi: “A nuk duhej të thoshe, “Na!.. unë jam djalë prej ensarëve?”” (Ebu Daud, Edeb 112.)

Nëse këtyre haditheve u shtojmë edhe këto ajete, do të bëhen edhe më të qartë kufijtë e botëkuptimit që duhet të ketë myslimani në lidhje me nacionalizmin:

“Nuk gjen njerëz, që besojnë në Allahun dhe në Ditën e Fundit, që të ushqejnë dashuri ndaj atyre, të cilët kundërshtojnë Allahun dhe të Dërguarin e tij, edhe në qofshin ata etërit e tyre ose bijtë e tyre, ose vëllezërit e tyre, ose farefisi i tyre...” (Muxhadile, 22)

“O besimtarë! Bëhuni zbatues të palëkundur të drejtësisë, duke dëshmuar në emër të Allahut, qoftë edhe kundër jush ose kundër prindërve dhe të afërmve tuaj. Qoftë i pasur ose i varfër ai (për të cilin dëshmoni), Allahu është për ata vlerësuesi më i drejtë. Dhe mos shkoni pas epsheve tua e të shtrembëroni drejtësinë!..” (Nisa, 135)

“...Le të mos ju nxisë urrejtja ndaj njerëzve për të bërë padrejtësi. Bëhuni të drejtë, se kjo është më afër devotshmërisë dhe frikësujni Allahut! Pa dyshim, Allahu është i Dijshëm për çdo gjë që punoni ju.” (Ma’ide, 8)

Prej të gjitha këtyre argumenteve, kuptohet shumë mirë se, nuk është e ndaluar që një mysliman të dojë popullin ku ai bën pjesë. Nacionalizëm/racizëm i ndaluar është mbështetja e popullit të vet në padrejtësi, pra t’i mbështesë ata në gabim vetëm sepse janë populli i tij. Kjo, sepse dëmtuesi kryesor dhe më i rrezikshëm i umetit, është nacionalizmi/racizmi.

Struktura e një umeti të bashkuar në trekëndëshin e dashurisë, mëshirës dhe solidaritetit mbi themelin e besimit Islam, është ilaçi i çdo lloji problemi. Deri në ditën që ta ringjallim unitetin e umetit të mbështetur në ndjenjat e besimit, për fat të keq problemet tona do të vazhdojnë të përjetohen në një masë apo në një tjetër!

KARVANI

i pafundësisë

— Idris Arpat —

Të mëdhenjtë tanë kanë thënë, ne po jua kujtojmë:

1. Në jetën tuaj të përditshme, ndani një kohë të përshtatshme për Kuranin. Lexojeni atë në tekstin origjinal dhe në përkthim, duke u munduar ta kuptoni. Leximi është për të kuptuar, ndërsa kuptimi për ta jetuar.

2. Lexojeni mjaft edhe jetën e të Dërguarit të Allahut (a.s.), edhe hadithet e tij. Suneti është shpjegimi më i mirë i Kuranit.

3. Sado e vogël qoftë, mundohuni të krijoni një bibliotekë personale. Gjeni libra të zgjedhur me kujdes, sepse çdo libër i bukur, është si një tefsir i Kuranit. Këto libra lexojini vazhdimisht në kohë të përshtatshme. Nëse nuk lexoni, nuk mund ta kuptoni ashtu siç duhet fenë tuaj. Mos vallë dëshironi të bëheni besimtarët e një feje, të cilën nuk e kuptoni?

4. Jepini rëndësi shëndetit tuaj. Profeti ynë (a.s.), “shëndetin dhe kohën e lirë”, i ka konsideruar si “dy mirësi”. Çdo punë e mirë, realizohet duke përdorur shëndetin e mirë dhe kohën e lirë. Ata që i shpërdorojnë kot këto dy mirësi, kanë mashtruar vetveten.

5. Ruhuni medoemos nga pirja e duha-

nit! Pirja e duhanit është tradhti ndaj amanetit të trupit, pasurisë dhe ambientit. Ajo është vdekje e ngadaltë.


6. Jepini rëndësi pastërtisë në çdo kohë dhe në çdo vend. Mos harroni se, feja është ndërtuar mbi pastërtinë. Allahu i Madhëruar është i pastër dhe e do pastërtinë.

7. Bëhuni aq fjalë drejtë, saqë askush të mos t’ju kërkojë të betoheni. Nuk jeni të detyruar të jeni profetë, por jeni të detyruar të jeni “të besueshëm”. Njeriu e arrin “gradën e të drejtëve” tek Allahu, duke thënë vazhdimisht të drejtën.

8. Mbajeni fjalën e dhënë dhe gëlltiteni zemërimin dhe urrejtjen. Nuk është e lehtë të mos zemërohesh. Mund të nevrikosesh, por s’ke pse e shfaq!

9. Bëhuni të drejtë! Kryesorja në marrëdhëniet me Allahun, është teuhidi, ndërsa në marrëdhëniet me njerëzit, është “drejtësia”. Drejtësia është themeli i administrimit. Konsiderojeni drejtësinë si Yllin Polar... çdo gjë tjetër rrotullohet rreth tij. Padrejtësia sjell zullum, ndërsa zullumi shkatërrim!

10. Sado të pasur dhe të ditur të jeni, përsëri merruni me një punë që ju sjell



fitim. Punoni, që të mos u bëheni barrë miqve. Madje, që të bëheni ju dora që jep! “Mos u bëni barrë, por mbani barrë!” Të urtët kanë thënë, “Dhëpra që shëtit, është më e mirë se luani që rri shtrirë.”

11. Nëse është e mundur, krijoheni vet punën tuaj! Derë është edhe dera e rrizkut që ju kanë hapur të tjerët, por pa shikoni, në dorën e kujt janë nëntë të dhjetat e parave?

12. Punën kryeni në mënyrë të përsosur dhe pa të meta! Kjo është gjëja më e përshtatshme me kënaqësinë e Allahut. “Çdo punë duhet të fillojë dhe të mbarojë brenda kohës që i është caktuar.” Aq sa e rëndësishme është të punosh me dëshirë, aq e rëndësishme është edhe të bësh planifikimin e kohës. “Në themel të suksesit qëndron planifikimi i kohës.”

13. Mundësisht mos hyni kurrë në borxh! “Borxhi është fillimi i robërisë.” Por nëse jeni të detyruar të hyni në borxh, paguajeni atë në kohën e vet. Mos lejo të lëkundet besimi që të tjerët kanë në ju. Si kanë thënë: “S’më vjen keq për humbjen e kalit, por për humbjen e besimit.”

14. Sado pak qoftë, një pjesë të pasurisë ndajeni për bamirësi, ndërsa një pjesë tjetër mbajeni për raste të papritura. Në asnjë mënyrë mos u jepni pas sendeve luksoze!

15. Respektioni zakonet dhe traditat Islame në çdo fushë të jetës! Për shembull, përshëndetja me selam, veshja e përshtatshme, edukata e të folurit, thjeshtësia e orendive shtëpiake, buzëqeshja, etj., janë të gjitha sunete që duhen respektuar.

16. Mos harroni se jeni gjithmonë nën vëzhgimin e Allahut! Vdekja dhe përtej saj, janë vazhdimi i udhëtimit tonë. Jeta e vërtetë është atje përtej. Kjo botë është si një han me dy porta, një vend ku hymë si mysafirë, e më pas ngrihemi dhe ikim. Mos e lidhni zemrën pas gjërave të përkohshme, me qëllim që të mos e kemi të vështirë të shkëputemi. Mos thoni: “Të kemi në këtë botë, pa bota tjetër le të jetë ç’të dojë!” Mos e ço dëm një thesar për një grusht ar!

17. Ashtu siç nuk e shkëputni lidhjen me Allahun dhe dijen, mos e shkëputni as me natyrën! Natyra është një libër i shkruar prej Allahut, e cila të është lënë amanet dhe duhet lexuar. Ditën kur të filloni të ndjeni kënaqësi prej atij leximi, do të jetë një ditë e madhe. Pikërisht atëherë, do të kapërceni kufirin e “të rëndomtës” dhe do të bëheni një njeri “përtej kufijve”, me ç’rast do të shihni se si i vërteton natyra ajetet e Kuranit. Do të dëgjoni se si çdo krijesë thotë “subhanallah” dhe do të mbeten të mahnitur e të

mrekulluar. Do ta gjeni veten në mes të një galerie arti, në një bote misterioze. Do të hutoheni duke u zhytur në bukuritë e saj. Mirëpo, nëse ende nuk e keni arritur kënaqësinë e leximit të atij libri, kjo është me të vërtetë një humbje e madhe. Nëse nuk kuptoni asgjë dhe nuk ndjeni asnjë shije prej atyre që shihni dhe dëgjoni një jetë të tërë... atëherë ç’të themi, Allahu ju dhënë urtësi dhe mirësi!..

18. Mundohuni të jeni gjithmonë me abdest! Sa herë të keni mundësi bëni adhurime vullnetare. Mos e neglizhoni dhikrin, teuben dhe istigfarin. Dhikri gjallëron zemrën, teubja të rinovon drejtimin, ndërsa istigfari është autokritikë. Këto janë të nevojshme për të mbajtur gjallë besimin.

19. Mos e harxhoni kohën kot! Jeta nuk është diçka që mund të çohet dëm. Bashkë me kohën ikën edhe jeta. Shikoni mirë cilat janë të ardhurat e kapitalit që po ju tretet! A ia vlen ajo që merrni në këmbim të asaj që jepni? Nëse nuk e harxhoni kohën në mënyrë të dobishme, do të thotë se koha po ju harxhon ju!

20. Kontrollojini ndjenjat tuaja! Aq sa është një genie fizike, e me mendje, njeriu është edhe një genie shpirtërore, e me ndjenja. Kjo është pasuria e natyrës njerëzore dhe një mirësi e Allahut. Çdo fjalë dhe çdo sjellje jona, duhet të thuhet e të realizohet pasi të ketë kaluar prej kontrollit të shpalljes hyjnore dhe mendjes së shëndoshë. Kjo është një domosdoshmëri e vullnetit për të respektuar rregullin e artë të quajtur “ekuilibër”.

21. Çdo virtyt dhe çdo bukuri morale që arrini, duhet të mundoheni ta përcillni edhe tek të tjerët. Ky është falënderimi i arritjes së atij virtyti dhe kujdesi që tregohet për fatin e shoqërisë. Kjo është përpjekja për ta bërë njeriun të dashur tek Allahu. Ky është dimension i shoqëror i xhihadit. Kjo do të thotë të vonosh ardhjen e Kiametit.

22. Bëhuni mik të miqve të Allahut dhe armik të armiqve të Tij! Nëse njerëzit do të ishin melekë, gjembat trëndafila dhe do të jetonim në një botë me liman prej qumështi, do të dëshironim të bëheshim miq me të gjithë. Por jeta ka realitetin e vet të ashpër miku im. Xhebraili me shejtanin, Muhammedi (a.s.) me Ebu Xhehlin dhe i sëmuri me mikrobin, nuk mund të pajtohen. “Miqësi, vëllazëri, barazi...” Kini kujdes që këto të mos kthehen në kamuflazhin e tytave që na kthehen neve! Allahu, i Cili ka krijuar Xhenetin, ka krijuar edhe Xhehenemin... Orizi ka edhe guriçka brenda... me të fshirë s’mund t’i heqim, por as orizin s’mund ta hedhim. Zgjidhja është veç të zgjedhim!



Ekspozimi MIRËSIVE

Të jemi syçelë! Të qëndrojmë gati!
Të jetojmë me përgjegjshmëri duke dërrmuar lubinë.
Të tregojmë që dimë të jemi të mëdhenj
në thjeshtësi dhe njerzillëk. **Përndryshe, Jazëk!**

— Nuredin Nazarko —

Vrulli jetësor i disave është për t'u përshëndetur. Janë tepër entuziastë. Duket sikur vetëm ata janë për këtë jetë. Kanë një forcë dhe energji gati të pashtershme për ta përçuar këtë frymë. Nuk është gjë e keqe të përçosh entuziazëm, energji në një kohë kur zymtësia e boshllëkut ka shtrirë rrënjët e veta si fara e sinapit. Madje ringjallja e dëshirës për të bërë gjëra të bukura me jetën është e domosdoshme. Njerëzit kanë vërtet nevojë për këtë. Kanë nevojë për të dalë nga absurdi jetës.

Ka një ngërç tek këta syresh që nuk kanë arritur ta kapërcejnë. Ka një mori arsyes që ndikojnë në veprimtarinë e njeriut. Ka arsye që nuk kapërcejnë dot ngërçet. Ka arsye që të frenojnë. Po në jetë nuk ka vetëm pengesa. Edhe nëse ka, njeriu duhet të zbulojë forcën brenda vetes për t'i kapërcyer në anën e duhur, përndryshe mund të thyejë brinjët. Të pësojë fraktura të pariparueshme dhe më pas e gjithë jeta e tij të përkufizohet nga këto thyerje e fraktura.

Në epokën që jetojmë dhe që shumë mirë e dimë se çfarë ndërhyrje po bën teknologjia në jetën tonë, ngërçet që nuk i tejkalojmë dot shpalosen një e nga një si petët e lakrorit. Kush më shumë e kush më pak është i prekur nga kjo ndërhyrje. Ndërhyrja nuk nënkupton vetëm faktin që tashmë shumë punë nisin e përfundojnë me mjetet teknike. Nuk mund të jetojmë jashtë epoke. As të sillemi sikur nuk na e ndjen aspak për ato çfarë ofron epoka. Jemi pjesë e epokës dhe jetojmë me të mirat dhe të këqijat që ka. Shmangia nuk jep zgjidhje. Izolimi nuk të çon kurrkund. Përshtatshmëria të dërrmon. Në

mes gjithë kësaj vorbulle duhet shtërnguar fort pas nurit të kandilit me një llambë të kristaltë që shndrit si yll e që ushqehet nga pema e bekuar e ullirit që nuk është as i lindjes dhe as i perëndimit. Nuri tij duhet vendosur brenda zemrës. Bëje! Atëherë do ta përjetosh forcën e rezistencës ndaj vorbullës. Nëse nuk e bën kurrë nuk ke për ta kuptuar çdo të thotë të ndriçohesh nga ky nur në mes vorbullës.

Le të vijmë tek ajo ndërhyrje që operon në fushën e ngërçeve që shumë syresh jo vetëm që nuk i tejkalojnë, por rënien pre të tyre e quajnë si shfrytëzim eficient i lirisë së munguar. Këtu ndodh ngatërresa e madhe. Shfrytëzim eficient i lirisë së munguar. Kjo është si të lëshohesh në dishezhë pa frena. Liria e munguar ashtu si të gjitha mungesat e tjera krijoi zbrazëti në konsum. Zbrazëti ushqeui lubinë brenda nesh. Në çastin kur ranë pengesat për konsum dhe ndodhi hapja e tregut dhe futja në të e mungesave, lubia u bë e lemerisshme. Nuk ndjente të ngopur. Oreksi vjen duke ngrënë. Zhvaste dhe gllabëronte. Nuk pyeste çfarë kishte përpara. As kush qëndronte para saj. Me nofullat gjigande dhe dhëmbët çelik bluante çdo gjë. E pandalshme kjo lubi tek shumë syresh. E verbër. Urrejtëse e nurit të kandilit me vajin e pemës së bekuar. Zuri vend tek shumë shpirtra. Nguli tentakulat dhe u përnjështua me ta. Aq shumë është përnjështuar tek një pjesë saqë është fare e pandjeshme prezenca e saj. Ndihen shumë komodë, sepse lubia tashmë është njësh me qenien e tyre. Lubia është dëshmi e ngërçit të parë dhe madhor. Padurimin e lirisë.

Liria është peshë e rëndë. Është mal që të shtyp. Është amaneti që e pranoi veç njeriu, duke qënë tepër fluturak në seriozitet dhe përgjegjshmëri. Ky mal shtypi të gjithë ata që kujtuan se u ngjiten në pi-

kën më të lartë të tij si triumfatorë. Kujtuan se të jesh i lirë është kaq e thjeshtë. Qenka bukur të jesh i lirë. Bën ç'të të dojë kokrra e qejfit. Dhe nuk i jep llogari askujt. Dhe për më tepër s'mban përgjegjësi për ç'thua e bën. Zog i lirë hesapi. Fluturoj si të dua e nga të dua.

Pre e këtyre përfytyrimeve mund të bien dhe ata që besojnë se ia kanë dalë të durojnë lirinë. Fijet që ndajnë gjërat janë kaq të holla saqë duhet një stërmundim i madh për t'i shquar. Nuk të mjafton vetëm optika e syve të tu. Ngatërresa mund të ndodhë në çdo çast. Në vend që të qëndrosh gati, fle mendjen. Në vend që të mbash veshët pipëz, fle gjumë. Në vend që të shoshitësh e të ndash grurin nga egjra, merr shoshën e shkon për ujë në lumë. Veprimet janë të përkundërta me ç'duhet bërë, por padurimi i lirisë të ngrin miokardin.

Prej këtij ngërçi rrjedhojnë e degëzohen me qindra e mijëra përroska që formojnë një deltë jopjellore, ku mund të rriten shkurre e gjëmba për qejf të tyre. Në epokën e teknologjisë dhe ndërhyrjen e saj në operacionet mendore të njeriut nisin ekspozimet për arritjet që mbajnë vulën, padurim i lirisë.

Të mirat materiale që sigurojnë njerëzit për të ndërtuar jetët e tyre janë padyshim pjesë e mirësive që i jepen njeriut. Nuk ka dyshimin më të vogël se njeriut i duhen këto të mira. Kush thotë që nuk i duhen, ose është dembel, ose ndonjë i marrë. Të mirat materiale janë plotësim i përmasës fizike, lëndore. Pa konsumin e tyre na pret vdekja fizike. Fakti që konsumojmë nuk do të thotë se nuk do të vdesim. Përtej të mirave që kemi arritur të sigurojmë, ku me punë, ku me "punë" është kaq mahnitëse bërja publike e tyre. Është epoka ku një pjesë të veprimtarisë sonë apo pothuaj të




tërën jemi duke e ekspozuar në realitetin virtual. Të ekspozosh ide të vyera të emrave të mëdhenj të religjionit, artit, letërsisë, filozofisë, psikologjisë, historisë, sociologjisë etj., nuk është se ua varin dhe aq. Në këtë pjesë janë moskokëçarës. Ajo që përbën shqetësim është ekspozimi i të ashtuquajturave mirësi në sytë e një publiku të gjerë dhe shpesh gati të pamundur për të mbërritur tek këto të mira. Pse të ashtuquajtura? Mirësitë mbeten të tilla, kur ato trajtohen si bekim e mundësisht mbahen sa më larg syve të publikut dhe jo si mjet për të thënë shihni ç'jetë që bëj unë me këto mirësi. Mbahen sa më të fshehta të jetë e mundur që të mos i bëjmë të vuajnë shpirtërisht ata që nuk munden ndoshta të sigurojnë mbijetesën. Nuk po themi të dalim të veshur për ibret. Të rimë të pakrehur e të pa parfumosur. Të mos zbukurohemi kur dalim në publik. Nuk është keq të zbukurohesh edhe kur qëndron në shtëpi pa dalë, që të kënaqet syri i njerëzve që meritojnë më shumë të kënaqen me pamjen tënde.

Ekspozimi i vazhdueshëm nga një pjesë syresh i mirësive materiale ku notojnë, jo vetëm krijon pakënaqësi ndaj asaj që njerëzve u është dhënë. Zhvleftëson jetën në sytë e tyre. Mallkojnë fatin që i la në mjerim. Ndez smirën dhe zilinë që u përvëlton shpirtin. Akoma më keq krijon substratin e një tendence të rrezikshme. Të fitosh shpejt. Të shitesh. Të blihesh. Të përdoresh. Nuk ka rëndësi mënyra si, rëndësi ka që të jetojmë jetën që na ka munguar. Ka dhe prej atyre që nga presioni ambiental bëjnë sikur janë andej e këndej. Fiksohen në celuloid para objekteve apo sendeve që nuk janë të tyre e ndoshta s'kanë për të qenë ndonjëherë, vetëm e vetëm që të hyjnë në tregun e egër të konkurrencës virtuale për jetë alla moderne. Ndërkohë në jetën e tyre reale nuk ka nevojë për koment.

Ndoshta është gati e pamundur t'i shpëtosh absolutisht ekspozimit të të mirave. Janë situatat ku gjendesh, puna që kryen. Mjedisi shoqëror ku bën pjesë që ndonjëherë të nxjerr nga ajo që duhet. Por ajo çfarë ndërmendim këtu ka të bëjë me atë pjesë që është në lirinë tonë ta ekspozojmë apo jo. Për atë pjesë që nuk ka asnjë mekanizëm shtërngues apo detyrues, përveç lubisë. Aq më tepër kur beson se ndriçohesh nga nuri kandilit me vajin e pemës së bekuar. Kjo është edhe më serioze. Edhe më tragjike.

Të jemi syçelë! Të qëndrojmë gati! Të jetojmë me përgjegjshmëri duke dërrmuar lubinë. Të tregojmë që dimë të jemi të mëdhenj në thjeshtësi dhe njerëzillëk. Përndryshe, Jazëk!



*Vera na jep
mundësinë të
rilexojmë natyrën.
Në këtë kuptim,
të lësh pa lexuar
detin, qiellin, malet
etj., duke u ngujuar
te leximi i një libri,
është paradoks.
Fundja në natyrë
çdo gjë është në
lëvizje: nëse humbet
një nga këto lëvizje/
ndryshime, nuk e
kthen dot pas, siç
mund të bësh me
një faqe libri kur të
shket diçka.*

Vera dhe qyteti

Qyteti është i zbrazur sot, në trajtën e pashquar. Edhe zogjtë sikur përtojnë të fluturojnë; kënga e tyre është e kursyer. Ata pak njerëz që kanë mbetur duken të zhytur në një dialog të shtruar me veten. Lëvizjet janë të ngadalta, duke u tretur po kaq ngadalë në honin e vapës. Të gjithë i ka thithur bregdeti si në një mobilizim nën armë, ku secili është përgatitur për të zënë një pozicion që e mbron nga mëshira e tepruar e diellit, i cili shfaqet kaq ngadhënjyes falë pushtetit të tij përcëllues.

Në të tilla ditë mund të rishohësh raportin tënd me qytetin, meqë gjatë pjesës më të madhe të vitit lëvizshmëria e dendur të detyron të jesh pothuaj një tjetër person, ose e thënë tjetërsoj, të përdorësh disa maska ("të tjerët janë ferri", thoshte Sartre). Në të tilla raste nuk ke asnjë shtysë që të përshtatesh, dhe vetja merr një tjetër peshë, herëherë të papërbalueshme, pasi çelet pa kushte ndaj vërshimit të kujtimeve. Deshe s'deshe "do rrnosh vetëm për me tregue", dhe jo të gjithë janë të gatshëm për këtë.

Në qytetin e zbrazur ke luksin të shohësh, e jo të shohin. Në çfarëdolloj pike të ndodhesh në këtë zbrazëti epidemike, je gjithnjë në qoshk, si kundrues; ndërsa kur qyteti i rikthehet jetës "normale", edhe nëse ke zënë ndonjë qoshk ekzotiko-ezoterik, prapëseprapë ke ndjesinë se je i vëzhguar, sidoqë askush nuk ka nge të të hedhë qoftë dhe një shikim skiç.¹ Fjalët dhe bisedat tërhiqen andej nga burojnë, si për të na ndërmendur vlerën e tyre, e cila provohet më fort se kurrë në gjendje privimi si kjo.

Ka një melankoli të ikjes dhe mungesës në një stinë pushtuese si vera, sepse njeriu ecën më shumë drejt vetes sesa drejt të tjerëve. Gati të gjithë bëhen të pakapshëm në verë, jo thjesht ngaqë janë në lëvizje, por ngaqë priren drejt shkëputjeve imagjinare; mendja nuk i bindet vendndodhjes së trupit.

Në verë qytetit i dëgjohen lehtësisht rrahjet e zemrës, dhe është gati për një rregullim të frymëmarrjes.

Fasadat e lara në dritë, rrugët e mbushura me hapësirë, bisedat e pemëve, heshtja e kalimtarëve, hapat policeskë të qenve, gogësima e ndonjë makine, jehona e mbytur e qiellit e shumë dukuri të tjera peshojnë ndryshe në verë. Natyrisht që regëtin një lloj ankthi në këtë zbrazje, por ia vlen, pasi ai të çel një shteg nga ku mund të provosh një tjetër dimension të qenësisë, ose më mirë: ta rikujton këtë dimension.

Pa e tepruar, në verë ka një aromë lirie, sepse vera të shtyn të dalësh nga varri i lirisë, nga qyteti, i cili gjatë gjithë vitit na kërkon vetëm përmbushjen e një funksioni, duke na reduktuar vetëm në pjesëza të një ingranazhi të madhërishtë që nuk ngopet duke i torturuar bijtë dhe bijat e tij.

Aksesorët-pranga të qytetërimit pak a shumë lihen mënjanë nga ndezullia e brendshme për t'u ritakuar me natyrën, pavarësisht njollosjes me pispillosje e patetizëm ku shkasin një pjesë e madhe. Nevoja për arrati nga e zakonshmja nxjerr krye më fort se kurrë pikërisht në verë. Vera na kujton vlerat e harruara.

Vera na jep mundësinë të rilexojmë natyrën. Në këtë kuptim, të lësh pa lexuar detin, qiellin², malet etj., duke u ngujuar te leximi i një libri, është paradoks. Fundja në natyrë çdo gjë është në lëvizje: nëse humbet një nga këto lëvizje/ndryshime, nuk e kthen dot pas, siç mund të bësh me një faqe libri kur të shket diçka.

Ndërtimi i një ekuilibri mes qytetit dhe natyrës është një nga sfidat më të mëdha të kohës sonë. Për t'iu afruar sa më shumë këtij ekuilibri, ne duhet ta rilexojmë herë pas here natyrën, dhe kjo nuk bëhet duke shkrepur foto, gjë që tregon se shumë veta vetëm sa janë prezantuar me natyrën, dhe nuk e kanë njohur akoma. Nuk na duhet asnjë ndërmjetës në këtë marrëdhënie.

Sa më sipërfaqësore të jetë sjellja jonë me natyrën, aq më i tmerrshëm do të jetë qyteti.

1. Megjithëse në Ballkan qëndron disi më ndryshe puna.

2. Qielli është një libër pa faqe.

Përgjithmonë VËLLAZËRI

— Xhafer Durmush —



Për të treguar rëndësinë e diçkaje, në shumë raste themi: “Sot është e rëndësishme të flasim për këtë çështje!”. Këtë duhet të themi edhe kur flasim për vëllazërinë fetare, por, është e pamjaftueshme, sepse mbajtja gjithmonë në aktualitet e vetëdijes, që të gjithë myslimanët janë vëllezër feje, është gjithmonë e rëndësishme. Dhe mangësitë që mund të ekzistojnë në këtë çështje, janë aq të rrezikshme, sa mund të shkaktojnë prishjen e botës Islame. E, duke u përhapur prej andej, shkon deri në prishjen e gjithë botës. Nisur nga kjo, dëshirojmë që ta trajtojmë këtë temë shkurtimisht duke kujtuar disa ajete dhe hadithe fisnike:

Në ajetin 10 të sures Huxhurat, urdhërohet: **“Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, andaj pajtojini vëllezërit tuaj midis tyre dhe kijeni frikë Allahun, në mënyrë që të mëshiroheni.”**

Në këtë ajet, deklarohet qartë se të gjithë besimtarët të çfarëdo kohe qofshin, janë vëllezër në fe. Ky parim fetar, gjykimin e të cilit jemi të detyruar ta zbatojmë, përmban në vetvete edhe disa detaje të tjera, si preferimi i vëllait të fesë para vetes, mos turpërimi i njëri-tjetrit, kujdesi ndaj të drejtave të njëri-tjetrit, etj. Për rrjedhojë, fjalia **“kijeni frikë Allahun, në mënyrë që të mëshiroheni!”**, që përdoret në këtë ajet, në veprën e tefsirit me titull, **“Ruhu’l-Bejan”**, shpjegohet me këto fjalë: **“Kini frikë prej Allahut në lidhje me besnikërinë ndaj marrëveshjeve me vëllezërit tuaj dhe në ruajtjen e të drejtave të njëri-tjetrit si në prezencë, ashtu edhe në mungesë të tyre, si gjatë jetës, ashtu edhe pas**

vdekjes të tyre, në mënyrë që të mëshiroheni.”

Nisur nga kjo, myslimanët mund të jetojnë të qetë dhe në paqe, aq sa arrijnë ta vënë në jetë atmosferën e vëllazërisë, duke u bërë shembull për gjithë njerëzimin në këtë çështje. Për sa kohë të ekzistojë kjo mangësi dhe e metë, grindjet dhe debatet do të jenë të pashmangshme. Dhe, pikërisht në këtë pikë, hyn në lojë edhe gjykimi i ajetit fisnik, ku urdhërohet: **“...(nëse ka ndonjë mosmarrëveshje) pajtojini vëllezërit tuaj!”**

Urdhri që jepet në këtë ajet me anë të fjalës, **“fe aslihu”**, (në bazë të rregullave gramatikore të gjuhës arabe), lë të kuptosh se urdhri për pajtim dhe përmirësim të marrëdhënieve, është diçka që duhet bërë menjëherë. Gjithashtu, urdhri për pajtim/përmirësim, nuk është kufizuar me asgjë. Nga kjo, kuptohet se ky veprim duhet të bëhet vazhdimisht... Sa herë që midis vëllezërve shfaqet ndonjë armiqësi apo mosmarrëveshje, ky urdhër duhet të zbatohet menjëherë. Nisur nga kjo, forcimi i elementëve që forcojnë vëllazërinë fetare, është parim, ndërsa grindja dhe mosmarrëveshja është çrregullim. Mirëpo, për arsye të ndryshme, pothuajse gjithmonë ndodhin grindje dhe konflikte. Madje, kjo mund të kapërcejë edhe kufijtë individualë, duke u përhapur edhe në shoqëri. Ja pra, atë që duhet të bëjmë në këto raste, e shpjegon shumë qartë ajeti paraardhës, në të cilin urdhërohet: **“Nëse dy palë besimtarësh bëjnë luftë midis tyre, pajtojini ata. Por, nëse njëra**

palë sulmon tjetrën, atëherë luftoni kundër sulmuesit, derisa të kthehet në urdhrat e Allahut. E, nëse kthehet, atëherë pajtojini ata midis tyre, me drejtësi dhe paanësi, sepse Allahu i do ata që veprojnë me drejtësi." (Huxhurat, 9)

Duke dashur të vendosë kufirin e dukshëm të vëllazërisë, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: "Myslimani është vëllai i myslimanit. Ai nuk i bën padrejtësi atij dhe nuk e dorëzon tek armiku!.." (Buhari, Medhalim 3.)

Ndërsa për të përkufizuar bashkimin e zemrave, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: "Besimtarët i ngjajnë trupit në dashuri, në dhembshuri dhe në ruajtjen ndaj njëri-tjetrit. Kur një organ i trupit sëmuret, atëherë edhe pjesët e tjera të tij vuajnë pagjumësinë dhe kanë temperaturë." (Buhari, Edeb, 27.)

Kurse porosia profetike në lidhje me ruajtjen e shpirtit të vëllazërisë është: "Mos kini smirë njëri-tjetrit! Mos bëni shitblerje për të ngritur pazarin në dëm të njëri-tjetrit! O robërit e Allahut bëhuni vëllezër! Myslimani është vëllai i myslimanit. Ai nuk e lë pa ndihmë dhe nuk e përçmon atë." Pas kësaj, bëri me shenjë tre herë gjoksin e vet dhe tha: "Devotshmëria është këtu. Njeriut i mjafton si vepër e keqe përçmimi i vëllait mysliman. Çdo mysliman e ka haram gjakun, pasurinë dhe namusin e myslimanit tjetër." (Muslim, Birr, 32.)

Siç shihet, kuadri themelor që na jepet në ajetet fisnike, që është shpjeguar me detaje në hadithet profetike dhe çështjet që duhen pasur kujdes në lidhje me ruajtjen e vëllazërisë, janë dhënë të radhitura në pika. Në bazë të kësaj, vëllazëria ndër-

mjet individëve dhe shoqërive myslimane, është thelbësore. Ndërsa në lidhje me parandalimin e kundërshtive pa vajtur puna deri në konflikt, janë përgjegjës të gjithë myslimanët sipas mundësive.

Këtu duam të theksojmë edhe faktin se, megjithëse Profeti ynë i dashur (a.s.), i njihte mirë hipokritët dhe qëllimet e tyre, ai nuk i zbuloi ata dhe nuk i përjashtoi nga shoqëria. Por përkundrazi, unitetin që arriti në sajë të vëllazërisë ndërmjet ensarëve dhe muhaxhirëve, ia ka lënë trashëgim njerëzimit si një shembull të përjetshëm. Ai ka thirrur duke thënë: "O robër të Allahut, bëhuni vëllezër!" (Ibn Maxhe, v. 10, fq. 32.)

Ne besojmë se bartja e kësaj thirrjeje të shenjtë në ditët tona, është e mundur me anë të zbatimit të urdhrit hyjnor: **"Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) dhe mos u përçani!.."** (Al-i Imran, 103) Gjithashtu, edhe duke respektuar urdhrat dhe ndalesat e Islamit dhe duke vënë në jetë virtytet e larta. Kjo, sepse shumë probleme të cilat duken si të reja, janë thjesht përsëritje të historisë. Dhe zgjidhja e të gjitha problemeve, gjendet në vlerat që thurin besimin tonë -siç është shpirti i vëllazërisë-. Aplikimi i tyre, është gjëja më e drejtë që mund të bëhet edhe ndaj kurtheve që thuren jashtë për të prishur qetësinë tonë.

Lexo-Mendo!

NDIKIMI POZITIV I FJALËS

Shembujt që jepen në Kuran në lidhje me forcën dhe ndikimin pozitiv apo negativ të fjalës, na bëjnë thirrje të kuptojmë përsëri rëndësinë e fjalës. Për shembull, edhe pse fjala e bukur nuk ta largon asnjëherë urinë dhe etjen, Kurani shprehet në mënyrë shumë domethënëse kur urdhëron se: **"Fjala e mirë dhe falja e gabimit janë më të vlefshme se lëmosha që përçillet me fyerje..."** (Bekare, 263)

Duke folur për ata që pretendojnë në mënyrë të pacipë se, "Allahu ka fëmijë", Kurani Fisnik shprehet: **"Kenë thënë diçka vërtet të tmerrshme! Qiejt gati sa nuk copëtohen prej kësaj; Toka gati sa s'çahet e malet sa s'rrëzohen të thërrmuar!"** (Merjem, 89-90) Kjo mënyrë e të shprehurit të Kuranit, bën të ditur se çdo njeri duhet të bëjë kujdes çfarë nxjerr nga goja.

Musai (a.s.), doli përpara superfuqisë së kohës, që ishte faraoni, jo me armë, por vetëm me fjalën e drejtë. Madje, duke qenë i urdhëruar nga Allahu që të flasë me fjalë të buta (kaul-i lejjin) me faraonin. E gjithë kjo, përbën një shembull shumë domethënës në lidhje me këtë çështje.¹

Kur Aisheja ((r.a.)), foli diçka duke aluduar në trupin e shkurtër të Safijes ((r.a.)), i Dërguari i Allahut (a.s.), e qortoi me këto fjalë: **"Ke thënë një fjalë të tillë, që nëse ajo fjalë do të përzihej me detin, do t'i prishte ngjyrën."** (Ebu Daud, Edeb, 35.)

Shembujt në lidhje me ndikimin pozitiv apo negativ të fjalës, është e mundur t'i shtojmë edhe më shumë. Mirëpo të gjitha këto, dëshirojmë t'i përmbledhim me fjalën e Allahut: **"Thuaju, robërve të Mi, që të flasin atë që është më e mira. Në të vërtetë, shejtani mbjell ngatërresa ndërmjet tyre!.."** (Isra, 53)

1. Shih. A'raf, 104; TaHa, 44.

Një ndarje e tillë!

— Ali Riza Temel —

Një raport i publikuar nga kompania kërkimore angleze Oxfam, nxjerr në pah me gjithë lakuriqësinë e vet padrejtësinë në ndarjen e të ardhurave në të gjithë botën. Sipas këtij raporti, 85 personat më të pasur në botë, zotërojnë një pasuri sa pasuria e tre miliardë e gjysmë njerëz në të gjithë botën. Pra, këta 85 persona posedojnë gjysmën e pasurisë së botës.

Në kasën e një prej njerëzve më të pasur të botës, themeluesit të Kompanisë Microsoft, Bill Gates, hyjnë rreth 230 dollar në sekondë. Kjo para është e barabartë me fitimin e 230 personave që punojnë gjithë ditën në kushte shumë të vështira. Në të gjithë botën, 2.5 miliardë njerëz jetojnë me një fitim prej dy dollarësh në ditë, ndërsa një miliardë të tjerë jetojnë vetëm me një dollar në ditë. Sigurisht, nëse kjo mund të quhet jetesë!..

Ndërkohë që shtëpia e njeriut më të pasur në botë ka kushtuar 113 milion dollar, nga ana tjetër, me miliona njerëz jetojnë në rrugë, pa shtëpi, të uritur dimër e verë.

N d ë r s a

shumë të tjerë luftojnë për mbijetesë nëpër çadra e barake, në statusin e refugjatëve. Ndërkohë që çdo ditë vdesin rreth 20 mijë fëmijë nën moshën pesë vjeçare, në kasat e super të pasurve hyjnë gjysmë milionë dollarë në minutë. Çfarë bote është kjo?

Të parët tanë, kanë lënë një shprehje të urtë, që thotë: *"Njëri ha, e tjetri vëren, Kiameti kështu shpërthen!"* Nisur nga kjo, kuptohet qartë shkaku kryesor i luftës, terrorit dhe konflikteve që ndodhin sot në botë. A mund të flitet për paqe, miqësi dhe vëllazëri në një botë ku padrejtësia e të ardhurave ka arritur dimensione kaq të mëdha? Si, dhe me çfarë mund të eliminohen trazirat armiqësia, terrori dhe kaosi që kanë shkaktuar këto padrejtësi dhe këta njerëz lakmitarë që nuk arrijnë të ngopen kurrë?

A mund të sigurohet një rregull i qëndrueshëm në rang botëror vetëm duke përdorur forcën, duke vrarë dhe duke burgosur njerëzit pa siguruar drejtësinë sociale? A do të ketë nevojë për terrorin dhe luftën nëse paratë që shpenzohen për vazhdimin e shfrytëzimit të njerëzve dhe një pjesë e burimeve që ndahet për armatime do të shpenzohej për të siguruar drejtësinë sociale, për të parandaluar urinë dhe për të zhvilluar një standard dinjitoz jetese për të gjithë?

A mund të përhapen ndjenjat e urrejtjes dhe armiqësisë në një botë ku janë të zhvilluara ndërgjegjja, njerëzillëku, ndjenjat morale dhe njerëzore, aty ku gjelbëron mëshira dhe ndjenja e ndarjes së të mirave? A ka kuptim të shkosh të fikësh zjarrin me benzinë në vend që të shkosh me ujë apo shkumë? A

nuk është e qartë se një veprim i tillë do ta ndezë edhe më shumë zjarrin? Për rrjedhojë, ky zjarr i përfshin të gjithë...

Pasuria është si gjaku



që shëtit në trup. Dhe, ashtu siç bëhen gangrenë organet ku nuk arrin gjaku, ashtu edhe pjesët e shoqërisë njerëzore, në të cilat nuk arrin pasuri aq sa duhet, bëhen gangrenë si organet e trupit. Që shoqëria të jetojë e shëndetshme dhe në harmoni, është e domosdoshme që pasuria të arrijë mjaftueshëm në të gjitha pjesët e saj. Islami, këtë e ka siguruar me anë të metodave si zekati, sadaka-ja, shpagimet, borxhi i mirë, vakëfet, trashëgimitë, solidariteti, etj.

Sigurimi i paqes dhe qetësisë, nuk arrihet me forcë, por me drejtësi. Forca pa drejtësi është tirani, ndërsa drejtësia pa forcë është e dobët. Kryesore, nuk është ligji i forcës, por forca e ligjit. Kryesore është të jesh në të drejtën. Forca që nuk mbështetet në të drejtën, në fund ha edhe kokën e vet. Forca që nuk kontrollohet me drejtësi, është shkatërrim.

Nëse fuqia e jashtëzakonshme që ka sjellë teknologjia marramendëse, nuk mbështetet mbi truallin e ndërgjegjes dhe moralit, ajo kthehet në armën e një banditi. Ky është shkaku kryesor i fatkeqësive që po përjetohen. Është e domosdoshme të parandalohet mbledhja e fuqisë dhe pasurisë vetëm në disa duar dhe qendra të caktuara. Prandaj duhet bërë përpjekje për të krijuar një sistem që do ta sigurojë këtë.

Në Islam, mbledhja e pasurisë vetëm në disa duar të caktuara, është e papëlqyeshme. Argument për këtë, është shtrirja e së drejtës së trashëgimisë në një hapësirë të gjerë. Këtë e tregon edhe fakti që plaçka e fituar në luftë, ndahet për Allahun, Profetin, të afërmit e tij, jetimët, të varfrit, udhëtarët e mbetur në rrugë, e kështu me radhë. Kjo ndarje me shtrirje të gjerë, është për shkak që **“ajo (pasuria) të mos qarkullojë vetëm në duart e të pasurve nga mesi juaj”** (shih. Hashr, 7)

Pasi u këshillua me sahabët e tjerë, Omeri ((r.a.)), vendosi që pasuritë e tundshme që përfitoheshin nga luftërat, t'u shpërndaheshin veteranëve në statusin e plaçkës së luftës, ndërsa tokat dhe burimet ujore të mos ndaheshin dhe, të ardhurat e siguruar prej tyre të kalonin në thesarin e shtetit. Këtë vendim ia dërgoi me shkrim Sa'd b. Ebu Uakkasit, me qëllim që ta zbatonte. Kalimi i fitimeve prej tokave në thesarin e shtetit si të ardhura, kishte për qëllim shtimin e të ardhurave publike, parandalimin e mbledhjes së pasurisë në duar të caktuara dhe përhapjen e drejtësisë dhe mirëqenies sociale në masa më të gjera të popullit.

Në Islam, shteti ka përgjegjësinë t'i sigurojë të gjithëve një standard jetese, ku mund të jetojë të paktën me kushtet minimale njerëzore. Në shoqërinë Islame, nuk ka vend botëkuptimi, “ligjin e bën më i forti”. Të gjithë janë përgjegjës ndaj njëri-tjetrit. Një mysliman, është i detyruar të kujdeset për të gjithë fqinjët çfarëdo feje apo kombësie të kenë. Delikatesën e kësaj çështjeje, i Dërguari i Allahut (a.s.), e ka shprehur me këto fjalë: **“Ai që fle me barkun**

plot duke e ditur se fqinji i tij është i uritur, nuk është besimtar i vërtetë.” (Munziri, Tergib, 3/258.)

Enes b. Malik ((r.a.)), transmeton se, një person erdhi tek i Dërguari i Allahut (a.s.) dhe i tha: **“O i Dërguari i Allahut! Më vish!”** I Dërguari i Allahut (a.s.), e pyeti: **“A nuk ke ndonjë fqinj që i ka dy palë rroba?”** Kur ai person tha: **“Kam o i Dërguar i Allahut!”**, atëherë Profeti (a.s.), tha: **“Allahu mos e bëftë fqinj me ty në Xhenet, atë fqinj që ka dy palë rroba dhe nuk të vesh!”** (Tergib, 3/259.)

Ndërsa Allahu i Madhëruar, faktin se të gjithë janë përgjegjësi për të gjithë, e shpreh në këtë mënyrë:

“Adhuroni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim); silluni mirë me prindërit, të afërmit, jetimët, të varfrit, fqinjët e afërt dhe të largët, me atë që keni pranë, me udhëtarin (që ka mbetur ngushtë) dhe me ata që janë robër nën pushtetin tuaj. Në të vërtetë, Allahu nuk i do njerëzit arrogantë e mburrave; (e as) ata që janë koprracë, të cilët kërkojnë që edhe të tjerët të bëhen koprracë dhe fshehin atë që ua ka dhuruar Allahu nga mirësitë e Tij. Ne kemi përgatitur për mohuesit ndëshkim poshtërues. (Ai nuk i do) as ata që ndajnë nga pasuria e tyre sa për sy e faqe të botës dhe që nuk e besojnë Allahun e as Ditën e Kiametit. Ai që ka për shok djallin, dihet sa shok i keq është!” (Nisa, 36-38)

Në përgjithësi, pasuritë të cilat nuk përdoren për t'u kujdesur për të varfrit dhe nevojtarët, fitohen në mënyra haram dhe po në të njëjtën mënyra harxhohen. Pasuritë që shpenzohen vend e pavend, për dukje dhe lazdrim, e shtojnë edhe më tepër varfërinë dhe armiqtësinë. Të varfrit, janë të varfër aq sa është shpërdorimi i të pasurve. Nëse do të përdroreshin në mënyrë normale, burimet që gjenden në tokë, do të arrinin të ushqenin shumë më tepër njerëz se ç'ka bota sot. Mirëpo, në sofrën e ujqërve nuk ka vend për qengjat, e mbi të gjitha, qengjat bëhen ushqimi i tyre.

Ata që rendin pas shpërdorimit dhe dukjes, janë njerëz të mjerë. Personalitetin dhe nderin e vërtetë që nuk arrijnë ta fitojnë me dinjitet, këta përpiqen ta fitojnë me shfaqje dhe virtyte të rreme.

Ata që rendin marrëzisht për të shumëfishuar pasurinë që kanë fituar me konkurrencë të pander-shme dhe mënyra haram, nuk janë të vetëdijshëm se po shkojnë drejt shkatërrimit, sepse dehja e pasurisë jua ka marr mendtë.

Nëse do të fitonin me ndershmëri në mënyra hallall dhe nëse do ta shpenzonin pasurinë për të fituar zemrat dhe lutjet e të tjerëve, në vend që ta shpenzonin për të kënaqur ambiciet e tyre, ata do të kishin arritur fitimin e vërtetë dhe lumturinë e fitimit të kënaqësisë së Zotit, i Cili ua ka dhënë ato mundësi për t'i sprovuar. Mirëpo, këta të mjerë, fitimin e vërtetë e pandehin humbje, ndërsa humbjen e vërtetë e pandehin fitim. Sa bukur e ka thënë një filozof indian: **“O Zot! Unë që nuk kam asgjë**

tjetër veç Teje, ndjej keqardhje për ata që kanë çdo gjë përveç Teje!” Gjithë këtë, e përmbledh edhe më bukur kjo shprehje e urtë e Ataullah Iskenderit: “E çfarë humbi kush të gjeti Ty, e çfarë gjeti kush të humbi Ty?”

Ata që humbasin kënaqësinë e Allahut, dashurinë dhe lutjet e njerëzve, zëre se nuk kanë fituar asgjë. Në fund të fundit, fitimet pa kënaqësinë e Allahut, shndërrohen në humbje.

“...Ata që grumbullojnë ar dhe argjend dhe nuk e shpenzojnë për hir të Allahut, paralajmëroji me dënim të dhembshëm. Do të vijë dita, kur (thesaret e mbledhura) do të digjen në zjarrin e Xhehenemit dhe me to do të damkoset balli, anët dhe shpina e tyre e do t’u thuhet: “Kjo është ajo që keni grumbulluar për veten; pra, shijoni atë që grumbulluat!”” (Teube, 34-35)

“Ditën, kur ata që kanë mohuar do të vihen para Zjarrit (do t’u thuhet): “Ju keni shfrytëzuar gjithë të mirat në jetën tuaj tokësore dhe jeni kënaqur me to, ndërsa sot do të ndëshkohej me dënim poshtërues, sepse keni qenë arrogantë në Tokë pa kurrfarë të drejte dhe nuk i jeni bindur Allahut.”” (Ahkaf, 20)

Pasuria dhe mundësitë, janë vetëm mjete sprove. Kryesore është që fitimi të jetë hallall. Pasuria që fitohet dhe shpenzohet në rrugë hallall, është e shenjtë.

Sipas **sheriati** Islam; “Pasuria jote, është e jotja. Pasuria ime, është e imja.” Sipas **tarikatis**, “Pasuria jote është e jotja. Pasuria ime është e jotja.” Sipas **hakikatit**, “As e jotja, s’është e jotja dhe as e imja, s’është e imja. Gjithçka është e Allahut.” Ndërsa sipas kapitalizmit të egër, “Pasuria ime, është e imja, por edhe pasuria jote është e imja.” Ky botëkuptim pra është shkaku i luftës dhe kaosit. Ky botëkuptim i ka shndërruar njerëzit në qenë që vijnë vërdallë pas një kocke dhe në zogj grabitqarë që luftojnë për një kërmë.



Ç'loj bote!?

— Ali Byjyqçapar —

Kjo botë, është ara e botës tjetër. Vallë çfarë vendi zë në jetën tonë kjo shprehje e urtë, kuptimi i së cilës është zgjeruar shumë brenda shekujve?

Ambientet e jetës moderne, qytetet dhe dhjetëra pengesa kanë hyrë midis nesh dhe tokës. Me mijëra njerëz që jetojnë në qytete të mëdha, nuk janë të vetëdijshëm se çfarë do të thotë tokë dhe për gjallërinë që ka ajo. Fjalët e urta mund të ndryshojnë kuptimin e tyre në kohë dhe ndonjëherë mund të dalin në pah kuptime krejt të kundërta.

Kurani Fisnik, kur flet për vendin ku zhvillohet jeta, përdor fjalën “Ard”, por, me këtë nuk ka për qëllim “dunjanë/botën”, e cila do të thotë jetë! Bota jonë është një vend gjeografik dhe një amanet i Allahut, e cila duhet studiuar, gjallëruar, mbrojtur dhe zbukuruar.

Një botë që nënçmohet!

Gjithmonë dëgjojmë dhe habitemi kur flitet për “një botë të pavlerë”, së cilës duhet t’i kthesh kurrizin, që është më e pavlefshme se krahu i një mize apo se një çap i ngordhur me veshë të vegjël. Harmonia ndërmjet të kundërtave, këtu tregon urtësinë e vet.

Të jepesh vetëm pas kësaj bote, apo vetëm pas asaj bote, nuk është diçka e pëlqyeshme në aspektin Islam. Në këtë pikë, ekuilibri është shumë i rëndësishëm. **“Përpiku me atë që të ka dhënë Allahu të fitosh jetën e botës së ardhshme, duke mos harruar pjesën tënde në këtë botë!..”** (Kasas, 77)

Shpesh dëgjojmë se kjo botë është një lojë dhe argëtim, stoli, shkak për mburrje ndër njerëz, dëshirë për pasuri e fëmijë, diçka mashtruese, etj. Por, në lidhje me faktin se çfarë duhet të bëjmë, nuk ia kemi shumë idenë.


Kur kuptojmë se Suneti i Profetit tonë (a.s.), na e freskon zemrën duke na njoftuar se këto ajete janë në lidhje me ata që përveç kësaj bote nuk besojnë në botën tjetër dhe se janë të lidhur pas kësaj bote deri në adhurim, marrim frymë thellë dhe përpiqemi të shohim se cila është detyra jonë.

Kjo botë është krijuar për besimtarët. Njerëzit kanë përgjegjësinë ta ndërtojnë këtë botë dhe, feja jonë, është për këtë botë! Të kuptosh gjithçka që ndodh, është çështje urtësie.

Por cila është zgjidhja?

Zgjidhja është që njeriu të kapet pas dijes së shpalljes hyjnore që i ofrohet dhe të mos e shohë metafizikën si një iluzion. Njeriu duhet ta njohë Allahun dhe veten e tij me cilësitë përkatëse dhe të dijë se kush është burimi i jetës. Njeriu është i nxituar, lakmitar, me natyrë të tillë që nuk mund ta mbizotërojë veten përballë dëshirave të egos dhe me potencialin për të shkatërruar dhe derdhur gjak në tokë. E megjithatë, Allahu i Madhëruar i ka dhënë vlerë atij, i ka fryrë shpirtin që është pronë e Tij, e ka bërë mëkëmbësin e Vet në tokë dhe e ka lënë atë vetëm për vetëm me sprovën e devotshmërisë, e cila është edhe urtësia e krijimit të tij.

Pra, kur e vërteta është kështu, si mund ta nënçmojmë botën? A nuk është ky një problem mbi të cilin duhet të mendohet çdo njeri dhe të gjejë zgjidhje?



FOL ME ZEMËR JO ME GJUHË

— Mehmet Dinç

Ndonjëherë, seriozisht e kam shumë të vështirë t'i kuptojë disa njerëz. Ato që kam të vështira t'i kuptoj, më tepër se sjelljet, karakteri ose zakonet e tyre, janë temat që flasin, ose më mirë të themi, mënyra e diskutimit të temave që flasin.

Uleni ballë përballë me një person për të diskutuar rreth një çështjeje dhe filloni të flisni. Çdo gjë që keni në zemër e vendosni në gjuhën tuaj me gjithë shpirt dhe prej bashkëbiseduesit tuaj prisni që edhe ai të jetë i sinqertë, së paku aq sa ju. Mirëpo, sapo mbaroni fjalën dhe tjetri që keni përballë fillon të flasë, e kuptoni që në fjalinë e parë që pritshmëritë tuaja janë të pamundura të realizohen. Kjo, sepse ju e kuptoni prej syve të bashkëbiseduesit tuaj që kur ai fillon të harxhojë fjalitë e para, se ato që ai po thotë, nuk janë prej zemrës së tij.

Ai sikur flet ndonjë gjuhë të huaj. Nëse dëgjoni gjuhën e tij, është e pamundur të kuptoni se çfarë dëshiron të thotë. Por nëse ndiqni sytë e tij, ose lëvizjet e trupit të tij, “në fakt” mund të perceptoni atë që dëshiron të thotë. Ah sikur të mos e lodhni fare gjuhën dhe të komunikoni me sy!.. Atë çast, njeriut i vijnë në mendje fjalët e një kënge të njohur, në të cilën thuhet: “Hesht, mos thuaj asgjë! Hesht le të flasin sytë e tu!”

Ka shumë arsye të këtij lloj qëndrimi. Disa, për shkak se i qasen me dyshim çdo njeriu dhe çdo ndodhie, nuk mund t'i vendosin në gjuhë ato që kanë në zemër. Ata pandehin se njeriu që kanë përballë, do të përpiqet të gjejë ndonjë dobësi në ato që thonë, ose nëse gjen ndonjë të dhënë në lidhje me ndonjë sekret që ata dëshirojnë ta mbaj të fshehtë, mund ta përdorë në dëm të tyre. Për këtë arsye, ata flasin gjithmonë duke e censuruar veten. Mbase pa e ditur fare se janë armiq të më të mëdhenj të vetvetes dhe pa e menduar aspak se po punojnë vet kundra vetes...

Disa të tjerë, nuk arrijnë t'i thonë ato që dëshirojnë, për shkak se nuk i besojnë pastërtisë së zemrës së tyre. Në fakt, ato që dëshirojnë t'i thonë bashkëbiseduesit, janë krejt ndryshe nga ato që i thonë. Por për shkak të interesave, ata nuk dëshirojnë ta reflektojnë në gjuhën e vet ligësinë ndjenjave të veta. Ata mendojnë se njeriu që kanë përballë do t'u besojë përzemërsisë së tyre dhe se nuk do t'i vërë re mendimet e liga që kanë në zemër. Por ata nuk e dinë se ekziston një rrugë nga zemra në zemër dhe se në atë rrugë nuk shkojnë ato që janë në gjuhë, por ato që janë në zemër.

Disa të tjerë, e përdorin këtë mënyrë për shkak të mungesës së guximit. Edhe nëse zemra e tyre është e pastër, për shkak të pamjaftueshmërisë së vetëbesimit, ata nuk arrijnë t'i shprehin asnjëherë ato që dëshirojnë të thonë. Diçka i pengon dhe çdo gjë u mbetet në gjuhë. Ata arrijnë ta çojnë nga zemra në mendje, por kur dëshirojnë ta çojnë deri në gjuhë, aty detyrohen të kthehen mbrapsht dhe, për shkak të kthimit të papritur, ata flasin gjëra pa lidhje, të cilat nuk dëshirojnë t'i thonë aspak. Më pas, kur ato që u dalin prej gjuhës u shkojnë në vesh të vet, fillojnë e nxehen me vetveten.

Për çfarëdolloj arsye qoftë, mua më duken gjithmonë dyfytirësh dhe interesaxhi ata që gjuha dhe zemra e tyre u flasin ndryshe. Për këtë arsye, nuk arrij t'i dua këta njerëz. Sado të mbushura me lavde qofshin ato që thonë me gjuhët e tyre, sado shprehje të përzemërta dhe fjalë dashurie të përmbajnë ato, kur unë shoh atë që reflektohet prej zemrave në sytë e tyre, bëhem akull karshi tyre.

Atë çast dua t'u hakërrehem e t'u them, “flisni me zemër, jo me gjuhë!”. Por, e di se as këtë nuk janë të aftë ta bëjnë, sepse gjuha e zemrës së tyre është memece, për shkak se ata nuk e kanë përdorur atë për një kohë të gjatë. Për këtë arsye, unë u qëndroj larg atyre njerëzve. Përpiqem të mos u afrohem, të mos qëndroj në bisedat e tyre dhe t'i ul në nivelin më të ulët marrëdhëniet me ta. Nëse për çfarëdolloj arsye jam i detyruar të flas me ta, i shkurtoj fjalët dhe i zgjas shikimet e mia për të thënë ato që kam në zemër. Dëshiroj që edhe ata të shpëtojnë nga këto sëmundje dhe të thonë çfarë kanë në zemër pa censuruar asnjë fjalë.



SHOKU I UDHËS

— Doç. dr. Kerim Bulladë —

Shoqëria dhe formimi i saj, është një realitet i pashmangshëm i jetës njerëzore, sepse njeriu është qenie shoqërore dhe është i detyruar të jetojë në shoqëri. Në gjuhën arabe, fjalët shok dhe mik, shprehen me fjalët, “*halil*”, “*sadik*” dhe “*rafik*”.¹ Në Kuranin Fisnik, këto fjalë janë përdorur në kontekste të ndryshme.² Në gjuhën tonë, kjo fjalë përdoret në fusha të ndryshme të jetës, si shokë shkolle, shokë pune, shokë ushtrie, shokë lagjeje, shok jete, etj.

Një fjalë e urtë thotë: “*Më thuaj me kë rri, të të them cili je!*” Kjo thënie na kujton hadithin e Profetit tonë (a.s.), i cili thotë: “*Njeriu është në fenë e shokut të tij. Prandaj secili prej jush duhet të bëjë kujdes se me kë shoqërohet!*” (Tirmidhi, Zuhd, 45.)

Shoqëria ka një rëndësi të madhe edhe në çështjet e kësaj bote, edhe në çështjet e botës tjetër. E thënë ndryshe, ajo ka rëndësi të madhe si në fitimin e lumturisë në këtë botë, ashtu edhe në fitimin e lumturisë në botën tjetër. Në këtë shkrim, do të trajtojmë më tepër dhe shkurtimisht çështjen e shoqërisë/miqësisë që përmendet në Kuran.

Besimtarët, përsërisin vazhdimisht këto lutje të sures Fatiha, në çdo rekat, në faljen e pesë kohëve të namazit, në faljen e xhumasë, bajramit dhe të çdo lloj namazi tjetër vullnetar:

“(O Zot!) Udhëzoni në rrugën e drejtë! Në rrugën

1. shih. Ebu Bekir b. Abdulkadir er-Razi, Muhtarut's-Sihaha, Daru'l-Marife, Bejrut, 2010, fq. 179, 232, 322.

2. shih. Nisa, 4/69, 125; Furkan, 25/28; Shuara, 26/101. etj.

***e atyre që u ke dhuruar mirësi e jo në të atyre që kanë shkaktuar zemërimin Tënd, as në të atyre që janë të humbur!*” (Fatiha, 6-7)**

Në shikim të parë, në lidhje me përmbajtjen e këtij ajeti mund të lindë një pyetje e tillë: “*Një besimtar fal namaz për shkak se beson. Pra, a nuk janë në rrugë të drejtë këta besimtarë që e falin namazin, i cili është shtylla e dytë kryesore e Islamit pas “Kelime-i Teuhidit” dhe që është urdhëruar si farz, jo në tokë, por në qiell (në miraxh)? Përse i luten Zotit dhjetëra herë në ditë që t’i udhëzojë, duke thënë: “Na udhëzo në udhën e drejtë!”*”?

Për të shpjeguar një pyetje të tillë që mund të vijë në mendje, komentuesit e Kuranit, fjalën “*ihdina/na udhëzo*”, e kanë komentuar në kuptimin: “*Na e shtu udhëzimin! Na i forco këmbët në rrugën e qartë të Islamit dhe Kuranit! Na frymëzo me rrugën e drejtë të fesë!*”³

Domethënë se, në çdo rekat të namazeve që fal, besimtari i kërkon Allahut, i Cili i ka dhuruar besimin, ta bëjë të qëndrueshëm në Islam/Kuran dhe të mos e lejojë t’i rrëshqasë këmba nga rruga e

3. shih. Bejdau, Nasiruddin Ebu Said Abdullah b. Omer el-Bejdau, Enuaru't-Tenzil ue Esraru't-Te'u'il, (Kitab Mexhmua mine't-Tefasir), Bejrut, ts. I, 30; Nesefi, Ebu'l-Berakat Abdullah b. Ahmed, Medariku't-Tenzil ue Hakaiku't-Te'u'il, (Kitabun Mexhmua mine't-Tefasir) Bejrut, ts I, 30; Hazin, Alauddin Ali b. Muhammed b. Ibrahim, Lubabu't-Te'u'il fi Meani't-Tenzil, Bejrut, ts. (Kitabun Mexhmuatun mine't-Tefasir), I, 30; Sheukani, Muhammed b. Ali b. Muhammed esh-Sheukani, Fethu'l-Kadir el-Xhamiu bejne Fenneji'R-riuajeti ue'd-Dirajeti min Ilmi't-Tefsir, Tas'hih, Ahmed Abdusselam, Bejrut, 1994, I, 26.

drejtë. Kjo, sepse është një fakt i vërtetë se shumë njerëz përjetojnë dobësi/plogështi dhe largim nga rruga e drejtë, pas fitimit të pozitave, gradave dhe titujve të kësaj bote. Në këtë kuadër, kjo lutje bart një rëndësi të madhe në jetën e çdo besimtari: **“O Zoti ynë! Mos lejo që zemrat tona të shmangen (nga e vërteta), pasi na ke udhëzuar në rrugën e drejtë, dhe jepna mëshirë prej Teje; vërtet, Ti je Dhuruesi i Madh!”** (Al-i Imran, 8)

Në pjesën e lutjes, **“Në rrugën e atyre që u ka dhuruar mirësi”**, që përdoret në ajetin 7 të sures Fatiha, theksohen qartë robërit që janë në rrugën e drejtë, të cilëve Allahu i Madhëruar u ka dhuruar mirësi. Në shpjegimin e këtij ajeti, në tefsirë të ndryshëm, tërhiqet vëmendja edhe në ajetin 69 të sures Nisa⁴, ku janë bërë të ditur ata, të cilëve Allahu u ka dhënë mirësi dhe shprehet se ata janë shokë shumë të mirë: **“Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit, do të jetë me ata të cilëve Allahu u ka dhënë shumë dhunti: me profetët, me të sinqertët, me dëshmorët dhe me të drejtët! Eh sa shokë të mrekullueshëm janë këta!”**

Ky shpjegim, tregon se kur besimtari fal namaz, kërkon dhe zgjedh me këmbëngulje shokët e përgjithshëm. Ashtu siç kuptohet qartë edhe prej ajetit, kategoria e shokëve të parë, janë të dërguarit e Allahut, të cilët Ai i ka zgjedhur dhe u ka dhënë shpalljet. Këta kanë sjellë civilizimin në tokë dhe janë angazhuar gjithmonë me udhëzimin, edukimin dhe përmirësimin e njerëzimit. Kategoria e dytë, janë besimtarët e fortë, që e aprovojnë pa ngurruar aspak ekzistencën e Allahut, njëshmërinë e Tij dhe profetët që Ai ka dërguar. Kategoria e tretë e shokëve, janë besimtarët e zgjedhur që besojnë dhe e zbukurojnë jetën e tyre me vepra të mira, të sinqerta dhe të bukura. Kategoria e katërt, janë dëshmorët, të cilët e sakrifikojnë gjënë e tyre më të çmuar, jetën, në rrugë të Allahut.

Atyre që i falin namazet në mënyrë të rregullt që prej moshës së pjekurisë, e deri sa dorëzojnë shpirtin e tyre, shpresohet prej Allahut të madhëruar, i Cili ua ka urdhëruar namazin, që t’u pranohen këto lutje të sinqerta që i bëjnë me dhjetëra herë në ditë. Allahu i Madhëruar, ata të cilët pasi kanë besuar, e falin namazin në mënyrë të rregullt, u ka dhënë shpërblimin e zgjedhjes së shokëve të përgjithshëm që në këtë botë të përkohshme. Vetëm kjo do të mjaftonte për të treguar se sa detyrë e rëndësishme dhe madhështore është namazi. Në namaz, besimtari i lutet Allahut të Madhëruar për t’u bërë shok me njerëzit më të zgjedhur të Tij, i kërkon të hyjë në rrugën që ndjekin ata dhe të jetë i qëndrueshëm në atë rrugë.

Në fund të ajetit 69 të sures Nisa, përdoret shpreh-

ja: **“...Eh sa shokë të mrekullueshëm janë këta!”** Kjo tregon qartë se këta e meritojnë të jenë shok e miq të vërtetë. Për këtë arsye, besimtarët duhet të garojnë për të krijuar shoqëri me njerëzit të cilët ua mësojnë fenë, i këshillojnë dhe ua kujtojnë botën tjetër. Nëse besimtari thur gjithmonë shoqëri e miqësi me besnikët, njerëzit e mirë dhe me ata që do ta ndihmojnë të fitojë Xhenetin, kjo do të kontribuojë në ndërtimin e jetës së tij fetare dhe për t’u bërë njeri i drejtë dhe i moralshëm. Madje, ky është një kusht i domosdoshëm i besimtarit dhe një kërkesë e rëndësishme e besimit.

Në Kuranin fisnik, në lidhje me rolin devijues të shokut të keq dhe pendimit që do të ndjejnë në botën tjetër ata që zgjedhin shokë të këqij, urdhërohet:

“Atë Ditë keqbërësi do të hajë gishtat e duarve të veta, duke thënë: ‘Ah, sikur ta kisha marrë rrugën (e drejtë) me të Dërguarin! Ah, sikur të mos e kisha bërë filanin mik! Ai më ka larguar nga Këshilla (Kurani) që më kishte ardhur!’ Në të vërtetë, shejtani e braktis gjithmonë njeriun në çastin e nevojës. Dhe i Dërguari do të thotë: ‘O Zoti im! Populli im e shpërfilli Kuranin, si (diçka) të urryer’.” (Furkan, 27-30)

Ndërsa në suren Saffat, theksohet se banorët e Xhenetit do të shpërblehen me mirësi të ndryshme, duke na dhënë edhe një skenë dialogu të tillë, në të cilën një prej banorëve të Xhenetit tregon në lidhje me një shokun e vet që e mohonte ringjalljen:

“Ata do t’i qasen njëri-tjetrit e do të bisedojnë. Dhe njëri prej tyre do të thotë: ‘Unë kam pasur një shok, i cili më thoshte: ‘Vallë, edhe ti je nga ata që besojnë se, kur të vdesim e të bëhemi eshtra e pluhur, do të japim llogari vërtet?!’ A doni ta shikoni (atë që më qortonte për shkak të besimit tim)?’ Dhe ai do të shikojë poshtë dhe do ta shohë atë në mes të Zjarrit flakëruar e do t’i thotë: ‘Për Allahun! Për pak më shkatërrove edhe mua.’” (Saffat, 50-56)

Vendi ku do të fitohen shokët e mirë e të përgjithshëm, është kjo botë, në të cilën jemi dërguar për t’u sprovuar. Arritja e kësaj, është e mundur me besimin Islam dhe me shtyllën e tij, që është namazi. Nuk duhet të harrojmë asnjëherë, se mënyra për të fituar shokë të mirë e të përgjithshëm në botën tjetër, për të cilët flet Kurani, kalon vetëm prej shoqërimit në këtë botë me robër të mirë që ndodhen në rrugën e drejtë. Ne kemi nevojë për shokë udhëtimi si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër. Kjo nevojë është edhe arsyeja që Allahu i Madhëruar ka dëshiruar që ne t’i lutemi e t’i përgjerohejmë vazhdimisht në namaze, që të ndjekim rrugën e njerëzve të mirë dhe të qëndrojmë larg prej të këqijve dhe të devijuarve.

4. Hazin, e njëjta vepër I, 31; Sheukani, e njëjta vepër., I, 27.

"Kjo edhe nuk është kohë e mirë,
dhe ju nuk mund të kuptoni se ndonjëherë kishte njerëz të mirë..."

(Alijaga Karabeg)

Njeriu i mirë dhe Urtësia

(Urtësia, dituria dhe informacioni)

— Azmir Jusufi —

Ne sot jetojmë në një kohë të progresit dhe zhvillimit të madh, kohën e kulmimit të teknologjisë dhe arritjeve të saja. Çdo kohë ka rrjedhën e saj, "koritën e saj" në të cilën rrjedh sikur uji i burimit. Ne nuk kemi asgjë kundër kësaj kohe të teknologjisë, mirëpo, ajo ka shumëçka të drejtuar kundër nesh. Kjo epokë e ka anën e saj pozitive, megjithatë, ajo fsheh anën tjetër të saj të cilën është vështirë ose e pamundur që të kuptohet. Kjo epokë e teknologjisë i ngjan një pasqyre, ne e shohim veten në pasqyrë ashtu si na e paraqet ajo, por, e njëjta ajo pasqyrë e fsheh dhe nuk e tregon anën e saj të kundërt - e cila paraqet realitetin tonë të njëjtë.

Sot, në kohën në të cilën jetojmë, dëshirojmë të arrijmë gjithçka, sikurse thotë populli "të gatshme", e gjitha e shërbyer e gatshme "si në pjatë."

Koha në të cilën jetojmë është një kohë e informacioneve dhe arritjeve teknologjike, madje, deri në masën që edhe njohuritë shkencore janë reduktuar në informacione të thjeshta dhe të avashta. Sikurse ka thënë profesori në FSHI në Sarajevë, dr. Enes Kariq, në një emision televiziv: "*Dikur ishte urtësia (mençuria) të cilën e harruam me diturinë, e më pastaj diturinë e zëvendësuam me informacione...*"

Si të mos jetë gjendja çfarë është dhe çfarë e përjetojmë, kur gjithmonë e më shumë dituria dhe urtësia marginalizohen, kur urtësia lihet mënjanë dhe më shumë i jepet prioritet informacioneve të thjeshta të shërbyera për ne në pajisje më të reja teknologjike të kohës. I mbaj mend edhe fjalët e profesorit tjetër po nga FSHI-ja në Sarajevë, të kurra hafëzit dr. Xhevad Shoshiqit, i cili me një rast na patë thënë: "Sot, si kurrë më parë shkruhen dhe përkthehen libra fetarë,

por më pak ka lexues për t'i lexuar këto libra." Në të vërtetë është kështu, për fat të keq, prandaj duhet ditur se "dituria" dhe "urtësia" fitohen vetëm me leximin e librave dhe në asnjë mënyrë tjetër, por, sot kjo gjë është bërë si "e mërzhitshme".

Në fillim të këtij teksti, me shkas e kemi përmendur thënien e Alijaga Karabegut, një plaku të urtë dhe të devotshëm i cili ka jetuar në kohën e fëmijërisë së autorit të mirënjohur boshnjak Alija Nametak. Ky autor në librin e tij "Tregimet e Ramazanit" e përmend shembullin e shkëlqyer të Alijaga Karabegut, i cili kishte jetuar në qytetin Mostar të Bosnje e Hercegovinës, dhe jetoj njëqind e dhjetë vjet. Kur disa ditë para pushtimit të Bosnje e Hercegovinës (në v. 1878) turma e përflakur e likuidoi myftiun Karabeg, i cili nuk ka dhënë pëlqimin e tij për t'i rezistuar hyrjes së Austro-Hungarisë, plaku Alijaga u largua nga Mostari në fshatin Uzariqi, ku mbeti për dyzet vjet. Pas viteve që kaloi në fshatin e përmendur, Alijaga kthehet në Mostar, por krejtësisht i zhgënjyer me çdo gjë që kishte parë tani aty. Shtrohet pyetja se çfarë kishte parë në Mostar e që e zhgënjëu aq shumë? Qyteti ka ndryshuar, njerëzit kanë ndryshuar, zakonet janë bërë ndryshe. Është venituri imazhi i qytetit të vjetër me shtëpi të vogla e me çati prej guri, përplot me hoxhallarë e haxhilerë, me fese e çallma mbi krye... Nuk ka më tubime sikur kishte dikur - nuk ka më tregime plot urtësi... Me një fjalë, kishte kuptuar se gati se urtësia është zhdukur nga ai qytet...

Po në të njëjtin libër autori në fjalë, përmend shembullin e një njeriu të zgjuar dhe të mirë, ndërsa të

1. Alija Nametak, *Ramazanske price*, „Kaligraf“, Sarajevo, 1992, f. 5-8.

tjerët e konsideronin si njeri të furishëm. Ky njeri është quajtur Mehmed Hindo, i cili ishte pak njeri “në dorën e vetë”. Shtëpia e tij ishte e agallarëve të vjetër, të cilët kishin vende të bukura dhe bujkrobërit, por ai kurrë nuk donte të hante nga ajo që sillnin bujkrobërit në shtëpi. Atë që sillnin bujkrobërit dhe për çfarë të gjithë thoshin se është e fituar “me të drejtë” ai e quajti “pa të drejtë”, sepse, sipas tij, nuk është e drejtë që ata të punojnë kurse të tjerët të hanë frytet e punës së tyre. Ky njeri i urtë nuk kishte ndonjë zanat, por, kishte nevojë që të jetojë, dhe vendosi që të enjteve në mbrëmje (d.m.th. në prag të së premtes) të vizitojë shtëpitë e hoxhallarëve, mualimëve dhe myderrizëve, të cilët ishin dhjetë prej tyre në qytet, dhe u kërkoi atyre që t’i përgatisin pite: byrek me mish, me djathë, me patate, etj.

Shtrohet pyetja, përse Hindo nuk pranoi të hajë nga ajo që sillnin bujkrobërit kurse pranoi të kërkojë nga personalitete fetare, nga ajo që kanë fituar prej duarve të tyre? Përgjigja është e thjeshtë, Hindo besonte dhe ishte i bindur se hoxhallarët fitonin me të drejtë dhe në mënyrë të ligjshme, dhe donte që të hajë vetëm prej punës së tyre. Natyrisht, prej këtij gjesti kuptojmë se me të vërtetë ishte njeri i mençur dhe i urtë, edhe pse atë e trajtonin ndryshe në vendin e tij.

Ne, në veçanti sot, kemi nevojë që të marrim shembuj/ibret dhe mençuri/hikmet prej njerëzve dhe shembujve të këtyllë, nga stërgjyshërit dhe gjyshërit tanë të cilët janë munduar që të fitojnë kafshatën e bukës në mënyrë të drejtë e të ligjshme e që t’i ushqejnë fëmijët e tyre në mënyrë hallall dhe të drejtë. Ne sot, shohim dhe jemi dëshmitarë se disa edhe prej “myslimanëve” nuk ia vunë veshin kësaj çështjeje, nuk i shqetëson se si fitojnë kafshatën e bukës dhe si i ushqejnë fëmijët e tyre, kurse kur të shfaqet ndonjë problem në familjet e tyre nga ana e fëmijëve, ata ia gjuajnë fajin fëmijëve, kurse vetë problemi qëndron tek ata si prindër të tyre sepse nuk janë menduar me kohë se si i ushqejnë fëmijët e vetë.

Ta kujtojmë hadithin e Muhamedit (a.s.), të cilin e shënojnë Buhariu dhe Muslimi, ku thuhet: *“Pejgamberi (a.s.), tregon për një njeri që ishte në udhëtim, i cili kishte flokët të pluhurosura, i ngre duart nga qielli dhe thotë: “O Zoti im! O Zoti im!” Ushqimi i tij është haram, pija e tij është haram, veshja e tij është haram dhe ai është i zhytur në haram. E si t’i përgjigjet Allahu këtij njeriu?!²*

Si mund të jenë të lumtur dhe si mund të ndiejnë kënaqësinë e adhurimit ndaj Zotit të Plotfuqishëm përderisa marrin rryshfet, merren me kamatën, iu bëjnë padrejtësi njerëzve?³

2. Hadithin e shënon imam Muslimi në *Sahihun* e tij.

3. Vjollca Shaban Braka, *Ushqimi i shpirtit në fenë islame*, NUN, Tiranë, 2017, f. 146.

Nuk ka dyshim se ata që ushqehen me haram, nuk mund ta adhurojnë Allahun, dhe krekosen me këto fjalë boshe që thonë. Kjo krekosje e tyre vlen vetëm për jetën e kësaj bote. Në Ditën e Gjykimit, kur të vijë momenti që ata do të ndahen nga besimtarët e sinqertë dhe të devotshëm, atyre do t’u thuhet: **“E tash, o ju kriminelë, ndahuni! O bijtë e Ademit (kriminelë), po a nuk ua dërgova porosinë që të mos e dëgjoni djallin, se me të vërtetë ai është armiku juaj i hapët!? (Ju porosita) Të më adhuroni Mua, se kjo është rruga e sigurt! Vërtet, ai ka humbur shumë njerëz prej jush, a nuk mblodhët mend?”⁴**

Buhariu dhe Muslimi transmetojnë nga Numan Ibn Beshiri (r.a.), se Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *“Hallalli është i qartë e po ashtu edhe harami është i qartë, ndërkohë që mes tyre ka gjëra të paqarta, të cilat nuk i dinë shumica e njerëzve. Andaj kush ruhet nga gjërat e dyshimta e ka ruajtur fenë dhe nderin e vet. Ndërsa kush bie në to, ka rënë në haram. (Kjo është) ngjashëm me çobanin që e kullot bagëtinë përreth tokës së ruajtur (të dikujt tjetër); nga çasti në çast pritet që bagëtia e tij të futet aty... Vërtet se në trupin e njeriut është një copë mishi, e cila nëse është e shëndoshë, edhe trupi tërësisht do të jetë i shëndoshë. E, nëse prishet, edhe trupi tërësisht do të prishet. Ajo (copë mishi) është zemra.”⁵*

Së fundi, le të kujtojmë hadithin e Pejgamberit (a.s.), i cili me një rast ka thënë: *“Të gjithë jeni barinj dhe të gjithë do të përgjigjeni për tufën tuaj. Kryetari i popullit është bari i popullit dhe do të përgjigjet për popullin e vet. Njeriu është bari i familjes së vet dhe do të përgjigjet për të. Gruaja është bareshë e shtëpisë së burrit dhe do të përgjigjet për të. Shërbëtori është bari i pasurisë së zotëriut dhe do të përgjigjet për të.”⁶*

Allahu xh.sh. në Kuran thotë: **“O ju që besuat, ruajeni veten dhe familjen tuaj prej një zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atë (zjarrin) e mbikëqyrin engjëj të rreptë e të ashpër që nuk e kundërshtojnë Allahun për asgjë që Ai i urdhëron dhe punojnë atë që janë të urdhëruara.”⁷**

Gjithashtu, le të kujtojmë edhe fjalët e Aliut (r.a.), i cili kishte thënë: *“Edukoje fëmijën tënd para se të lindë.”⁸* Një fjalë popullore thotë: *“Fëmija edukohet njëzet vjet para se të lindë!”*

4. Surja Jusuf, 59-62.

5. Muttefekun alejhi.

6. Muttefekun alejhi.

7. Surja Tahrim, 6.

8. Pra, kujdesu për edukimin tënd dhe fitimin e kafshatës së bukës në mënyrë që edhe fëmijët e tu të dalin të “hajrit”.

Zhvillimi mendor

përtej përpjekjes për të mbijetuar...

— Mesut Kaja —

Të hysh në botën e mendimit, ku njeriu në kuptimin e vërtetë të fjalës bëhet njeri konsiderohet si një proces përsosmërie i qenies njerëzore.

Titulli i këtij artikulli në fillim u mendua si “Progresi intelektual (fikri terakki)”. Megjithatë edhe “intelekti” apo “intelektuali” që përdorim ne, si dhe “progresi” tashmë janë fjalë të natyrshme të gjuhës sonë, ajo gjë që më bëri të heq dorë nga ky titull ishte përpjekja për të përdorur fjalët tona, jo të huaja.

Mesa duket, shkak kryesor është kuptimi ideologjik që i kemi veshur fjalës “terakki (progres)” dhe qëndrimi im larg prej saj. Ashtu siç dihet, “progresi” është një nga fjalët magjike të shekullit të 19-të. E njëjtë me arsyen dhe shkençën. Triniteti filozofik që bëri adhurues të rrugës së qytetërimit të Evropës...

Në krahun tjetër, janë koncepte që përmbajnë të njëjtën magji tek popujt që ende nuk janë qytetëruar apo që nuk e kanë realizuar procesin përndritës së civilizimit. Pra, si përfundim, “progresi” është një koncept me qendër ligjërimin para-mbrapa, porsì një balsam për gjuhën...

Progresi është njëkohësisht një term i mistikës islame. Përdoret për të treguar zhvillimin shpirtëror të sufiut. Myridi që kryen dhikrin dhe virdin dhe që respekton edukatën dhe rregullat e caktuara, vëren frytet e rrugëtimit shpirtëror; kështu ai bën progres dhe zbulim (inkishaf) shpirtëror. Në këtë kontekst, ajo fjalë përmban një konotacion pozitiv.

Mirëpo unë, sidoqoftë, parapëlqej të përdor fjalën “zhvillim” në vend të fjalës “progres”. Natyrisht fjala “zhvillim” u bë koncepti populist i kohëve të fundit; na sorollati për një kohë të gjatë dhe nuk na shpuri gjëkund si dhe pranoj që kjo fjalë menjëherë sjell në mendje “zhvillimin e personalitetit”, që duket se na ka lënë plot lëngata në unin tonë. Ç’e do se unë besoj që shprehja “zhvillim mendor” shpreh siç duhet atë që unë dua të them.

Po mirë, vallë, ç’është zhvillimi mendor?

Mendimi është cilësia më dalluese e njeriut. Për të bërë dallimin e njeriut me gjallesat e tjera, janë krijuar përkufizime të llojit “gjallesa që mendon dhe flet” (el-insanu hajeavanun natik). E folura është domosdoshmëri e të menduarit. Thënë ndryshe, kur shprehet mendimi, shfaqet qenia. Nuk është e mundur të flitet mbi ekzistencën e një mendimi që nuk është shprehur. Si rrjedhojë, njeriu është një qenie që mund ta derdhë në fjalë mendimin. Le ta

kujtojmë anekdotën e Nastradin Hoxhës me papagallin dhe gjelin e detit.

Vërtet papagalli flet, por ajo e folur nuk është e vetëdijshme.

Gjeli i detit mendon, por ai mendim nuk ka ndonjë vlerë praktike.

Allahu i Madhëruar ka



krijuar njeriun, i ka mësuar atij të folurën/të shprehurën. (Rahman, 1 – 4) Këtu le të përmendim komentin që bën komentuesi i Kuranit, Zamahsheri: “Këtu Allahu bën të ditur një veçori shquese të njeriut nga gjallesat e tjera; e shprehura. Të shprehurit është të mund të flasësh në mënyrë të kuptueshme, të artikulosh mendimin që mban brenda.” Në një tjetër ajet të Kuranit Famëlartë, bëhet fjalë se Ademit (a.s.), i janë mësuar të gjithë emrat. (Bekare, 31.) Pra, Allahu i ka dhënë njeriut aftësinë për të menduar dhe për të prodhuar mendim; si rrjedhojë i ka dhënë njeriut aftësinë për t’u dhënë emër sendeve dhe për të krijuar lidhje mes qenies dhe emrave.

Njeriu, aftësinë për të menduar dhe folur e përdor në çdo fazë të përditshmërisë së tij. Mirëpo, a është vallë ai proces i të menduarit, pikërisht ai që bën dallimin me gjallesat e tjera, për të cilën po flasim ne? Pa dashur ta mohojmë këtë, ajo çfarë është thelbësore është që do të ishte më esenciale sikur të prananim formën e të menduarit që prodhon dituri dhe vlerë. Pasi edhe engjëjt janë gjallesa që kanë dije. Mirëpo, kur iu kërkua atyre që t’i thoshin emrat e sendeve, ata thanë: **“Qofsh i lavdëruar! - thanë ata - Ne dimë vetëm atë që na ke mësuar Ti. Në të vërtetë, Ti je i Gjithëdituri, i Urti.”** (Bekare, 32) Kjo do të thotë, që ajo çfarë e bën njeriun të ndryshëm, është mundësia për të mësuar dije të reja, përtej dijes që i është dhënë dhe mundësia për të shpallur vijimësinë e prodhimit të dijes. Ndaj dhe këto janë qeniet që i janë përkulur edhe engjëjt para tyre.

Struktura biologjike e njeriut është sikurse e të gjitha krijesave, që nga barku i nënës deri në vdekje është gjithnjë në një proces ndryshimi dhe zhvillimi. Edhe mendimi dhe e folura gjatë përditshmërisë, në mënyrë paralele me këtë, zhvillohet deri në një farë pike të caktuar. Por mendimi për të cilin po flasim ne, zhvillohet në varësi të një përpjekjeje dhe pune brenda njeriut pas një faze të caktuar.

Kësisoj, zhvillimin mendor mund ta shohim si një domosdoshmëri e qenies njerëzore, për gjetjen e së vërtetës, si një përpjekje dhe punë për të prodhuar dituri dhe vlerë. Të hysh në botën e mendimit, ku njeriu në kuptimin e vërtetë të fjalës bëhet njeri konsiderohet si një proces përsosmërie i qenies njerëzore.

Duhet të pranojmë që edukimi, rrethi, interesimi dhe prirjet e njeriut ndikojnë tek ai. Edukimi që merr nga familja dhe shkolla, përbën një vend të rëndësishëm për të arritur frytet e jetës. Po ashtu

edhe rrethi. Mirëpo, një njeri që mendon, ndërkohë që kërkon nga njëra luginë në tjetrën, mund të shohë përreth si një subjekt; vjen koha dhe sheh me një sy kritik edhe edukimin që merr edhe rrethin që e rrethon. Të testosh njohuritë që mëson; të vlerësosh sa të vërteta dhe sa të gabuara janë ato çfarë dimë; të arrish nga e njohura tek e panjohura; të prodhosh dije dhe vlerë, është një rezultat i përpjekjeve personale.

Nëse do të duhet ta konkretizojmë, leksionet jepen dhe përpjekjet bëhen në varësi të degës që zgjidhni në universitet dhe të shërbimit të njohjes më mirë të profesionit tuaj. Kur njeriu diplomohet në një universitet të caktuar do të dalë prej aty me një profesionin përkatës. Mirëpo, njeriu përtej pretendimit për të pasur një profesion, brenda një kohe të caktuar duhet t’i shtojë shumëçka ekzistencës ontologjike. Ai duhet ta shohë jetën me një sy tjetër, duhet të hyjë në një klimë reflektimi. Kjo gjë ndodh vetëm përmes veprimtarive të ndryshme jashtë fakultetit dhe një leximi alternativ, që mund të kontribuojë në zhvillimin mendor të njeriut.

Edhe procesi pas saj është shumë i rëndësishëm. Njeriu duhet ta vazhdojë zhvillimin mendor edhe pasi të ketë një punë dhe pasi të krijojë një familje. Aktiviteti mendor që nuk vijon edhe pasi është hedhur në jetë, do të hyjë në një qorrsoak, kështu do të nisë të mbajë erë, nëse mund të themi kështu. Kjo gjë sjell me vete edhe njëfarë përtacie mendore. Për sa kohë që vazhdon të rrjedhë jeta, duhet të vazhdojë po ashtu të rrjedhë edhe mësimi bashkë me mendimin. Meqë ky proces vazhdon, mënyra e shikimit të njeriut kur është 25- vjeçar ndaj një teme të caktuar, me mënyrën e shikimit kur ai është 30 vjeç është mjaft e ndryshme. Kështu që, nëse njeriu procesin e mendimit e vazhdon gjatë tërë jetës, besoj që njeriu do ta ndjejë më mirë fuqinë brenda vetes, si dhe tek vetja e tij do të ndjejë qëllimin e qenies, kështu do të mund të jetë më afër me fuqinë dhe madhësinë e Allahut.

Edhe Kurani njeriun e nxit që të mendojë vazhdimisht. Nuk bëhet fjalë për një mendim të rëndomtë, por për meditim në kuptimin e të menduarit thellësisht. Për sa kohë që njeriu zhytet në detin e meditimit, sheh dallimin e vet me gjallesat e tjera, e ndjen më shumë të qenit më i nderuari i krijesave (eshrefi mahlukat). Të gjitha gjallesat bëjnë përpjekje për të mbijetuar. Ajo çfarë është e rëndësishme është përtej kësaj përpjekjeje, pra vazhdimi i kërkimit të së vërtetës; të mund të bëjë përpjekje për një jetë që bart në vetvete besimin dhe fenë, vlerat sublime dhe diturinë.

MENDIME TË “PASTORIZUARA” (!)...

— Xhihan Tashtan —

Ishte mesditë... Arkeologut i dëgjoheshin rrahjet e zemrës teksa po pastronte me kujdes tabelën prej argjile... Pas pak çastesh do të ishte në gjendje që të hapte një letër që kishte qëndruar e fshehur prej mijëra vitesh, një letër që një qytetërim tjetër ia kishte nisur kohës sonë. Si një lajm i mezipiturur nga njeriu i zemrës... Nuk kanë ndryshuar shumë gjëra qëkur sumerët para 4000 vitesh, shkruanin në tabelën prej guri; tani atyre u ka kaluar moda dhe ne shkruajmë në tabela elektronike, në tableta...

Shkrimi me gozhdë ia la vendin shkrimit me gishta. Por një fjalë nuk ka ndryshuar fare... “i Cili, me anë të penës ia mësoi, ia mësoi njeriut ato që nuk i dinte.” (Alak, 4-5)

Faktikisht shkenca është ndërtuar mbi “Big Bangun” ose siç njihet ndryshe: “Shpërthimin e madh”. Allahu ua nguliti shkencën njerëzve në thellësinë e mendjeve të tyre. Dija është trashëgimia e njerëzimit. Ajo nuk është mbuluar asnjëherë, por ka pushtuar botën. Pas ardhjes së Islamit filloi “Epoka e Artë”. Gjatë shekujve 6-14 Islami i dha njerëzimit ndjenjën e “etjes për dituri” duke krijuar themelet të forta për shkencën moderne. Ndikimi i qytetërimit islam dhe rregulli që vendosi, shikohen akoma në artikujt shkencorë që publikohen edhe në ditët tona. Edukata e lartë që dijetarët islamë i shtuan shkencës, “lavdërimi i burimit të dijes”, “citimi i burimit prej ku është marrë informacioni”, “diskutimi i qytetëruar mbi veprat (parimi i kritikës së drejtë) dhe ecja gjithmonë përpara...”

Para Islamit, vendi i ditorisë mendohet se ishte Greqia. Pas shekullit të gjashtë, myslimanët e uritur për dituri, filluan të tregonin kureshtje për të gjitha fushat e dijes. U ftuan njerëzit më të ditur të botës, pa dallim race e feje dhe u dëgjuan me kureshtje mësimet e tyre. Sigurisht që pas kësaj pike, ata nuk qëndruan në vend numëro por bënë përpjekje për ta zhvilluar sa më shumë shkencën.

Një prej cilësive të dije-

tarëve myslimanë ishte respekti dhe kujdesi i tyre për të treguar burimin prej ku e merrnin një njohuri të caktuar. Në lidhje me këtë gjë, historiani i shkencës ka thënë diçka shumë të goditur: “Kultura e vetme që citonte burimet e veta ishte kultura islame.” Një praktikë e tillë lindi nga transmetimi i haditheve me zinxhir transmetuesish. Hadithet e Pejgamberit tonë të nderuar nuk janë transmetuar gojë me gojë si shprehje të thjeshta, sepse në atë rast mund t’u humbiste origjinaliteti dhe vërtetësia. Kjo sjellje është një prej cilësive më të rëndësishme të artikujve shkencorë të shekullit 21. Pra mund të themi se kapitujt e referencave dhe të diskutimeve kanë mbetur trashëgimi prej shkencës islame.

Fatkeqësisht, një kujdes i tillë nuk është treguar me veprat e dijetarëve islam që u kopjuan në të gjithë Evropën. Shumë prej librave që vendosen themelet e mjekësisë u përkthyen nga arabishtja, por u referuan si libra të grekëve. Për shembull, libri që Hakeza Ibni Sina shkroi në lidhje me gurët, njihet si libër i Aristotelit. Ndërkohë dijetarët islamë me ndërgjegjen, respektin dhe dashurinë që i karakterizonte, kur shkruanin libra të frymëzuara nga Aristoteli, e përmendnin atë me titullin: “Mjeshtri i Madh”.

Në të njëjtën mënyrë nuk njihet as libri “Maddetul Hajat” i të nderuarit Akshemseddin. Ky libër shpjegon eksperimentet e bëra në lidhje me sëmundjet ngjitëse dhe në të përmendet për herë të parë mikroskopi. Ndërkohë bota njeh shkencëtarin Pastor si shpikës të mikroskopit, një njeri që jetoi 400 vite pas Akshemseddinit.

Fjalët e poetit të madh Junus Emre janë të përshatshme për çdo epokë: “U futa në botën e dijes dhe iu vura mësimet. Më thanë se dituria vjen më pas, e para është njerëzia.”

Përpara se të mbyllni tabletën në të cilin po e lexoni këtë shkrim, mendoni edhe njëherë: shkenca ka marrë kaq shumë prej “nesh”, po ne vetë sa larg jemi prej “nesh”?



HESHTJA E MBAN SEKRETIN



Në një vend, gjendej një burrë me karakter të mirë. Njerëzit shkonin për ta vizituar dhe qëndronin rreth e rrotull tij. Një natë, tha me vete:

“Njeriu është i fshehur në gjuhën e tij. Përse po hesht?” Pastaj mendoi: “Nga do ta kuptojnë njerëzit se jam një njeri i ditur nëse nuk flas?”

Për këtë arsye, vendosi ta prishte heshtjen dhe filloi të fliste me njerëzit. Kur filloi të fliste, burrit i doli në pah fytyra e vërtetë. Njerëzit e kuptuan se sa injorant ishte ai në të vërtetë. Pas një kohe të shkurtër, ky njeri nuk qëndronte dot në vendin e tij dhe u detyrua të largohej. Para se të largohej, shkroi këto fjalë në një qoshe:

“Po ta shikoja veten në pasqyrë, nuk do ta bëja këtë budallallëk duke hapur perden. Por ja që e hapa perden edhe pse e dija se jam i shëmtuar.”

O njeri i mençur! Shfaqe pjekurinë për të heshtur! Nëse je i ditur, mos e humb fisnikërinë! Nëse nuk je i ditur, mos e shqyej perden!

NJË THËNIE

“Ta lësh punën duke e parë të ardhmen të errët, Nuk është gjë tjetër përveçse një vdekje e ulët.”

(Mehmet Akif Ersoj)

NJË LUTJE

“O Zoti Ynë! Ne dëgjuam një thirrës që na ftonë në besim: “Besoni Zotin tuaj!” Dhe kështu besuam. O Zoti Ynë! Na i fal gjynahet tona, na i shlyej gabimet dhe bëna që të vdesim me të mirët!”

(Al Imran, 193)

FAKTE INTERESANTE

- Në një kilogram limon, ka më shumë sheqer sesa në një kilogram luleshtrydhe.
- Një njeri, përgjatë ditës, konsumon 28-33 mijë litra ajër, 500-700 litra oksigjen dhe 2 kilogram ushqim.
- Në një vend ku nuk ka gravitet, flaka e qiriut merr formë rrethore.
- Një gotë me ujë të nxehtë ngrin më shpejt se një gotë me ujë të ftohtë në frigorifer.
- Bufi është zogu i vetëm që mund të shohë ngjyrën blu.

Bota e misterhme e Saturnit

— Muaz Erdem —

Ne si njerëz kudo që kemi dërguar mjete kozmike për të na shuar kureshtjen, lëre që nuk na e kanë shuar aspak këtë të fundit, por përkundrazi, na kanë formuar në kokë pikëpyetje të reja dhe na kanë lënë ballë për ballë me mistere të tjera. Kureshtja është e bukur. Të menduarit është i bukur, sepse edhe në Kuranin Fisnik thuhet: *“Krijesat më të këqija para Allahut janë ato që janë shurdhe dhe memece (ndaj së vërtetës) e që nuk arsyetojnë.”* (Enfal, 22)

Kur bëhet fjalë për planetin, njerëzve u vjen në mendje një trup qiellor i rrumbullakët që ka përreth unaza edhe pse mund të mos ia dinë emrin. Ja pra, planeti që i dihet forma por që nuk i kujtohet emri menjëherë është Saturni. Ky planet ka ndikuar aq shumë te njerëzit sa që me dhjetëra kompani i kanë marrë emrin ose i kanë përdorur formën si logo. Saturni është planeti i vetëm që mund të shihet me unaza nga Toka. Por edhe Jupiteri, Urani dhe Neptuni e kanë strukturën e unazave edhe pse unazat e tyre e kanë dendësinë e ulët dhe është shumë e vështirë të shikohen nga Toka.

Saturni për nga madhësia është planeti i dytë i madh pas Jupiterit në sistemin diellor. Ai nuk është një planet që ka tokë. Domethënë, nëse dëshironi të vini këmbën mbi sipërfaqen e tij, nuk do të gjeni ndonjë pjesë toke ku ta vendosni. Ngaqë Saturni është një gjigand i madh gazi, me shprehjen më të thjeshtë, ka një sipërfaqe që përbëhet nga retë. Shpejtësia e erërave që i lëvizin retë e Saturnit nga perëndimi në lindje herë-herë arrijnë deri në 1800 km në orë!..

Saturni është mesatarisht 1.3 miliard kilometra larg nga Toka. Temperatura në sipërfaqen e tij është -178 gradë celsius. Një ditë në Saturn me kohën e Tokës është 10.5 orë. Rrotullimin e plotë rreth diellit e bën me 35.000 km në orë dhe për një kohë të barabartë me 29.4 vjet të Tokës. Si madhësi ai është plotësisht 763 herë më i madh se Toka. Ndërsa si masë është vetëm 95 herë më i rëndë se Toka. Për këtë arsye, dendësia e tij është shumë e ulët. Madje është aq e ulët sa që po të kishim mundësi për ta vendosur Saturnin në një legen të mbushur me ujë, Saturni nuk do të humbte, por do të notonte, sepse dendësia e



ujit është 1 g/cm³, ndërsa dendësia e Saturnit është 0.70 g/cm³.

Ngaqë dihet se Saturni është një gjigand gazi, nuk do të ishte e logjikshme që të shtrohej pyetja: “Vallë, a ka jetë në Saturn?” Ndërkohë Saturnin nuk duhet ta mendojmë të vetëm. Siç e mendojmë sistemin diellor si një sistem të madh që ka diellin në qendër, edhe Saturnin duhet ta mendojmë si qendrën e sistemit të Saturnit. Për këtë arsye, në sistemin e Saturnit gjenden edhe shumë trupa qiellorë përveç Saturnit. Anëtarët më të dukshëm të këtij sistemi janë miliarda trupa të vegjël dhe të mëdhenj qiellorë të mbuluar me akull prej uji që formojnë unazat e Saturnit. Këta trupa qiellorë janë aq të shumtë saqë nga Toka duken sikur të jenë një unazë e vetme. Sistemi i unazave fillon nga 80.000 kilometra larg qendrës së Saturnit dhe vazhdon larg deri në 130.000 kilometra. Copat e mëdha dhe të vogla vazhdimisht bashkohen duke u përplasur me njëra-tjetrën. Pastaj përsëri copëtohen duke u përplasur prapë me njëra-tjetrën. Për këtë arsye, pak e shumë gjithmonë janë të njëjta. Ndërsa një grup tjetër anëtar i sistemit të Saturnit është grupi i satelitëve që përbëhet prej 62 të tillëve. Sateliti më i njohur dhe që ka tërhequr më shumë interesimin e njerëzve është Titani. Titani është sateliti (hëna) e vetme në sistemin

diellor që ka një atmosferë të dendur. Kjo hënë është më e madh dhe më e ngatërrueshme se hëna jonë. Ndërsa shkaku më kryesor që e bën Titanin të njohur është fakti që mendohet se ky satelit përbën njërin prej tri vendeve që mund të ketë jetë në sistemin diellor.

Anija kozmike Cassini u hodh në hapësirë nga NASA në vitin 1997 për ta studiuar me detaje Saturnin dhe sistemin e tij. Anija kozmike kaloi Tokën, Afërditën dhe Jupiterin dhe ia doli mbanë për të hyrë në orbitën e Saturnit në vitin 2004. Deri në ditët e sotme ajo na ka sjellë shumë të dhëna jo vetëm për Saturnin, por në të njëjtën kohë edhe për unazat dhe satelitët e mëdhenj. Fotot që i ka dërguar na e kanë shtuar admirimin dhe besimin dhe na kanë bërë të themi: “Aman o Zot!” Vitin e ardhshëm Cassini do ta përfundojë detyrën e saj. Më së fundi, më 29-30 Tetor ajo na pati shtruar para sysh lëvizjen e reve të metanit në Titan që është hëna e Saturnit.

Përfundimisht, ne si njerëz kudo që kemi dërguar mjete kozmike për të na shuar kureshtjen, lëre që nuk na e kanë shuar aspak këtë të fundit, por përkundrazi, na kanë formuar në kokë pikëpyetje të reja dhe na kanë lënë ballë për ballë me mistere të tjera. Kureshtja është e bukur. Të menduarit është i bukur, sepse edhe në Kuranin Fisnik thuhet: **“Krijesat më të këqija para Allahut janë ato që janë shurdhe dhe memece (ndaj së vërtetës) e që nuk hanë arsye.”** (Enfal, 22)

"Përmende Zotin tënd me vete, i përlur dhe me frikë; jo me zë të lartë, në mëngjes dhe mbrëmje, dhe mos u bëj nga ata që nuk i kushtojnë vëmendje!"

(A'raf, 205)

Një Ajet

Ky ajet ka zbritur në Meke para natës së miraxhit, në të cilën namazi është bërë obligim. Allahu na mëson mënyrën e dhikrit, pra përmendjen e Tij. Por qëllimi kryesor i ajetit është nxitja e besimtarëve në përmendjen e Allahut dhe tërheqja e vëmendjes për të mos u bërë neglizhentë, indiferentë dhe të pakujdes-shëm në raport me krijuesin e tyre.

Dhikri i përmendur në këtë ajet nuk nënkupton dhikrin që bëhet vetëm me gojë, por dhikri që realizohet nëpërmjet gjuhës, zemrës dhe shpirtit. Nëse gjatë dhikrit nuk dridhet zemra, nuk zgjohet ndërgjegjja dhe nuk shoqërohet me ndjesinë e modestisë dhe përgjërimit, nuk mund të quhet dhikër. Përkundrazi, kjo është një gjendje hutimi karshi Allahut. Sepse dhikri është sjellja vazhdimisht ndërmend e madhësisë së Allahut, duke iu drejtuar me përgjërimit dhe devotshmëri dhe të jetuarit në çdo moment dhe çdo situatë me vetëdijen e plotë se je nën mbikëqyrjen e Tij. Kjo gjendje e zemrës pasqyrohet nëpërmjet gjuhës, e cila e shoqëron me një zë të lehtë që nuk e prish qetësinë e dhikrit.

NË MËNGJES DHE NË MBRËMJE

Me dhikrin në agim dhe në aksham, zemra lidhet me të dyja skajet kohore të ditës. Natyrisht që përmendja e Allahut nuk është e kufizuar vetëm me këto dy kohë. Përmendja e Allahut duhet ndier në zemër në çdo moment dhe situatë, por theksimi në veçanti i këtyre dy kohëve, është për shkak të ndikim që kanë këto dy kohë në zemrën e njeriut. Në agim dhe aksham njeriu vëren një ndryshim të qartë, ndjen fuqinë e Allahut në shndërrimin e errësirës në dritë dhe anasjelltas. Allahu e di shumë mirë se zemra e njeriut është shumë më e gatshme të ndikohet në këto dy segmente kohore. Prandaj tërhiqet vëmendja e bërjes së dhikrit, veçanërisht në këto kohë.



DHE MOS U BËJ NGA ATA QË NUK I KUSHTOJNË VËMENDJE.

Pra mos e neglizho dhikrin ndaj Allahut, sepse kjo sjell shkëputjen e lidhjes që ekziston ndërmjet teje dhe Atij, shkëputje e cila sjell me vete gjendje letargjie dhe përhumbje të plotë ndaj argumenteve të qartë të Allahut të madhërishtë.

Resulullahi (sal-lallahu alejhi ve slem) ka thënë:

“Shembulli i atij që përmend Allahun e lartësuar dhe atij që nuk e përmend, është si shembulli i të gjallit dhe të vdekurit.”

(Buhari)

Pejgamberi (a.s.), e ka përngjasuar gjendjen e besimtarit që i shkëlqen zemra nga përmendja e Allahut, me trupin e shëndetshëm, nëpër damarët e të cilit qarkullon gjak, kurse gjendjen e atij që është neglizhent ndaj përmendjes së Allahut, me të vdekurin që nuk lëviz. Nga ky hadith kuptojmë që dhikri është i domosdoshëm për njeriun, ashtu siç është i domosdoshëm uji për peshkun. Zemra e besimtarit njomet, qetësohet me anë të dhikrit. Këtë fakt e përforcon edhe ajeti kuranor, ku Allahu thotë: **“Ata që besojnë dhe zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, qetësohen. Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!”** (Ra’d)

Dhikri ndahet në tre lloje: artikulum me gjuhë, që nënkupton shqiptimin e fjalëve të caktuara që përmbajnë madhërim, falënderim dhe lartësim të Allahut. Përmendje me zemër, që nënkupton kontemplimin rreth krijesave të Allahut, që të depërtojë në kuptimin e tyre dhe të thellohet në fshehtësitë që mbajnë ato dhe, përmendja me trup, që konsiston në kryerjen e akteve, sipas përcaktimit të Allahut. Çdo vepër, që i shërben përmbushjes së qëllimit për të cilin është krijuar njeriu, është dhikër. Ibadeti i njeriut ndaj Allahut të madhërishtëm realizohet në forma të ndryshme. Njëra nga këto forma, që arrin ta mbajë të fortë lidhjen

e njeriut me Allahun, është dhikri. Madje, mund të themi që, të gjitha adhurimet janë pjesë e dhikrit; çdo veprim gjatë namazit shoqërohet me dhikër. Dobitë e dhikrit janë të shumta, ndër të cilat mund të përmendim: nëpërmjet dhikrit fitohet kënaqësia e Allahut, dëbohet shejtani, largohen brengat, vuajtjet dhe hidhërimet, kurse zemrën e përfshin gëzimi dhe lumturia. Të përmendurit e Allahut forcon zemrën dhe trupin. Të kujtuarit e Allahut pakëson dhe shlyen mëkatet. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *“Kush deklaroi brenda një nate dhe dite: Subhanallahi ve bi hamdihi (Allahu qoftë madhëruar dhe lëvduar) njëqind herë, do t’i falen mëkatet, madje, edhe nëse janë shumë, sa shkuma e detit”.* Kush braktis dhikrin, është i destinuar të bëjë një jetë të vështirë dhe të trishtuar **“kushdo që lë pas dore dhikrin, do të ketë jetë të vështirë e të vuajtur...”** (Taha 124) Të harrosh Krijuesin, do të thotë të harrosh veten, të humbësh lidhjen me jetën, të biesh në përhumbje të plotë ndaj çdo gjëje që të rrethon.

MËSIMET QË NXJERRIM NGA HADITHI:

1. Zemra që nuk përmend Allahun, është si organ i vdekur.
2. Duhet t’i gjallërojmë zemrat dhe shtëpitë, duke përmendur Allahun vazhdimisht.

Një Hadith



PERSONALITETI QË SIGURON SHPËTIMIN E PËRJETSHËM



PËR SHPËTIMIN E PËRJETSHËM

Allahu në ajetin: **“Besimtarët kanë shpëtuar”** të sures Muminun sqaron cilësinë kryesore të personit të shpëtuar.

Pra kushti i domosdoshëm i shpëtimit është besimi.

Shpëtimi nënkupton suksesin ndaj sprovave të kësaj bote.

Si ta arrijnë besimtarët shpëtimin?

Ajetet në vazhdim i japin përgjigje kësaj pyetjeje duke përcaktuar parimet e personalitetit të myslimanit.

NJË NAMAZ GJITHË PËRKUSHTIM

Në dhjetë ajetet e para të sures muminun, e cila jep sihariqin për shpëtimin e përhershëm të besimtarëve numërohen pesë cilësi. Këto pesë cilësi janë parime dhe kriteret e pandashme nga personaliteti i myslimanit. Cilësia e parë është namazi i kryer me

përkushtim e përlësi.

“Me të vërtetë, janë të shpëtuar besimtarët, të cilët janë të përlurur në namazin e tyre.” (Muminun, 1-2)

Ata që përmes namazit fitojnë dashurinë e Allahut, mbrohen nga e keqja dhe imoraliteti, kryejnë namazin shpirtërisht dhe fizikisht. Ata që bien në sexhde dhe i përgjigjen përzemërsisht urdhrat të Allahut: **“Bëj sexhde dhe afrohu.”** (Alak, 19)

Këta janë ata që arrijnë të shpëtojnë përfundimisht...

Falja e namazit me përkushtim dhe harmoni me trupin dhe shpirtin është kusht i domosdoshëm për shpëtimin e përhershëm. Një besimtar duhet që patjetër të falë namazin dhe të qëndrojë para pranisë hyjnore ashtu siç i ka hije asaj.

Ashtu si abdesti është kusht i jashtëm për namazin edhe ndjeshmëria se gjatë namazit gjendesh në komunikim me Allahun është kushti shpirtëror i namazit. Pejgamberi (a.s.), me këtë përkushtim, për-



ulësi dhe dashuri e kryente namazin e Tij.

Profeti (a.s.), thotë:

“Namazi është drita e syrit tim.” (Nesai, Isharetun-Nisa, 1)

Në kohën e Profetit (a.s.), një njeri erdhi në xhami dhe filloi të falë namazin nxitimthi. Kur e pa Pejgamberi (a.s.), i tha:

“Çohu dhe fale përsëri, sepse nuk e ke kryer namazin!” Besimtari e përsëriti namazin, por Profeti përsëri i tha:

“Kthehu dhe fal namazin, sepse ti nuk e ke falur atë.”

Të tretën herë njeriu i tha Profetit (a.s.), se nuk dinte të falej siç duhej. Profeti (a.s.), i mësoi atij namazin e vërtetë. (Tirmidhi, Salat, 110)

Namazi nuk duhet kryer me nxitim, sepse Profeti (a.s.), në një hadith thotë:

“Hajdutëria më e keqe është hajdutëria e namazit.” (Muvatta, Kasrus-salat, 72)

Falja e namazit më vetëdijën se gjendesh para dëgjësës hyjnore dhe plotësimi i kushteve të jashtme dhe të brendshme është parimi më i rëndësishëm individual dhe fetar i personallitetit të myslimanit.

Ndjenja e qëndrimit para Allahut e fton besimtarin të angazhohet në punë të mirë në çdo moment. Prandaj kushti i dytë i shpëtimit është:

VEPRA E DOBISHME

“Ata të cilët shmangen nga fjalët dhe veprat e kota.” (Muminun, 3)

Për myslimanin nuk ekziston koncepti i kohës së lirë. Ai çdo çast të jetës së tij, e cila është kapitali më i madh i njeriut në këtë botë, duhet të angazhohet me një punë të mirë. Besimtari duhet të përpiqet të shpëtojë nga humbja që përshkruan dekreti hyjnor:

“Pasha kohën, me të vërtetë, njeriu është në humbje.” (Asr, 1-2) Besimtari duhet të jetë vazhdimisht i angazhuar me punë të mira. Allahu kërkon që të mos ketë kohë bosh në jetën e besimtarit.

“Kur të mbarosh një punë menjëherë kalo në një punë tjetër dhe drejtoju Allahut.” (Inshirah,7) Sipas

ajetit besimtari nuk duhet të kalojë asnjë moment pa kryer një vepër të mirë. Prandaj besimtari nuk duhet ta lejojë veten që t'i ikë asnjë moment pa vepra të mira dhe adhurim. Jeta është mirësia më e madhe përmes së cilës mund të fitojmë lumturinë e përjetshme dhe na është dhënë vetëm një herë, pa të drejtë kthimi.

Profeti (a.s.), i ka edukuar shokët e tij në mënyrën më të përsosur duke e lënë edukatën e tyre si trashëgim për ymetin e tij. Profeti (a.s.), një ditë, mbas namazit të sabahut u kthye nga shokët duke i pyetur:

A është kush agjërueshëm sot?

- O i Dërguari i Allahut! Mbrëmë nuk e bëra nijetin për të agjëruar sot, prandaj nuk jam agjërueshëm - u përgjigj Umeri (r.a.).

Kurse Ebu Bekri (r.a.), tha:

- Unë e bëra nijet mbrëmë për të agjëruar dhe sot jam agjërueshëm.

Pyetja e lartpërmendur e Profetit (a.s.), ishte individuale. Ai pas kësaj filloi të bëjë disa pyetje që kishin lidhje me vepërimitarinë shoqërore.

- A ka vizituar kush ndonjë të sëmurë sot?

- Ne ende nuk kemi dalë nga xhamia, o i Dërguari i Allahut si mund të kishim vizituar të sëmurë - tha Umeri (r.a.).

Kurse Ebu Bekri (r.a.), tha:

- Dëgjova se Abdurrahman ibn Auf ishte sëmurë dhe rrugës për në xhami i bëra një vizitë duke u lutur për shërimin e tij sa më të shpejtë.

Profeti (a.s.), vazhdoi me një pyetje tjetër:

- A ka ndihmuar kush prej jush ndonjë sot?

- Ne tani sapo falëm namazin dhe akoma nuk kemi dalë nga xhamia, o i Dërguari i Allahut.

Kurse Ebu Bekri tha:

- Në hyrje të xhamisë na doli një i vobekët, i cili kërkoj diçka për të ngrënë, unë ia mora djalit tim Abdurrahmanit bukën që kishte në dorë dhe ia dhashë atij.

Mbas kësaj Profeti (a.s.), tha:



- Të përgëzohet me Xhenet ty, o Ebu Bekër!

Umeri (r.a.), mori frymë thellë dhe tha: Ah Xhenet!

Profeti (a.s.), duke i fituar zemrën Umerit tha:

- Allahu e mëshiroftë Umerin, Allahu e mëshiroftë Umerin! Sa herë që dëshiron të bëjë një të mirë, gjithmonë ia kalon Ebu Bekri.” (Hejthemi, III, 163-164)

Nga ky hadith kuptojmë që dashuria e Pejgamberit (a.s.), për ymetin është aq e madhe, sa që ai nuk dëshiron që në ymetin e tij të ekzistojë shpërdorimi i kohës. Ai dëshiron që ymeti i tij në çdo moment të jetë në kërkim të dashurisë së Allahut. Besimtari duhet të jetë gjithmonë në gjendje ihsani.

Nëse njeriu nuk angazhohet me vepra dhe punë të dobishme, ai do të bjerë në vorbullën e veprave të padobishme dhe punëve të kota. Angazhimet e kota janë bërë sot pengesë e madhe për rininë, e cila është zhytur në punë të cilat nuk japin dobi as për Dynjanë as për Ahiretin.

Profeti (a.s.), ka kërkuar mbrojtje nga Allahu edhe nga padobia e një mirësie të madhe, siç është dituria. Nëse njeriu kërkon vazhdimisht dhe me sinqeritet dashurinë e Allahut, atij do t'i hapen dyert e mirësisë dhe vështirësitë do t'i shndërrohen në lehtësime.

“Me të vërtetë, pas vështirësisë vjen lehtësimi! Me të vërtetë, pas vështirësisë vjen lehtësimi!” (Inshirah, 5-6)

Allahu kërkon prej nesh të jemi të dashur, të dhembshëm dhe të mirësjellshëm me të varfrit dhe jetimët. Nga kjo pikëpamje, një nga verprimtaritë e besimtarit gjatë jetës së tij duhet të jetë edhe ndihma ekonomike ndaj nevojtarëve.

BAMIRËSIA

Në suren Muminun pas kushtit të një namazi të mbushur me jetë dhe largimit prej punëve të kota kushti i tretë është:

“Të jesh aktiv në dhënien e zeqatit.” (Muminun, 4)

Ajeti kuranor thekson faktin se nuk mjafton thjesht të japësh zeqatin, por duhet të kërkosh, të jesh i kujdesshëm, t'i japësh të drejtën e tij edhe të varfrit në mënyrën më të mirë. Me zeqatin, sadakanë dhe verprimtaritë e tjera bamirëse duhet të tregojmë kujdes, seriozitet, përkushtim po aq sa tregojmë kur kryejmë një punë tonën private.

Allahu në një ajet tjetër kuranor thotë:

“Lëmosha) u takon të varfërve, të cilët kanë hyrë në rrugën e Zotit e nuk janë në gjendje të udhëtojnë (për të fituar). Kush nuk i njeh ata, kujton se janë të kamur, për shkak se ata nuk lypin. Do t'i njohësh nga pamja e tyre. Ata nuk i mërzhisin njerëzit duke lypur. E çdo gjë që shpenzoni prej të mirave, Allahu i di ato.” (Bekare, 273)

Allahu në këtë ajet kërkon prej nesh t'u bëjmë një skanim shpirtëror zemrave, në mënyrë që të arrijmë të dallojmë nevojtarët, të cilët për shkak të sedrës dhe krenarisë nuk e shfaqin nevojën dhe vështirësinë në të cilën ndodhen. Në fakt ata lënë një amantet për të pasurit. Ja si thuhet në ajetin vijues:

“Të caktohet një pjesë e pasurisë për lypësin dhe për nevojtarin.” (Mearixh, 24-25)

Sipas ajetit, të varfrit dhe nevojtarët janë ortakë në pasurinë e të pasurve. Ortaku duhet të kryejë detyrën që i takon përballë ortakut. Plotësimi me përkushtim i kushteve të kësaj ortakërie është një nga kushtet për të arritur shpëtimin e përhershëm.

Ndërsa përmbushim një cilësi morale nuk duhet të neglizhohet të tjerat.

Cilësitë morale kanë një rëndësi të veçantë, sidomos në periudhën e fundit.

NDERSHMËRIA

Kushti i katërt i shpëtimit është:

“Ruajtja e nderit të tyre.” (Muminun, 5)

Nderi është tërësia e vetive morale të njeriut, të cilat e bëjnë të dallueshëm njeriun nga krijesat e tjera.

Humbja e nderit është humbje e dinjitetit dhe rënia në një nivel më të ulët se krijesat e tjera.

Nderi dhe pastërtia morale janë ndër vetitë më të rëndësishme të qenies njerëzore. Krenaria, dinjiteti dhe vlera të tjera morale janë të varura prej ndershmërisë. Profeti (a.s.), i cili është model për bashkësinë islame në lutjet e tij nderin e përfshinte vazhdimisht si cilësi të vyer të besimtarit.

“O Zot! Kërkoj prej Teje udhëzim, devotshmëri, moral të pastër dhe zemër të dëlirë.” (Muslim, dhikr, 72)

Për një jetë të ndershme, martesë është e domosdoshme, përmes saj arrihet një gjendje shpirtërore ideale dhe zbuten dëshirat epe shore.

Çerdhja e lumtur familjare e njeriut filloi në Xhenet. Prandaj çerdhja familjare në këtë botë duhet të jetë një parajsë.

Një nga emrat e bukur të Allahut është “El- Vedud” që do të thotë Ai është burimi i vërtetë i da-



shurisë. Allahu në Kuran na jep dy shembuj idealë të ndershmërisë; njëri i takon Jusufit u, i cili për hir të ndershmërisë zgjodhi burgun, kurse tjetri është shembulli i Merjemes së cilës i përmendet emri 34 herë në Kuran.

Nderi si një nga cilësitë dalluese të besimtarit ka një vlerë të veçantë tek Allahu.

Për rrjedhojë, elementet më të rëndësishme të personalitetit të myslimanit janë: nderi, turpi dhe edukata.

Në fakt edhe qëllimi i fesë është kultivimi tek njeriu i virtyteve të vjera si mëshira, dashamirësia, mirësjellja, modestia, solidariteti etj.

Kushti tjetër i shpëtimit është:

MBAJTJA E AMANETIT DHE BESNIKËRIA

Allahu midis cilësive të tjera përmend edhe cilësi shoqërore:

“Ata të cilët u përmbahen amaneteve dhe detyrimeve të marra.”
(Muminun, 8)

Besimtari përveç përkushtimit në ibadet, seriozitetit në jetë, bamirësisë dhe ndershmërisë në jetën e tij, duhet të zotërojë edhe cilësinë e besnikërisë, respektimin e marrëveshjeve, mbajtjen e fjalës, ruajtjen e amanetit. Të gjitha këto janë cilësi të pandashme të besimtarit.

Cilësitë dhe virtytet morale përbëjnë personalitetin e myslimanit.

Dy amanetet më të rëndësishme për të cilat besimtari duhet të kujdeset janë amanetet e të Dërguarit të Allahut r. Në një hadith Profeti (a.s.), thotë:

“Po ju lë dy gjëra dhe për sa kohë do të kapeni fort pas tyre, nuk do të devijoni. Njëri është Libri i Allahut, Kurani, kurse tjetra është rruga ime...” (Muvatta, Kader, 3)

Karakterit është shumë i rëndësishëm, sepse në fund të fundit njerëzit mahniten dhe admirojnë karakterin e njeriut. Njerëzit ndjekin dhe mbështeten pas njerëzve me karakter dhe personalitet.

Ebu Sufjani në luftën e Uhudit ishte komandant i ushtrisë pagane. Ai Umerin e njihte prej kohësh dhe ishte i vetëdijshëm për trimërinë dhe drejtësinë e tij. Në betejë ishin të dy ballë për ballë. Kur ushtria islame u rrethua u përhap fjala se Profeti (a.s.), ra dëshmor.

Ebu Sufjani u kthye nga myslimanët duke thirrur:

“Umer, thonë që Muhamedi vdiq, a është e vërtetë? Unë më shumë se sa njerëzve të mi të besoj ty.

Ishte karakteri dhe personaliteti i Umerit që e bëri Ebu Sufjanin t'i besonte më shumë fjalës së tij se sa fjalës së njerëzve të vet.

JA PERSONALITETI I MYSLIMANIT

Osman Pasha, heroi i Plevnes në Bulgari mbeti gjashtë muaj i rrethuar, u përpoq të çante rrethimin nuk arriti dhe ra rob lufte. Kur u mbledh komuniteti i krishterë tha:

“Unë për t'ju mbrojtur kam marrë xhizje prej jush, tani që nuk mund t'ju mbroj xhizjen po ua kthej”.

Shekuj më parë e njëjta drejtësi është treguar edhe me popullin e Humusit.

Ky është personaliteti i modeluar sipas kriterëve dhe mënyrës së edukimit profetik.

Xhabiri t, tregon:

Profeti (a.s.), mbajti një fjalim të gjatë. Fjalimin e mbaroi me këto fjalë, të cilat përmbledhnin personalitetin e myslimanit.

“Unë jam më afër besimtarit se sa është ai me veten e tij. Nëse vdes dikush, pasuria që lë pas u takon trashëgimtarëve, por nëse pas lë borxh, atëherë ai borxh më përket mua për ta shlyer. Nëse lë pas jetim, mbrojtja dhe kujdesi ndaj tyre është detyra ime.” (Muslim, Xhuma, 43)

Ky pra është një personalitet që shërben si udhëzues për njerëzimin.

Rumi poeti i famshëm thotë: “Thirri mendjes dhe mos përfito vetëm nga aspekti i jashtëm i namazit, por përpiku të përfitosh edhe nga aspekti i brendshëm. Mos bëj si ai zogu që ulet e ngre kokën për të mbledhur thërrmija, pa qenë i vetëdijshëm për madhësitinë e Allahut”.

TË HUAJT E MAHNITUR

Ja çfarë thotë një i huaj për të:

“Në botë asnjë mbret me kurorë nuk ka pasur presigjin, respektin dhe nderimin e Muhamedit, i cili arnonte rrobat e veta.”

Profeti përmes personalitetit shembullor mahnit edhe një të huaj.

*Ndershmëria
konsiston në çlirimin
nga çdo ndjenjë epshi
dhe dëshirë e ulët.
Cilësia më e spikatur
që e dallon njeriun
nga krijesat
e tjera është
nderi.*



Neve si myslimanë na bie detyra të manifestojmë një personalitet që i ka hije ymetit të tij.

Të parët tanë përmes personalitetit dhe karakterit që morën prej Profetit (a.s.) arritën të sundojnë për shekuj me radhë një perandori prej 24 milion km².

Fjala: “Nëse në lumin Vistul janë kuajt e Turqve, atëherë ka drejtësi, siguri dhe ndershmëri”, është shndërruar në fjalë të urtë.

Cilësia e fundit që Allahu përmend në ajetet e para të sures Muminun është përsëri namazi:

“Ata të cilët kryejnë rregullisht namazin.” (Muminun, 9)

Përkushtimi dhe vazhdimësia e namazit janë sekretet e shpëtimit të përhershëm. Cilësitë e tjera radhiten midis dy ajeteve të namazit. Kjo tregon se cilësitë e tjera janë të lidhura me namazin. Përmeshja e cilësive të tjera është në raport të drejtë me përmeshjen e namazit.

Atyre që brumosen me këto cilësi Allahu u premton Xhenetin Firdeus.

“Pikërisht ata do të jenë trashëgimtarët, që do ta trashëgojnë Firdeusin, ku do të qëndrojnë përjetësisht.” (Muminun, 10-11)

Umeri (r.a.), thotë se Profeti (a.s.), pas zbritjes së këtyre ajeteve u kthye nga Kibla dhe bëri këtë lutje:

“O Zot! Mos na pakëso por na shto, mos na përçmo por na ndero, mos na privo, na jep mirësi, na mundëso të sundojmë dhe jo të sundohemi. Ji i kënaqur me ne dhe na bëj edhe ne të kënaqur me ty.”

Pastaj Profeti (a.s.), u kthye nga shokët dhe tha:

“Më janë shpallur dhjetë ajete, të cilëve kush i jep hakun do të hyjë në Xhenet.” (Tirmidhi, Tefsir, 23:1)

Profeti (a.s.), kërkonte me gjithë qenien e tij që ymeti të manifestonte cilësitë më të larta dhe në këmbim të kësaj, gjithë gëzim, u premntonte Xhenetin, shpëtimin e përhershëm. Profeti (a.s.), ishte vetë një shembull i përsosur.

PERSONALITET IDEAL

Udhëzuesi i personalitetit islam është Kurani. Personi që ia ka ofruar më së miri këtë personalitet njerëzimit me jetën, moralin dhe sjelljet e tij është Profeti (a.s.).

Allahu betohet për jetën e Profetit (a.s.).

“Betohem për jetën tënde.” (Hixhr, 72)

Allahu i cili nuk është betuar për asnjë njeri dhe profet, betohet për jetën e Muahmedit r. Ky është një argument i qartë se ai është shembulli ideal për ymetin në të gjitha aspektet e jetës.

Asnjëri prej nesh nuk është i aftë të tregojë për virtytet e Profetit (a.s.). Kur një ditë komandanti i shquar, Halid ibn Velid shkoi te një fis arab, kryetari i

fisit i kërkoi t’i përshkruante portretin dhe karakterin e Profetit (a.s.). Halidi iu përgjigj:

“Kjo është e pamundur, fjalët nuk mjaftojnë për këtë, por mund të them vetëm kaq:

Vlera e të Dërguarit buron nga Dërguesi dhe meqë Dërguesi është Krijuesi i gjithësisë, merre vetë me mend tani madhështinë e bukurisë së tij, në mundsh!”

Sa mundet mendja jonë e kufizuar ta kuptojë atë dhe sa është në gjendje gjuha jonë të flasë për të!

Por sa të dobët jemi ne, aq bujar dhe i mëshirshëm është Profeti (a.s.). Ai na ka treguar për veten e tij në mënyrën më të bukur. Përshtypja e parë që krijonte një person në kontaktin e parë me të ishte:

MËSHIRË DHE BUZËQESHJE

Ebu Derda, megjithëse në një moment të vështirë po fliste duke buzëqeshur. Kur e pyetën gjithë kuriozitet tha:

“Përse flet gjithmonë duke buzëqeshur?

“Sepse e kam parë gjithmonë duke buzëqeshur Profetin r.

Buzëqeshja është shenjë e dashurisë. Është shprehje e dashurisë për hir të Allahut. Dhembshuria e Profetit (a.s.), për krijesat është e jashtëzakonshme, dhembshuria e tij shkon deri tek dega e një peme. Ai nuk dëshiron thyerjen e një dege peme të njomë, kërkonte të mos shqetësonin qenin që po ushqente të vegjëlit e tij.

Profeti (a.s.), tregonte mëshirë edhe për të vdekurit. Disa ditë para se të ndërronte jetë shkoi në varreza dhe bëri lutje për ta. Sa mëshirë gjithëpërfshirëse është kjo!

Pasi bisedoi për disa momente me sahabët tha:

“Sa dëshiroj të shikoj vëllezërit e mi, më ka marrë malli shumë për ta.”

Sahabët e pyetën: “A nuk jemi ne vëllezërit e tu, o Resulullah?”

“Ju jeni shokët e mi, kurse vëllezërit e mi janë ata që nuk kanë ardhur ende.”

“Si do t’i njohësh ata që nuk kanë ardhur ende, o i Dërguari Allahut?”

Profeti (a.s.), u përgjigj:

“Mendoni një njeri që ka një kalë me ballë dhe këmbë të bardha. Ky njeri a mund të ketë vështirësi për ta njohur kalin e tij midis një tufe kuajsh të zinj?”

“Sigurisht që mund ta njohë menjëherë kalin e tij”, - thanë sahabët.

“Ata pra, - tha Profeti (a.s.)- për shkak të abdestit do të vijnë me fytyra të ndritura, me duar e këmbë të ndritshme. Unë do t’i pres ata në Havuz për t’i gostitur. Kurse disa do të dëbohen prej Havuzit, porsi një deve e huaj që dëbohet prej tufës.”

Unë do t'i ftoj të kthehen, por mua do të më thuhet: -Ata e ndryshuan gjendjen pas teje, (duke mos ndjekur rrugën tënde), atëherë edhe unë do të them të qëndrojnë larg, të qëndrojnë larg.” (Muslim, Taharet, 39)

Profeti (a.s.), pastaj kaloi në Xhami, mbledhi sahabët dhe tha:

“Kujt i kam marrë pasuri, le të vijë të marrë pasurinë time. Kë kam goditur le të vijë të më godasë.”

Profeti (a.s.), këtu dëshiron të na japë një mesazh të rëndësishëm, sepse Ai ishte i mbrojtur nga mëkatet, nuk mund të mendohet që ai të bëjë padrejtësi.

Por Profeti (a.s.), përmes këtyre mesazheve edukon te ymetin e tij. Besimtarët sipas shprehjes kuranore, janë dëshmitarët e Allahut në tokë.

DËSHMITARËT E ALLAHUT

Allahu i drejtohet ymetit të Muhamedit r kështu në Kuran:

“Kështu, Ne ju kemi bërë një bashkësi të drejtë, që të bëheni dëshmitarë përmbi njerëzit dhe që i Dërguari të jetë dëshmitar përmbi ju.” (Bekare, 143)

Këtë kërkon Allahu prej nesh në mënyrë që Profeti (a.s.), në Ditën Gjykimit të jetë dëshmitar për ne.

Myslimani është person me karakter dhe personalitet të lartë. Ai këtë personalitet dhe karakter duhet t'ia paraqesë dhe t'ia ofrojë gjithë njerëzimit. Vetëm në këtë mënyrë njeriu mund të bëhet përfaqësues i denjë i Allahut në tokë. Një karakter dhe personalitet i tillë arrihet duke ndjekur rrugën dhe moralin profetik.

Nëse u hedhim një sy të parëve tanë, të cilët qenë mbrujtur me moralin profetik dhe sakrifikuan çdo gjë për përhapjen e tij në botë do të vërejmë se kishin formuar një shoqëri ideale. Në një shoqëri të tillë nuk mund të gjeje: fëmijë të braktisur, të varfër dhe të moshuar të lënë pas dore.

Ajo ishte një shoqëri ku nuk mund të gjeje fëmijë dhe të moshuar të braktisur.

Të parët tanë patën themeluar 26300 institucione bamirësie, të cilat përfshinin edhe mjekimin e zogjve të plagosur. Sa horizont i gjerë shërbimi! Ky është përkufizimi i njeriut sipas Islamit. Rrugët ishin të mirëmbajtura, dora e ndihmës ishte shtrirë deri atje ku imagjinata ndeshte vështirësi. Ishte krijuar një vakëf që çonte ujë nga shami në Meke dhe Medine, në mënyrë që haxhilerët të pinin nga uji i shamit. Ky ujë nuk dërgohej me makinë, tren apo avion, por me deve.

Sa horizont i gjerë shërbimi!

Ky ishte njeriu që ndërtoi feja islame.

Ajo që duhet të bëjnë myslimanët sot është ndjekja e rrugës profetike për të ndërtuar një personalitet të

lartë dhe të nderuar. Gjyshërit tanë në këtë mënyrë çliruan zemrat e njerëzve. Sulltan Fatihu 10 vjet mbas ngadhënjimit mbi Stamboll ngadhënjëu mbi Bosnje. Asnjë boshnjak nuk u vra, sepse shpata ishte thjeshtë një copë hekuri për të flakur padrejtësitë. Shpata, nëse përdoret gabim, shkakton terror. Xhihadi në Islam nënkupton çlirimin e zemrave. Boshnjakët u bënë myslimanë nga drejtësia dhe mëshira që tregoi ushtria osmane. Morali i ushtrisë i bëri ata të ktheheshin në mënyrë masive në myslimanë. Edhe Abisinia kështu u bë myslimane. Tregtarët që ikën në Indonezi nuk e rritën çmimin, megjithëse kishte mungesë malli në treg.

Kur mbretit i mbërriti lajmi, e shprehu kështu admirimin për myslimanët:

SA FE TË BUKUR PASKENI JU!

Një personalitet të tillë nuk ka mundur ta shprehë asnjë pedagog, asnjë psikolog, asnjë mësues që është edukuar dhe selitur me parime e mësim të tjera të ndryshme nga ato islame. Një personalitet i tillë nuk mund të arrihet përmes filozofisë dhe arsyes, një personalitet i tillë është i mundur vetëm duke ndjekur gjurmët e Muhamedit r.

Në lidhje me këtë pikë, çështja më e rëndësishme është njohja si duhet e Profetit (a.s.). Është shumë e rëndësishme njohja e jetës, rrugës, personalitetit dhe karakterit të Profetit (a.s.).

Afrimi tek Ai është i mundur vetëm duke ndjekur rrugën e tij dhe duke u ngjyrosur me moralin e Tij. Devijimi nga rruga e Tij, çon në humbjen e përherëshme.

Shkëputja një nga një prej Sunetit të Profetit (a.s.), i ngjan zbërthimit të fijeve të litarit deri në këputje. Litari është i fortë për sa kohë është një tërësi e vetme, por nëse fijet zbërthehen njëra pas tjetrës, atëherë e humbet forcën. Braktisja e një suneti sjell braktisjen në seri të tij deri në shkëputjen plotësisht prej tij. Shkëputja plotësisht prej tij, sjell humbjen në këtë botë dhe botën tjetër.

Prandaj Suneti i Profetit (a.s.), duhet ndjekur në tërësinë e tij. Ne nuk duhet të harrojmë se jemi dëshmitarët e Allahut të zgjedhur për të përfaqësuar moralin dhe personalitetin islam në tokë.

E lusim Allahun të na bëjë përfaqësues të denjë të moralit profetik. E lusim Atë të na zbukurojë me cilësitë që përshkruhen në suren Merjem. Lusim Allahun që pasardhësit tanë të zbukurohen me bukuritë e moralit profetik.

Amin!..



EL-HAFID - ER-RAFI

AI QË EDHE TË UL, EDHE TË NGRE

— Ilir Hoxha —

Mbi çfarë baze e vlerësoni pozitën tuaj dhe atë të të tjerëve? Kush është në pozitë të mirë, e kush në të keqe? Kush është lart, e kush është poshtë? Si e matni dhe vendosni për këtë?

Përveç cilësisë së kriterëve tona në lidhje me këtë çështje, është për t'u diskutuar edhe qasja jonë në lidhje me atë se si e kanë arritur njerëzit këtë pozitë. Përkrah atyre që për të përçmuar suksesin e atyre që i shohin më sipër vetes, e shpjegojnë atë me shansin ose vetëm me dhuntinë e Allahut, ka edhe një pjesë prej atyre që e shohin veten në një pozitë shumë të suksesshme dhe mendojnë se e kanë arritur atë me përpjekjet, punën dhe përkushtimin e tyre personal.

Mirëpo, emrat hyjnorë Hafid dhe Rafi, që bëjnë pjesë në emrat e bukur të Allahut, na bëjnë të ditur se, Allahu është Ai që edhe të ul, edhe të ngre.

TË PRESËSH QË TË NGRENË, APO TË PUNOSH PËR T'U NGRITUR?

Aftësitë, potencialet, familjet tona, statuset, etj., që nuk janë si rezultat i punës sonë dhe shumicën e të cilave i kemi gjetur të gatshme kur kemi ardhur në këtë botë, janë të gjitha dhunti të Allahut të Madhëruar. Të gjithë e fillojnë jetën e kësaj bote nga një pikë që e ka caktuar më parë Krijuesi ynë i Madhëruar. (shih. Zuhruf, 32.) Mirëpo, kjo nuk do të thotë se nuk do merret parasysh se çfarë bëjmë ne me ato që kemi në dorë. Për rrjedhojë, në vend që të pyesim për pikën e fillimit, duhet të vazhdojmë të ecim përpara, sepse llogaria me të cilën do të përballemi në botën tjetër, nuk është në lidhje me pikën e fillimit, por distanca që kemi arritur deri në fund të jetës (pra puna jonë). Dhe pozitën tonë atje, do ta përcaktojnë ato që ne i kemi shtuar atyre që na janë dhënë.

Ajo që nuk duhet harruar asnjëherë, është se çdo

gjë që Allahu jep (ose nuk jep) me qëllim që t'i ngrejë (ose t'i ulë) njerëzit ndaj njëri-tjetrit, është çështje sprove. ***“Ai ju ka bërë pasardhës të njëri-tjetrit në Tokë dhe ka ngritur disa nga ju në shkallë (më të lartë) mbi të tjerët, për t’ju provuar në atë që ju ka dhënë. Sigurisht që Zoti yt është i shpejtë në dënim, por, në të vërtetë, Ai është edhe Falës e Mëshirëplotë.”*** (En’am, 165.)

Në disa ajete (Uakia, 1-3), Allahu shprehet se, pozitë e larta apo të ulëta që njerëzit ia atribuojnë njëri-tjetrit në këtë botë, janë kalimtare dhe mashtruese, se pozita e vërtetë e gjithsecilit do të kuptohet me kërcitjen e kijametit, kur të gjithë të shohin gjithçka që ndodh në mënyrë të qartë dhe se pikërisht atëherë të gjithë do ta gjejnë pozitën e tyre të vërtetë. Nisur nga kjo, këto ajete na tregojnë se emrat hyjnorë Hafid dhe Rafi janë cilësi që kanë të bëjnë me kijametin.

Po, Allahu është Ai që edhe të ngre, edhe të ul. Mirëpo, Ai na e ka bërë të ditur edhe se në çfarë baze e bën këtë, duke na i treguar që në fillim rrugët për t'u ngritur dhe për t'u ulur. Ngritja dhe ulja, më tepër se një caktim i pandryshueshëm që Allahu ka vendosur në ligjet e krijimit (me kusht që caktimi/kaderi të pranohet brenda kufijve të caktuar), është një përfundim që kemi arritur në bazë të përdorimit të drejtë, ose jo të drejtë të vetes sonë. Ndërkohë që shkuarja pas atij që është poshtë, e ul njeriun, synimi i lartësive, e lartëson atë.

Nëse i jep shumë rëndësi trupit prej balte dhe anës shtazore të natyrës së tij, njeriu do të ulet. Por nëse ai ndjek shpirtin që e thërret në lartësi dhe ftesën e shpalljes hyjnore që vjen nga lart, njeriu do të lartësohet. (shih. A'raf, 175-176.) Për këtë arsye edhe Sadreddin Konevi është shprehur se, çdo gjë që të lartëson është prej Allahut, e çdo gjë që të ul është prej vet njeriut. Kjo, sepse Allahu nuk i bën



padrejtësi askujt. Shkurtimisht, nëse njeriu dëshiron të dijë pozitën e vet tek Allahu, mjafton të shohë vendin që zë Allahu në zemrën e tij.

ÇFARË NA NGRE DHE ÇFARË NA UL?

Allahu i ul njerëzit gjynahqarë me qëllim që t'i largojë prej Vetes. Pra, të qëndrosh larg Allahut është ulje, poshtërim. Këta njerëz i kanë prerë shpresat prej Zotit të tyre, janë mposhtur prej egove të veta dhe kanë humbur forcën për të bërë teube dhe për t'iu drejtuar Allahut. Megjithëse janë gjithmonë në vështirësi, ata nuk ndejnë dëshirë për t'u lutur. Në këtë mënyrë, ata ndëshkohen me braktisje nga Allahu. Siç shprehet edhe autori i *"Komentimi i Esma-i Husna"*, Ali Osman Tatlisu, *"Allahu i ka ulur ata, por shkaku është vetë njeriu"*. Dhe atë që ul Allahu, nuk ka kush ta ngrejë tjetër përveç Tij. Për këtë arsye, ai që bie në një gjendje të tillë, s'ka tjetër rrugë shpëtimi përveçse të kthehet e të strehohet tek Allahu.

Ndërsa zemrat e të dashurve të Vet, Allahu i Madhëruar i ngre dhe i afron pranë vetes. Për rrjedhojë, zemra e këtij personi mbushet me shpresë, qetësi dhe gëzim hyjnor. Dhe Allahu nuk ua merr atyre këtë mirësi nëse ata nuk largohen nga kjo rrugë.

Gjendja shpirtërore e njeriut, sjelljet dhe rruga që ndjek, janë tregues të këtyre manifestimeve. Mistikët thonë se, njerëzit që ngre Allahu, shpesh janë njerëz të butë e gojëmbël, njerëz që i mbulojnë të metat e njerëzve dhe i plotësojnë nevojat e tyre, njerëz që ndihmojnë të tjerët me edukatë dhe mirësjellje.

Allahu i Madhëruar, në Kuranin Fisnik flet për robërit e Tij që i ka ngritur, duke filluar nga profetët dhe shprehet se kjo ngritje është me grada. (shih. Bekare, 253; En'am, 83; Jusuf, 76; Gafir, 1.) Ky detaj na tregon edhe se ngritja është me faza, edhe se midis njerëzve që ngre Allahu, ka gradë të ndryshme. Po sipas Kuranit Fisnik, pozita më e lartë që ka caktuar Allahu, është ajo e dijetarëve. (shih. Muxhadele, 11.) Po ashtu, edhe Profeti ynë (a.s.), në shumë hadithe shprehet se grada më e lartë është ajo e dijes.

ROBËRIT TEK TË CILËT MANIFESTOHEN KËTO EMRA HYJNOR.

Ata që i kanë kuptuar përmbajtjet dhe manifestimet e këtyre emrave, duhet t'i japin vlerë dhe t'i mbajnë lartë ata, të cilëve Allahu i Madhëruar u ka dhënë vlerë dhe i ka ngritur lart. Ndërsa ata që janë larguar prej Allahut dhe kanë ulur veten, nuk duhet të qëndrojnë në zemra më lart se pozitat që meritojnë. Ky është edhe kuptimi i hadithit, *"të duash për hir të Allahut dhe të urresh për hir të Tij"*. Ata që bëhen manifestime të këtyre emrave hyjnorë, janë njerëz që kanë zbuluar dijen e ngritjes dhe uljes tek Allahu dhe, në bazë të kësaj, i rregullojnë të gjitha marrëdhëniet e tyre.

Pothuajse në çdo fushë të jetës ku njerëzit kanë detyra të ndryshme, ekziston një sistem që quhet *"ngritje në detyrë"*, i cili përdoret për të shpërblyer dhe motivuar njerëzit që kryejnë ato detyra. Gjëja kryesore në të cilën duhet pasur kujdes në këtë çështje, është merita. Një person që gjendet në pozicionin e menaxhimit të njerëzve, duhet të përdorë sistemin e shpërblimit dhe ngritjes në detyrë, me qëllim që të nxisë punonjësit të bëjnë sa më mirë punën e tyre. Nëse ndodh ndonjë problem apo neglizhencë në punë, ato duhen evidentuar patjetër dhe, edhe nëse autori do të falet, kjo duhet të bëhet pasi të dalë në pah faji dhe dënimi, me qëllim që njerëzit të mos mendojnë se kjo është lojë.

Pas gjithë këtyre të dhënave, ne mund ta pyesim veten se cila është përmbajtja e vërtet e *"uljes"* dhe *"ngritjes"*. Në çfarë baze i ngremë ata që i vlerësojmë shumë dhe në çfarë baze i ulim ata që i dënojmë dhe i largojmë? Cilat veçori të ulin, e cilat të ngrënë? A i japim çdo gjëje në këtë botë (përfshi njerëzit) vlerën dhe vendin që u takon? Cili është vendi që zë shëndeti, paraja, ndershmëria, besnikëria, farefisi, shoqëria, familja, e vërteta, puna dhe fuqia? Ja pra, nëse arrijmë t'i vendosim këto në vendet e duhura, të ngremë e t'u japim vlerë atyre që ngre dhe u jep vlerë Allahu, t'i ulim e t'i përçmojmë ato që ul e përçmon Allahu, atëherë do të përfundojë edhe kaosi në botën tonë të brendshme dhe, mendimet, ndjenjat e sjelljet tona do të jenë në përputhje të plotë me natyrën e krijimit.

RREGULLAT E ARTA TË SUKSESIT NË ADMINISTRIM / UDHËHEQJE

— Ahmet Zijlan —

Njeriu është një krijesë që jeton në shoqëri. Ai nuk mund të jetojë i vetëm. Familja, fshati, lagjja, qyteti, shteti... Çdo shoqëri kërkon një sistem. Prandaj, ndihet nevoja për administruesit (udhëheqësit) që do ta bëjnë këtë sistem dhe që do t'i udhëheqin njerëzit.

Edhe firmat, por dhe kompanitë janë një organizim si shteti. Suksesi i tyre lidhet direkt me administrimin e duhur.

Administrimi dhe aftësia për të udhëhequr është një dhunti e Allahut Teala... Cilësia e administrimit zhvillohet në forma të ndryshme te disa njerëz, por te disa të tjerë, nuk zhvillohet aspak. Ata mbartin cilësinë për t'u bërë njerëzit e dytë, të tretë apo të katërt.

CAKTIMI HYJNOR...

Sikur të gjithë të kishin cilësinë për të qenë numri një në administrim, kush kë do të ndiqte?! Por si doqoftë, çdo baba është i detyruar ta njohë artin e udhëheqjes sa për të administruar një familje. Çdo mësues është i detyruar ta njohë administrimin aq sa t'i dëgjohet fjala në klasë.

Edhe një tregtar i vogël duhet të dijë se si ta çojë drejt suksesit çirakun apo shitësin e tezgës së tij. Së pari duhet të kontrollojë jetesën dhe sjelljet e veta, pastaj duhet të bëhet një këshillues i heshtur. Për shembull, nëse një administrues pi duhan, nuk mund të ketë sukses sado që t'u thotë vartësve të tij se duhani është i dëmshëm. Administrim do të



thotë t'i udhëheqësh, t'i mbledhësh njerëzit dhe nga njëri aspekt, të jesh bari i tyre... Në hadithin fisnik thuhet:

“Të gjithë jeni barinj dhe të gjithë jeni përgjegjës për grigjën tuaj... Burri është bari i familjes së tij dhe përgjegjës për grigjën e vet. Gruaja është baresh e shtëpisë së burrit të saj dhe përgjegjëse për grigjën e vet.” (Buhari, Vesaja, 9; Muslim, Imare, 20.)

Shprehjet bari dhe grigjë nuk duhet të keqkuptohen siç përdoren nganjëherë në gjuhën shqipe. Në këtë hadith fisnik synohet ky kontekst:

“Të gjithë jeni përgjegjës për ata që i keni nën administrim siç është përgjegjës bariu për grigjën e tij. Përdërisa t'i keni nën administrim, duhet t'u dilni për zot. Ata duhet t'i drejtoni jo në humnerë, por në kahe të dobishme dhe të mira. Nëse ata i çoni drejt humbjes, do të jepni llogari.”

Kaq e rëndësishme është kjo çështje.

Babai është përgjegjës për fëmijët e tij... Për këtë arsye, baballarët që nuk i kanë edukuar, orientuar dhe udhëhequr mirë fëmijët e tyre, në ahiret do të ikin nga ata. Çdo përgjegjës kështu do veprojë nëse nuk i ka edukuar mirë ata që ka nën përgjegjësi...

Njohja e artit të udhëheqjes është kusht edhe për të korrur suksese në jetën e kësaj bote. Atëherë, të gjithë duhet t'i dimë dhe t'i praktikojmë cilësitë e administrimit / udhëheqjes.

Mirë, por cilat janë cilësitë e një administruesi / udhëheqësi?

- Administruesi duhet të jetë i mençur. Nuk është kusht që të ketë IQ të lartë. Mendja e administruesit duhet të jetë një mendje që di të përfitojë nga të gjitha mendjet e tjera. Nganjëherë administruesit mund t'i jepen aq shumë mendime të vjera, saqë përfiton prej tyre më shumë se nga mendimet e tij. Administruesi duhet të ketë një mendje që t'i shqyrtojë ato që sheh, dëgjon dhe shikon, të japë vendimin e vet dhe të marrë iniciativën... Nëse administruesi nuk ka një mendje të tillë, ai nuk mund të administrojë por administrohet. Në pamjen e jashtme vendimet dalin nga goja e tij, por në të vërtetë, nuk mund të bëjë më shumë se të zbatojë ato që i thonë shokët, këshilltarët dhe nganjëherë edhe rivalët madje. Një mendje nuk është e mjaftueshme për të gjykuar e vetme. Duhet dije. Për ta arritur këtë dije, duhet shumë punë.

- Administruesi / udhëheqësi duhet të jetë p - nëtor. Ai duhet ta zhvillojë veten duke punuar. Të punuarit me vendosmëri dhe insistim, e zhvillon mendjen dhe perceptimin. Administruesi duhet të marrë mësim nga njerëzit e duhur, të shkojë nëpër seminare, të lexojë libra në lidhje me çfarëdo pune dhe vendi që administron, vazhdimisht duhet të marrë informacion dhe të bëhet specialist i asaj

pune. Nëse nuk e njeh punën, nuk mund të bëhet administrues, qoftë bari apo qoftë gjeneral. Qoftë administrator në ndonjë fabrikë apo organizatë... Qoftë mësues apo qoftë drejtor në ndonjë shkollë. Pra, administruesi duhet ta njohë mirë punën çfarëdo që të jetë ajo. Puna që njihet është e lehtë. Ndërsa puna më e vështirë është ajo që nuk njihet. Sado që njeriu të përpiqet, çdo gjë nuk mund ta dijë vetë. Atëherë duhet të konsultohet me ata që dinë, duhet të formojë një ekip konsultimi dhe të veprojë sipas vendimeve që jepen në konsultë.

- Administruesi / udhëheqësi duhet të jetë i drejtë. Drejtësi do të thotë t'i japësh rëndësi meritës dhe aftësisë. Nëse administruesi nuk i jep rëndësi meritës dhe aftësisë kur të formojë ekipin e tij prej atyre që ka nën administrim, por mbledh rreth vetes ata që e duan dhe e lavdërojnë, devijon nga drejtësia. Asnjë administrues nuk duhet t'i lavdërojë më shumë se duhet ata njerëz që i ka në vartësi të tij. Nëse një njeriu vazhdimisht i thuhet: “Keni të drejtë. Çfarëdo që të thoni ju është e drejtë.” – pas një kohe ky njeri fillon të llastohet dhe të fluturojë. Por sidoqoftë, ai që bën punë të mirë, sigurisht se duhet të falënderohet.

Edhe plotësisht e kundërta e kësaj nuk duhet të ndodhë. Për shembull, nëse fëmijës, nxënësit apo punëtorit që e ke nën vartësi i thua: “Ti nuk di asgjë. Ti nuk ke aftësi të bësh asgjë siç duhet.” – e shtyp dhe e lëndon atë. Këto janë prej sjelljeve delikate të administrimit. Ngaqë administruesi është edhe vetë njeri, duhet të ketë konsultues që ia thonë të vërtetën, që e kthejnë nga e gabuara dhe e çojnë te e drejta dhe duhet të ketë miq me të cilët të diskutojë.

- Administruesi / udhëheqësi duhet të jetë i butë, i mëshirshëm, i drejtë, i aftë, trim, i ditur, i kujdesshëm, i zgjuar, modest, i sigurt në vetvete, fytyrëqeshur dhe fjalëmirë. Administruesi asnjëherë nuk duhet t'i harrojë ata që ka nën administrimin e tij. Për shembull, një mësues duhet ta dojë nxënësin si fëmijën e tij. Të gjitha marrëdhëniet e administruesit me punëtorët nuk duhet të përbëhen vetëm prej urdhrave, por nganjëherë duhet t'i pyesë edhe për hallet e tyre. I zoti i shtëpisë duhet t'i dije hallet dhe problemet e bashkëshortes, fëmijëve dhe të të gjithë pjesëtarëve të familjes së tij. Ai duhet t'i ndjekë këto dhe të informohet për çdo gjë të re që ndodh. Këto janë sjellje që i kënaqin zemrat dhe fitojnë pëlqimin e tyre. Nëse një profesor, pronar, apo shef pyet dhe interesohet për gjendjen e atyre që ka nën administrim, kjo sigurisht se i kënaq shumë ata. Një specifikë tjetër që unë e këshilloj shpesh është që administruesit nganjëherë duhet të hanë bashkë me punëtorët ushqimin që hanë punëtorët. E kam treguar edhe në shkrimet e më-

parshme: Një komandant i suksesshëm në ushtri, hëngri ushqim plot oreks bashkë me ne ushtarët. Kjo na dha shumë moral mua dhe ushtarit tjetër. Kjo dhe sjelljet e singerta si kjo, i gëzojnë shumë ata që janë nën administrim. Për këtë arsye, ata thonë: “Administruesi ynë është njeri si ne. Sa modest që është. Ai ha ushqim bashkë me ne.” Ajo ditë që administruesi ha ushqim bashkë me punëtorët e tij, është ditë feste për ata punëtorë. Këtë nuk mund ta dijë ai që nuk është punëtor. Ata që e shohin çështjen nga jashtë, nuk mund ta kuptojnë botën e brendshme të punëtorëve.

- Ekuilibri ndërmjet modestisë dhe seriozitetit. Administruesi, në të njëjtën kohë duhet të jetë edhe serioz. Ai që përgojn të tjerët dhe që bën shaka të pavend me të gjithë, e humb seriozitetin e tij. Në këtë mënyrë, i bie ndikimi i fjalës. Umeri (r.a.), ka thënë: “Atij që nuk qesh shumë, i jepet madhështi. Ndërsa atij që e lë shakanë, i jepet krenari.” Pra, administruesi duhet të jetë një njeri modest dhe që interesohet për ata që ka nën vartësi, por jo aq sa të quhet njeri që merret me gjëra që nuk i interesojnë, duhet të jetë një njeri që mban largësi, por jo aq sa të quhet mendjemadh dhe duhet të jetë një njeri që e nxjerr në pah seriozitetin që pozita e tij e kërkon domosdoshmërisht.

- Ekuilibri ndërmjet butësisë dhe ashpërsisë. Po ashtu, edhe butësia e tepërt, edhe ashpërsia e tepërt janë të këqija. Në të vërtetë, ashpërsia nuk bën aspak. Administruesi nuk bën që të zemërohet. Ai duhet të jetë një njeri që e ka nën sundim zemërimin. Zemërimi është shenjë e paafësisë dhe mos-suksesit. Një administrues nxehet kur nuk di çfarë të bëjë dhe nuk di se çfarë të thotë. Një administrues i mirë nuk zemërohet aspak. Një kryetari bashkë i thashë: “Një kryetar i mirë nuk zemërohet aspak. Prandaj, mos u zemëro!” Ai më tha: “Disave nuk mund t’u shpjegosh gjë pa u nxehur. Patjetër se do të të nxehin për diçka. Nëse nuk nxehesh, e bëjnë përsëri të njëjtin gabim ngaqë mendojnë se nuk zemërohesh.” Unë i thashë: “Kur të ndodhë diçka e tillë, bëj sikur je nxehur. Domethënë, do të bësh rolin e të nxehurit, por asnjëherë mos u zemëro, sepse, zemërimi të bën dëm edhe ty.”

- Administruesi duhet t’i ndjekë dhe t’i kontrollojë vartësit e tij. Çfarë bën një biznesmen, një sportist apo një lojtar shahu? Gjithmonë ndjek rivalin dhe mendon për lëvizjet që ai mund të bëjë. Si do të lëvizë pas kësaj? Çfarë do të bëjë pastaj? Nëse unë lëviz kështu, si do më përgjigjet ai? Këto duhet të mendohen dhe të ndiqen hap pas hapi. Siç është e domosdoshme që në lojë të mendohen lëvizjet e të gjithë gurëve, ai që shikon jo nga një dritare, por nga të gjitha dritaret, jo nga një drejtim, por nga të gjitha drejtimet, ai që mendohet jo një herë, por dhjetë

herë për një ngjarje apo punë, bëhet administrues i përsosur. Unë kam mësuar shumë gjëra nga Mehmet Kurdalli, i cili ishte komandanti ynë në ushtri. Ai ishte një burrë edhe shumë i ashpër, edhe shumë i ëmbël. E kam shkruar edhe më parë: Kur ishim duke bërë rojë në kazermë, më mernte pranë, me jepte çaj për të pirë dhe bisedonte me mua. Në të njëjtën kohë mësonte çdo gjë që ndodhte në njësinë ushtarake. Pastaj i qortonte oficerët që nuk i dinin këto. Oficerët vinin dhe më nxeheshin mua. Unë u thosha: “Edhe ju veproni si komandanti. Hyni ndërmjet ushtarëve, bisedoni me ta dhe i mësoni të gjitha ato që mësoi komandanti.” Komandan-tin Mehmet Kurdall e kishin shumë frikë të gjithë ushtarët. Në të njëjtën kohë, edhe e donin shumë. Ja pra, ky është ekuilibri ndërmjet ashpërsisë dhe butësisë. Ai ishte njeri punëtor. E donte punën e tij. Interesohej për të gjithë dhe e zgjidhte çdo çështje, të madhe apo të vogël që mund të ishte ajo. Ai interesohej aq shumë, sa që kur shikonte ndonjë që rroba i vinte e ngushtë dhe dikë tjetër që rroba i vinte e bollshme, u thoshte: “Ndërrojini rrobat me njëri-tjetrin!” Në këtë mënyrë, i bënte ushtarët që të dukeshin bukur.

Ngjarjet që ndodhnin në njësinë ushtarake, i shkruante në një fletore të cilën e quante fletorja e mëkateve dhe sevapeve. Kur bëhej ndonjë gabim, nuk bërtiste me të madhe, por vetëm thoshte se çfarë duhej të bëhej në atë moment, në mënyrë që të kompensohej ai gabim. Por pas disa ditësh, i mbledhte ushtarët, nxirrte fletoren e mëkateve dhe sevapeve dhe thoshte përpara të gjithëve:

“Filan ditë është bërë një gabim i tillë. Ai që e ka bërë është filan ushtar. Sa turp për të.”

“Në filan vend kam parë një ushtar që ia jepte hakun punës së rojës dhe ishte shumë i kujdesshëm. E falënderoj për këtë.”

Ai ndante shpërblime të ndryshme dhe ua jepte atyre që kishin sukses. Atë që bënte gabim, e ndëshkonte. Ose më të paktën, e kritikonte. Kjo kritikë do të thoshte ndëshkim. Ai interesohej për çdo punë: Me ushqimin, shtretërit, pastrimin... Kontrollonte çdo gjë. Ja, ne këtij i themi administrues. Administruesi i vërtetë bën çdo gjë që mundet për ata të cilët i ka nën vartësinë e tij.

- Administruesi e ka kusht që të jetë durimtar për -ballë ngjarjeve që mund të ndodhin. Siç na sugjeron Allahu Teala që të jemi të durueshëm kundrejt fat-keqësive që mund të na ndodhin për shkak të fesë apo për shkak të predikimit të saj, edhe në jetën e biznesit durimi është kusht. Njeriu nuk duhet ta shkatërrojë menjëherë veten sapo të ndodhë ndonjë ngjarje negative. Në ajetin fisnik thuhet: “...(Besimtarët) **e mposhtin zemërimin...**” (Al Imran, 134)

Edhe nëse administruesi nxehet apo zemërohet, duhet ta mposhtë zemërimin, duhet të durojë, duhet të sillet me gjakftohtësi dhe duhet të mendojë mirë për pasojat. Nëse vepron kështu, punët do të hyjnë në binarë vetvetiu.

- Administruesi nuk duhet të ankohet, sepse ank - sa e bezdis njeriun. Nëse një administrues ankohet për vartësit e tij, nëse një biznesmen ankohet për biznesin e tij dhe nëse një mësues ankohet për nxënësin e tij, do të thotë se aty ka mbaruar puna. Do të thotë se atij njeriu i kanë mbaruar bateritë. Do të thotë se atij njeriu i ka ikur dëshira dhe i është konsumuar dashuria e iniciativa për ta bërë atë punë. Kur njeriu të arrijë në këtë gjendje, duhet të lërë çdo gjë dhe të thotë: “La havle ve la kuvete illa billahi'l-alijji'l-adhim.” Duhet të marrë abdest, të falë dy rekat namaz dhe të bëjë sa më shumë lutje. Administruesi asnjëherë nuk duhet të ankohet, të ofendojë apo të mallkojë, por duhet ta lërë punën derisa të qetësohet ose ta preokupojë veten me ndonjë punë tjetër.

Ka shumë shprehje ankesash që janë të njohura. Për shembull: “Nuk kam kohë. Jam shumë i zënë. Nuk bën edhe kaq. A durohet kjo, etj.” Një shok më ka thënë: “Të thuash në shkollë në Amerikë se nuk më mjafton koha, është arsye që mësuesi të të lërë në klasë.” Prandaj duhet ta bësh kohën të mjaftueshme, duhet ta bësh ditën të mjaftueshme dhe duhet të kesh durim të mjaftueshëm. Edhe te ne, çështja më problematike në provimet e rëndësishme është koha e pamjaftueshme. Ai që nuk u përgjigjet për shkak të kohës edhe pse i di, nuk mund të kërkojë asnjë të drejtë.

Nëse mund t’ia japësh hakun çdo gjëje, je administrues. Nëse nuk mund të administrosh, atëherë do të administrohesh. Nëse nuk ndodh kështu, atëherë s’ka nga të vijë përpjekja, këmbëngulja, iniciativa, durimi etj.

- Administruesi patjetër duhet ta dojë punën, zanatin, punëtorin, nxënësin etj. të tij. Administruesi duhet të jetë bujar, por jo shpenzues i tepërt. Ai duhet t’i dojë të gjithë, sepse njeriu bezdiset nga çdo gjë që nuk e do. Për këtë arsye, administruesi duhet t’i dojë të gjithë ata që ka nën administrim. Njeriu mendjemadh, kryelartë dhe egoist, nuk mund të dojë askënd. Prandaj, ai nuk duhet të jetë egoist dhe njeri që gjithmonë lavdëron veten. Çfarë thotë njeriu më

i mrekullueshëm, Pejgamberi (a.s.): “Nuk bën të lavdërohesh...”

Administruesi nuk duhet ta shohë veten më lart se të tjerët, ngaqë ai duhet të jetë modest. Sigurisht se ai duhet ta mbrojë seriozitetin e pozitës që ka, por jashtë punës duhet të sillet natyrshëm me të gjithë. Ai duhet t’ua plotësojë nevojat njerëzve, duhet t’i dojë ata dhe t’u japë punë me këtë dashuri.

- Administruesi duhet të jetë konsekuent, i rregullt dhe serioz. Administruesi duhet të formojë dhe zbatojë një sistem. Ai nuk duhet të jetë i lëkundshëm dhe duhet t’i rrijë korrekt fjalës së dhënë dhe kohës së caktuar. Jo një ditë herët dhe një ditë tjetër vonë, por çdo ditë duhet të shkojë në punë në të njëjtën kohë dhe me seriozitet. Nëse administruesi vjen në dhjetë apo në njëmbëdhjetë, edhe punëtori do të vijë vonë si ai. Nisur nga kjo, atëherë asgjë nuk shkon mbarë. Ky pra është serioziteti i punës.

I ndjeri Musa Topbashi thoshte:

“Neve nuk na pëlqen mendimi që ka për këtë botë filan biznesmen i njohur, por seriozitetin që ka në punë, të shkuarit herët në punë dhe përpikërinë e tij e vlerësojmë.”

Këto janë cilësitë e administruesit / udhëheqësit. Nëse këto cilësi gjenden te një biznesmen, administrues, apo mësues, ai njeri bëhet i suksesshëm. Në vendin ku gjendet një administrues i suksesshëm ka bashkim. Aty ku ka bashkim, ka gjallëri dhe aktivitet. Aty ku ka gjallëri dhe aktivitet, ka sukses.

Administruesi më i mirë është i Dërguari i Allahut, (a.s.). Ai i kishte të gjitha cilësitë e bukura. Ai ishte më i miri në jetën familjare, në jetën e punës, në komandim dhe në edukim. Ai bënte më të mirën. Nëse ne bëhemi prej umetit të tij dhe e ndjekim Atë, me lejen e Allahut Teala do të kemi sukses.

Zoti na i dhëntë të gjithëve këto cilësi dhe na bëftë administrues të suksesshëm. Na bëftë prej robërve të Tij që do dalin me fytyrë të bardhë nga përgjegjësitë për të cilat do japim llogari në ahiret dhe fatlumëve që e kanë librin e veprave të mbushur me sevape dhe mirësi në të cilat i kanë udhëhequr vartësit e tyre. Amin!



Mos të të **ZOTËROJNË** ato që i **ZOTËRON!**

— Ali Khan —

*Pasioni ndaj ekspozimit,
modës dhe luksit konsiderohet
si dinamizmi i jetës së ekonomisë
nga teoricienët e sotëm të ekonomisë.*

*Ndërkohë ne po shitemi pak nga
pak me çdo produkt që po blejmë
dhe po konsumohemi pak nga pak
me çdo produkt që po konsumojmë.*


*Në çdo çështje që po mendojmë se
kemi gjetur shpëtim, po hapim plagë
të pashërueshme. Kur gjërat që i
posedojmë të fillojnë të na zotërojnë,
nuk shtohet vetëm agresiviteti, por në të
njëjtën kohë u hapin rrugë problemeve
sociale si prishja e ekuilibrit social dhe
xhelozia apo urrejtja ndërmjet klasave.*

Allahu Teala thotë në Kuranin Fisnik:

“Ai i ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t’ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë; Ai është i Plotfuqishmi dhe Falësi i madh.” (Mulk, 2)

Njeriu nuk është krijuar dhe dërguar në këtë botë vetëm për të prodhuar dhe konsumuar, por edhe për të kaluar nga një provim. Për këtë arsye, ai ka përgjegjësi në fillim kundrejt Allahut Teala, pastaj kundrejt vetes së tij dhe pastaj kundrejt njerëzve të tjerë e natyrës. Fakti që njeriu jeton në një mjedis material, dashje apo pa dashje e bën atë të hyjë në marrëdhënie materiale. Kjo botë është vendi i jetesës dhe i shitblerjes. Njeriu krahas përpjekjes për sigurimin e jetesës së tij në mënyrë të ligjshme, duhet të fitojë që të mund të harxhojë në rrugë të Allahut (xh.sh.).

Sipas Islamit çdo gjë është e Allahut (xh.sh.). Poseduesi absolut i çdo gjëje është vetëm Allahu. Ndërsa shtetet dhe personat kanë të drejtat formale për posedimin dhe shfrytëzimin e tyre.



Në ajetin fisnik thuhet: **“...Atij i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në Tokë...”** (Bakara, 255)

Islami, megjithëse ia ka njohur njeriut të drejtën për të fituar pasuri, nuk dëshiron që njerëzit të veprojnë me shumë tamah në këtë çështje. Pasioni i tepërt ndaj kësaj bote sipas Islamit është një dobësi besimi dhe morali. Një besimtar edhe nëse fiton nëpërmjet rrugëve plotësisht hallall, në pasurinë e tij kanë të drejtën e tyre edhe të varfrit. Nisur nga kjo, sipas Islamit njeriu nuk mund ta përdorë pasurinë për t'u dukur, për të fituar fuqi në shoqëri, për të sunduar dhe për të bërë padrejtësi. Në Kuranin Fisnik thuhet se e gjithë pasuria e atyre që thonë: **“Unë kam pasuri më shumë se ti dhe rreth më të fuqishëm.”** (Kehf, 34), do të shkatërrohet dhe ajo pasuri nuk do t'i shpëtojë dot ata. (Shik. Kehf, 34, 42, 43.)

ROBËRIMI PËR TË POSEDUAR!

Reklamat janë strategji madhështore marketingu që bëhen për të nxitur çmendurinë e konsumimit. Reklamat përfshijnë mesazhe të fshehta si shndërrimin e diçkaje në të nevojshme dhe nxitjen për konsumimin e saj edhe pse nuk është aspak e nevojshme. Ata që bëjnë reklama janë bërë aq të pafytyrë saqë tashmë mund të thonë për një produkt që e reklamojnë: “Ti mund ta blesh atë, por ai do të të zotërojë ty.” Dëshpërimi dhe depresioni në të cilin janë futur me plan masat e gjera, ka arritur në një situatë të pazgjidhshme.

Tyleri, aktori filozof i filmit “Klubi i Ndjeshjeve” (Fight Club, 1999) që më së fundi edhe ai vetë u montazhua si një objekt reklame, u thoshte elementeve të çetës së tij: “Reklamat na kanë bërë të rendim pas makinave dhe veshjeve. Ne po punojmë në punët që i urrejmë, në mënyrë që t'i blejmë gjërat për të cilat nuk kemi nevojë.” Ne jemi femijët thjeshtë të historisë. Në këtë jetë nuk kemi as ndonjë qëllim, as ndonjë vend. Sa luftë të madhe që po përjetojmë ne! Sa dëshpërim i madh! Lufta jonë është në botën tonë shpirtërore. Dëshpërimi ynë i madh është në jetën tonë.


Në tregun aktual të kulturës absolutisht gjenden disa gjëra që mund të konsumohen nga çdo klasë dhe individ i shoqërisë. Robërimi për të poseduar e ekspozon shumë bukur iluzionin “të gjithë mund të bëhen mbret”. Tregtarët e famshëm, nisur nga përçartja se nevojat e njerëzve janë të pakufizueshme, kanë arritur të antivlerë se “të gjithë kanë të drejtë të konsumojnë aq sa dëshirojnë”. Ndërkohë që më parë vendosnim vetë se çfarë duhet të ki-

shim, tashmë vendosin administratorët, konsultoret, ata që merren me modën dhe ata që merren me reklamat. Një mënyrë për ta fituar prestigjin dhe statusin në këtë sistem robërimi është posedimi i asaj që nuk e kanë të tjerët. Kuptimi i produktit cakton edhe identitetin e konsumatorit. Shtëpia në të cilën banojmë, makina që përdorim, gjërat ditore, etj., gjithmonë na shiten me këtë kod. Stili i jetës, pamja e jashtme, grupet në të cilat gjendemi dhe do të gjendemi gjithmonë nxirren në pah si faktorë të cilët duhet të caktohen me produktet e konsumit. Në fillim shpiket korrelacioni ndërmjet konsumit dhe statusit. Pastaj inkurajohet fshehurazi shtimi i konsumit të lartë të njeriut në vartësi me statusin e tij. Përfundimi: Njeriu do të tregojë se cilat simbole e mjetet përdor dhe se cilin status përfaqëson.

Në gjërat që përdoren është kusht marrëdhënia e objektit nevojë-dobi me njeriun. Sipas shkencës së ekonomisë, vlera e diçkaje formohet në varësi të dobisë që ka për ne, në varësi të gjendjes së saj dhe në varësi të mundit që jepet për të. Por krahas kësaj, përfytyrimi dhe vetëdija sociale janë kusht për vlerën e atyre që posedojmë. Këtë përfytyrim dhe vetëdije neve na e jep Kurani Fisnik. Sipas Kuranit Fisnik, e gjithë bota është dhënë nën urdhrin dhe përdorimin e njeriut. Islami nuk e refuzon ndjenjën për të pasur, por dëshiron që ajo të mos tërbohet. Përqasja e Islamit ndaj ekonomisë pranon se natyra është nën urdhrin tonë, por me kushtin për të mos e shpërdoruar dhe për të mos e dëmtuar. Islami pranon se mund të ketë ndryshime të logjikshme në pasuri, por gjithashtu thekson se pasuria nuk duhet të gjendet vetëm në dorën e disa klasave dhe njerëzve të pakët. Islami, megjithëse e pranon garën dhe rivalitetin, nuk lejon që ato të jenë në masë të tërbuar. Nëse dikush e ka gjendjen e mirë, myslimani duhet të gëzohet për këtë. Myslmani qëndron larg ekspozimit me ato që posedon dhe është kundër konsumimit që bëhet për shtirje. Allahu Teala thotë në Kuranin Fisnik: **“(Ai nuk i do) as ata që ndajnë nga pasuria e tyre sa për sy e faqe të botës dhe që nuk e besojnë Allahun e as Ditën e Kiametit. Ai që ka për shok djallin, dihet sa shok i keq është!”** (Nisa, 38)

A TË BËHEMI TË VARFËR?

Me ndjeshmërinë e përgjithshme islame, e cila nxjerr në pah se as pasuria e tepërt dhe as varfëria nuk janë gjëra që mund të kihen zili, është tërhequr vëmendja ndaj dimensioneve që pasuria dhe varfëria në shkallë të ndryshme mund ta hedhin vetëdijen e adhurimit të Zotit në rrezik. I Dërguari



Kurani Fisnik është kundër prirjes ndaj pasurisë nëse ajo konsiderohet si qëllimi më i madh dhe nëse fuqia e pushteti i arritur nëpërmjet kësaj pasurie përdoret për keq. Në ajetet fisnike thuhet:

“Mjerë për çdo përqeshës - shpifës që grumbullon pasuri dhe e ruan duke menduar se ajo pasuri do ta bëjë të pavdekshëm!”

(Humeze, 1-3)

i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, i ka kërkuar mbrojtje Allahut Teala nga sprova e varfërisë dhe i ka këshilluar ata që kishte përreth: *“Kërkojini mbrojtje Allahut që të mos bini në varfëri, që të mos përjetoni mungesën e gjërave të nevojshme, që të mos i bëni keq kujt dhe që të mos ju bëjë keq kush.”* Nga ana tjetër, të varfrit e ndershëm dhe me sedër janë përgëzuar për mirësitë që do t’i arrijnë në botën e përtejme. Në hadithet fisnik është theksuar se të varfrit do të hyjnë në Xhenet para të pasurve dhe se shumicën e banorëve të Xhenetit e përbëjnë ata që kanë vuajtur nga vështirësia e varfërisë në këtë botë. Krahës varfërisë që e bën njeriun t’i harrojë detyrat dhe përgjegjësitë e tij, është tërhequr vëmendja edhe për pasurinë që e zvarrit atë drejt tërbimit. Në të dyja situatat, e gjithë çështja është mbrojtja e besimit kundrejt Zotit (xh.sh.). Nga ana tjetër, duhet të punojmë fort për ta mposhtur varfërinë dhe për ta mbrojtur besimin. Allahu Teala në Kuranin Fisnik thotë:

“Është Ai që për ju ka krijuar çdo gjë që ka në Tokë...” (Bakara, 29) ***“Thuaj: “Kush i ka penguar stolitë dhe ushqimet e këndshme, të cilat Ai i ka krijuar për robërit e Vet?...”*** (A’raf, 32) Ndërkohë, këto ajete fisnike nuk e shfuqizojnë të vërtetën se myslimani duhet të mbajë distancë ndaj kësaj botë.

Parimi që ka vënë në pah i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, në formën: *“Puno për botën e përtejme sikur ke për të vdekur nesër dhe puno për këtë botë sikur nuk ke për të vdekur asnjëherë.”*, është një ligj që nuk i lejon të dyja këto skaje ekstreme.

Në Islam nuk ka çmenduri konsumi, shpërdorim dhe shtirje, por ka përdorim në bazë të nevojës, kursim dhe të menduarit për të tjerët. Ndjenja për të poseduar është simbolizuar me “të mos qenët koprrac” dhe “mos shpërdorimin”. Në Kuranin Fisnik thuhet: ***“Ata që, kur shpenzojnë, nuk janë as dorëshpuar, as dorështrënguar, por i përmbahen të mesmes.”*** (Furkan, 67) Ky është një simbol i cili shpreh një doktrinë si “ai që beson dhe bën vepra të mira”.

MOS E HIDHNI VETEN NË ZJARR ME DUART TUAJA

“Njeriu do të ketë vetëm atë për të cilën ka punuar.” (Nexhm, 39) Njeriu duhet ta mbledhë pasurinë dhe të fitojë riskun në bazë të rregullave dhe dispozitave hyjnore. Por ja që disa njerëz, edhe pse harxhojnë të gjitha mundësitë dhe japin përpjekjet serioze, prapë se prapë nuk vënë dot pasuri. Ky është një rezultat i caktimit hyjnor. Allahu Teala

thotë: **“Allahu ia shton furnizimin kujt të dojë dhe ia pakëson kujt të dojë...”** (Rra’d, 26)

Pasuria dhe derivatet e saj për myslimanin nuk mund të jenë më të dashura se sa xhihadi që bëhet në rrugë të Allahut (xh.sh.) dhe të të Dërguarit të tij (s.a.s.). Allahu Teala thotë: **“Thuaj: “Nëse etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farefisi juaj, pasuria juaj që e keni fituar, tregtia për të cilën keni frikë se nuk do të shkojë mirë dhe shtëpitë ku e ndieni veten rehat, janë më të dashura për ju sesa Allahu, i Dërguari i Tij dhe lufta në rrugën e Tij, atëherë pritni deri sa Allahu të sjellë vendimin (dënimin) e Tij. Allahu nuk e udhëzon në rrugën e drejtë popullin e pabindur.”** (Teube, 24)

Kurani Fisnik është kundër prirjes ndaj pasurisë nëse ajo konsiderohet si qëllimi më i madh dhe nëse fuqia e pushteti i arritur nëpërmjet kësaj pasurie përdoret për keq. Në ajetet fisnike thuhet: **“Mjerë për çdo përqeshës - shpifës që grumbullon pasuri dhe e ruan duke menduar se ajo pasuri do ta bëjë të pavdekshëm!”** (Humeze, 1-3)

Ata që interesohen dhe që i bëjnë llogaritë vetëm për jetën e kësaj bote, siç shprehet edhe në ajetin fisnik: **“Nuk ka tjetër veç jetës së kësaj bote, vdesim e jetojmë dhe vetëm koha na shkatërron...”** (Xhathije, 24), janë materialistët që e mohojnë ringjalljen dhe botën e përtejme. Ata njerëz që kanë këtë psikologji dhe ndjenjë e harrojnë Poseduesin e Vërtetë duke u lidhur më tepër se ç’duhet me jetën e kësaj bote dhe duke besuar se pasurinë që e posedojnë e kanë fituar me dijen, aftësitë dhe përvojat e tyre. Allahu i Lartësuar thotë në ajetet e mëposhtme:


“Njeriu nuk lodhet kurrë duke kërkuar të mirën, por, nëse e godet e keqja, ai menjëherë bie në dëshpërim dhe humb shpresën. Nëse pas fatkeqësisë, Ne i japim atij që të shijojë nga mirësitë Tona, ai me siguri, do të thotë: “Këtë e meritoj! Unë nuk besoj se do të vijë Ora (e Kiametit), por, edhe nëse

ktthehem te Zoti im, sigurisht që Ai do të më japë shpërblimin më të mirë...” (Fussilet, 49-50)

Ja pra, një njeri që ka një psikologji të tillë, vepron me mendimin se është vetë poseduesi absolut i pasurisë, e cila është e përkohshme dhe për sprovë, dhe i mirësive të ndryshme. Ky njeri për shkak të fitimeve të mëdha e shikon veten si më fisnik, më të respektuar dhe më të lartë se njerëzit e tjerë. Madje mendon se këtë respekt dhe nderim do ta ketë edhe në botën tjetër. Ndërkohë, nga ana tjetër, Allahu i Lartësuar na njofton për fundin që i pret ata të cilët pandehin se pasurinë që e posedojnë e kanë fituar me dijen, përvojën, aftësitë dhe përpjekjet e tyre: **“Kjo më është dhënë vetëm prej diturisë sime”. Vallë, a nuk e dinte ai, se Allahu kishte zhdukur para tij shumë brezni, që kishin qenë më të fuqishëm dhe që kishin grumbulluar më shumë pasuri se ai?..”** (Kasas, 78)

A mund ta shikojmë kuptimin e pasmë të gjërave? Po të mos ishim kapluar nga pamja e jashtme e gjërave dhe të mos kishim pandehur sikur ato përbëhen vetëm nga ajo, a do na hiqeshin qoftë edhe pak perdet e të vërtetës së pafillimësisë dhe përhershmërisë? Përgjatë gjithë kohës garojmë dhe orvatemi për të mbledhur sa më shumë pasuri dhe për të arritur status sa më të lartë. Çfarë dobie ka kjo nëse nuk fitojmë ndonjë zemër, nëse nuk ushqejmë ndonjë të varfër, nëse nuk ia lehdatojmë kokën ndonjë jetimi, nëse nuk japim dhe nëse nuk i ndajmë ato që kemi me të tjerët për hir të Allahut (xh.sh.)? A po e kuptojmë dot se po e rrokullisim veten me duart tona drejt një grope zjarri për shkak të këtij egoizmi, tamahu, garës për të vënë pasuri dhe lakmisë për të poseduar sa më shumë? Këto po e bëjnë këtë jetë të pajetueshme dhe po e shndërrojnë në një treg barbarizmi në të cilin nuk kanë ngelur vlera njerëzore.





Komunikoje mesazhin e Zotit

— Ferit Piku —

Allahu (xh.sh) thotë në Kuranin fisnik: **“O profet, përcille atë që të është zbritur prej Zotit tënd dhe nëse ti nuk e bën këtë gjë, nuk e ke përcjellë amanetin e Zotit, nuk e ke çuar në vend fenë e Tij dhe dije, se Zoti të ruan ty nga e keqja e njerëzve”.**

Zoti i gjithësisë i krijoi vetë njerëzit e Tij po ashtu Ai i furnizon dhe i ruan vetë ata. Ndërsa kur erdhi puna tek çështja e besimit, Ai i kërkoi njerëzve që ta kërkojnë besimin, ta gjejnë atë e ta pranojnë sepse Zoti nuk deshi që njerëzit ta marrin besimin me imponim, por me dëshirë dhe vullnet. Për këtë mision kaq të lartë, për të arritur tek besimi në Zot, Allahu (xh.sh) zgjodhi njerëzit më të mirë. I bëri ata profetë dhe i dërgoi në tokë që të përcjellin mesazhin e Tij, ta çojnë në vend amanetin e Tij drejtuar mbarë njerëzimit. Ndaj rruga e këtyre profetëve nuk ka qenë aspak e lehtë. Dikush prej tyre u vra në këtë rrugë, dikush tjetër u hodh në zjarr, një tjetër u tentua të ekzekutohej, e një tjetër u bojkotua familjarisht, shumë të tjerë u ofenduan. Por profetët e Zotit i pranuan të gjitha këto, madje i pranoi vetë Zoti i gjithësisë. Por një gjë nuk u pranua kurrë: S’ka tolerim në mesazhin e Zotit, s’ka kompromis në kurriz të këtij mesazhi, se përndryshe këta njerëz nuk do të ishin profetë.

Shembulli më i mirë i këtyre njerëzve është profeti i fundit, Muhamedi (a.s). Kur njerëzit talleshin me të, talleshin me njeriun më të mirë që kishte krijuar Zoti por ai nuk mërzhitej nga kjo, ai thoshte: **“Vetëm**

më lini që t’iu flas njerëzve dhe pastaj njerëzit të vendosin çfarë të duan, ose të më ndjekin, ose të më mohojnë”.

Kur njerëzit dashakeqë shkuan për të bërë pazare me të, duke i ofruar para e pushtet vetëm që të hiqte dorë nga besimi i tij apo kur i thanë: “Ne do ta adhurojmë Allahun një ditë, por edhe ti duhet të adhurosh zotat tanë një ditë tjetër”, Ai (a.s) ia ktheu: **“Ajo që më jepni është shumë pak. Beto hem në Zot, se sikur diellin të ma vendosin në dorën e djathtë dhe hënën në dorën e majtë, nuk do të heq dorë nga kjo fe, derisa Zoti ta çojë fenë e Tij në vend, ose unë të vdes në rrugën e kësaj feje”.**

Për këtë bindje dhe për këtë mesazh, Muhamedi (a.s) bashkë me familjen e tij dhe me të gjithë myslimanët u bojkotuan për tre vjet, duke qenë i detyruar të hajë gjethet e pemëve dhe lëkurat e kafshëve të ngordhura, por as ai dhe as shokët e tij nuk bënë pazare me fenë e Zotit.

Për këtë mesazh ai u dëbua nga Meka, iu keqtrajtoi shokët e tij. Për këtë mesazh ai luftoi dhe u plagos, madje edhe e helmuan, por para se të vdiste i mblodhi të gjithë myslimanët dhe u tha tre herë: **“O njerëz! A dëshmoni se unë ua kam përcjellë mesazhin e Zotit?”** Të gjithë myslimanët thanë njëzëri: “O profet i Zotit, dëshmojmë se ti e përcolle mesazhin e Zotit, ti e çove në vend amanetin e Tij, ti na këshillove e na le në rrugë të drejtë”. Atëherë profeti (a.s) u kthye me kokën drejt qiellit

dhe tha: **“O Zot dëshmo edhe Ti, se unë e përco-lla mesazhin Tënd”**. Prandaj ai (a.s) vdiq i pastër, faqebardhë e fisnik para Zotit.

Kjo është rruga e të gjithë profetëve. Kjo duhet të jetë rruga e të gjithë atyre që quhen dijetarë në fe, pasi Muhamedi (a.s) tha: **“Dijetarët janë trashëgimtarët e profetëve. Ata nuk kanë trashëguar as pushtet e as pasuri, por kanë trashëguar diturinë”**. Prandaj çdokush që fiton dituri dhe përcjell amanetin e Zotit, ka hise nga trashëgimia e profetëve. Kjo duhet të jetë detyra e të gjitha bashkësive islame dhe të gjithë përgjegjësve të fesë kudo qofshin në të katër anët e botës, se janë përgjegjës para Zotit dhe janë model për njerëzit e tjerë. Kjo duhet të jetë detyra e çdo myslimani, i cili pranon Allahun për Zot, Islamin për fe dhe Muhamedin (a.s) për profet. Prandaj ai duhet ta përcjellë atë dituri fetare që ka, sado e pakët qoftë ajo, pasi Muhamedi (a.s) tha: **“Transmetoni prej meje qoftë edhe një hadith”**.

Sot kur njerëzit luftojnë e punojnë natë e ditë për të bërë reklamat e kompanive të tyre, për të bërë propagandë për partitë e tyre, të ideve dhe filozofive të tyre, a nuk është turp që myslimanët, të cilët pretendojnë se janë shumicë në këtë vend, të mos punojnë për lartësimin e kësaj feje, për ta çuar në vend amanetin e Allahut (xh.sh).

Unë them me plot bindje, se të transmetosh sot mesazhin e Zotit është xhihadi më i madh që mund të bëjmë, është detyra më e shenjtë, është përgjegjësia më e madhe historike që kemi ndaj këtij populli, i cili është mbi 70% mysliman, ku shumë prej tyre nuk e dinë se çdo të thotë Zot, çdo të thotë Islam dhe çdo të thotë Muhamed. Kjo është detyra më e madhe dhe ne duhet të punojmë për këtë detyrë në të mirë e në të keq, kur na intereson dhe kur na prishen interesat personale. Ky është amaneti që na ka lënë Zoti dhe profeti (a.s).

Ky mision nuk është i lehtë. Dikush do të zemërohet, kur ti të insistosh në këtë mision, diku tjetër do t'i mbetet hatri, dikush tjetër mund të të quajë ekstremist dhe fundamentalist. Por ti mos u mër- zitet dhe mos ua bëj qejfin njerëzve duke zemëruar Zotin. Zoti ka shkruar se ai njeri që i bën qejfin njerëzve duke fituar zemërimin e Zotit, do të vijë një ditë që përveç zemërimit të Zotit do të fitojë edhe zemërimin e njerëzve. Ndërsa ai njeri që i bën qejfin Zotit edhe pse mund t'i mërzisë njerëzit, do të vijë një ditë që Zoti do të kënaqet me këtë person, por edhe njerëzit do të kënaqen me të.

Por duhet të dimë diçka të rëndësishme: transmetimi i këtij mesazhi nuk bëhet me dhunë, me forcë apo me vrazhdësi, por bëhet me butësi sepse e buta e fut fjalën në zemër, kurse dhuna nuk arrin kurrë ta fusë fenë në zemrën e njeriut.

Zoti na bëftë prej atyre që e çojnë në vend ama-

netin e Zotit dhe vdesin faqebardhë përpara Zotit, pastaj Zoti e di se kujt i hyn besimi në zemër dhe kush e refuzon atë.

Mos harroni se feja nuk është e jona, por është e Zotit dhe transmetimi i kësaj feje ashtu siç e ka zbritur Zoti është amanet përpara Tij. Prandaj Zoti do ta pyesë çdo njeri për këtë amanet. Kur njerëzit të merren në llogari, Zoti nuk do t'i pyesë: “Çfarë bëtë ju për fisin tuaj, çfarë bëtë ju për partinë tuaj, çfarë bëtë ju për xhematin tuaj”, por do t'u thotë: “Çfarë bëtë ju për amanetin Tim, Çfarë bëtë ju për fenë Time”? Jo vetëm hoxhallarët, jo vetëm besimtarët apo bashkësitë islame që aktivizohen në përhapjen e fesë së Zotit, por të gjithë do të pyeten për këtë amanet të Zotit.

Ditën e Kiametit, Allahu do t'i pyesë profetët: “Po ju a e çuat në vend amanetin Tim”? Në fakt Zoti e di më së miri se kush e ka çuar në vend amanetin, por kërkon t'iu tregojë të gjithëve se sa i shenjtë ka qenë amaneti i Zotit.

Ditën e Kiametit, Allahu do ta pyesë profetin Isa (a.s): “O Isa! A ti u ke thënë njerëzve, që të të adhurojnë ty dhe nënën tënde si zota përveç Meje”? Atëherë Isai (a.s) përgjigjet: “I lartësuar qofsh Ti o Zot. Ti di çka brenda zemrës sime, ndërsa unë nuk e di se çka brenda Teje. Ti e di fare mirë se çfarë u kam thënë unë atyre. Sa kam qenë gjallë, Ti më ke parë dhe më ke vëzhguar, ndërsa pasi Ti më more, Ti e di më mirë se çfarë kanë bërë njerëzit”. Pas kësaj Isai (a.s) i lutet Zotit që të ketë mëshirë për njerëzit.

Ai njeri që ka tradhtuar këtë amanet dhe këtë mesazh, le ta dijë se nuk ka qenë dijetar, por ka qenë matrapaz dhe fundi i tij do të jetë shumë i hidhur. Zoti thotë në Kuran për këtë fund të hidhur: **“Ata që kanë fshehur atë që Unë kam zbritur, e kanë ndryshuar atë, pasi ua kam sqaruar njerëzve nëpër libra, ta dinë se ata i mallkon Zoti dhe të gjithë njerëzit”**.

Ndërsa për dijetarët, Zoti thotë në Kuran: **“Ata që përcjellin mesazhet e Zotit, kanë frikë vetëm Zotin e askënd tjetër veç Tij, ata e dinë mirë, se i vetmi llogaritës është Allahu”**.

E lus Zotin me gjithë zemër, që Ai të na ndihmojë neve, dijetarët myslimanë, përgjegjës të fesë në këtë vend dhe në gjithë botën që ta çojmë në vend amanetin e Tij. Dijeni se është më mirë të thuash: “Unë e di por nuk e bëj dot”, sesa ta fshehësh të vërtetën e të mos ua tregosh njerëzve. Zoti na ruajt nga neglizhenca dhe nga devijimi. Zoti na ruajt nga zemërimi i Tij. Zoti na ruajt nga përçarjet dhe trazirat e dukshme dhe të padukshme. Zoti na bëftë shkak, që njerëzit të udhëzohen në rrugën e drejtë.

Amin!..



Modeli i Aishes dhe Ummu Sherik në predikimin e Islamit

— Shefika Kaja Meriç —

Ebu Musa, (r.a.), tregon:

“Kur ne sahabëve të të Dërguarit të Allahut, (a.s.), na shfaqej ndonjë problem në lidhje me ndonjë hadith, menjëherë pyesnim Aishen. Ajo patjetër na jepte të dhëna mbi atë çështje.” (Tirmidhi, Menakib, 3877.)

Një nga detyrat më të rëndësishme që Allahu i ka vënë besimtarit në ndërtimin e njeriut në Islam, është edhe predikimi. Predikimi është të shprehurit e Islamit nga besimtari me anë të gjendjes, qëndrimit, pasurisë dhe gjuhës në çdo kohë dhe në çdo vend; po ashtu është të njoftuarit e njerëzve mbi ndjeshmërinë e Islamit.

Islami kërkon nga besimtarët të jetojnë një jetë me vetëdije dhe nder. Rruga e fitimit të këtij nderi kalon nga shprehja Kuranore **“emr-i bi’l-ma’ruf, nehy-i ani’l-munker”**, pra urdhërimi për mirë dhe ndalimi nga e keqja.

Ashtu si dija që është farz për çdo mysliman qoftë burrë apo grua, edhe predikimi është farz për çdo mysliman. Të gjithë burrat dhe gratë myslimane janë përgjegjës për transmetimin e Islamit edhe te brezat e ardhshëm. Ajetet Kuranore me përmbajtje predikimin që Allahu Teala i dërgoi Pejgamberit, (a.s.), në të njëjtën kohë janë një thirrje edhe për ne.

Disa nga këto ajete fisnike janë në këtë mënyrë:

“O i Dërguar! Trego atë që të është shpallur nga Zoti yt! Në qoftë se nuk e bën këtë, atëherë nuk e ke përcjellë mesazhin e Tij; Allahu të ruan ty prej njerëzve. Natyrisht që Allahu nuk i udhëzon njerëzit që nuk besojnë.” (Maide, 67)

“Unë kam për detyrë veç t’ju përcjell atë që më vjen nga Allahu dhe mesazhet e Tij. Këdo që s’dëgjon Allahun dhe të Dërguarin e Tij, e

pret zjarri i Xhehenemit në të cilin do të mbetet përgjithmonë.” (Xhinn, 23)

“Bindjuni Allahut dhe bindjuni të Dërguarit! Kujdes! Nëse nuk ia vini veshin, ta dini se i Dërguari ka për detyrë vetëm të përçojë shpalljen e qartë.” (Maide, 92)

Aq sa merrnin detyra burrat sahabë përreth të Dërguarit të Allahut, (a.s.), për të predikuar Islam, po aq merrnin edhe gratë sahabe. Secila prej tyre pothuajse garonte me të tjerat për të mësuar e përhapur ajetet fisnike të reja që zbrisnin nga Allahu Teala dhe hadithet e të Dërguarit të Allahut, alejhisselam.

Veçanërisht bashkëshortet e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), ndanin me njerëzit çdo çështje që shikonin, dëgjonin dhe mësonin nga Ai (a.s.), duke filluar nga gjendjet e veçanta të Tij e deri te dispozitat më të përgjithshme të Islamit. Aishja, (r.a.), kishte një vend shumë të veçantë ndërmjet tyre. Ajo u edukua në mënyrë të veçantë nga i Dërguari i Allahut, (a.s.), ngaqë ishte më e reja prej bashkëshorteve të Tij dhe ngaqë ishte kureshtarë dhe e aftë për dijen. Aishja, (r.a.), pothuajse ishte “nëna mësuese” e të gjithë umetit burra-gra kur i Dërguari i Allahut, alejhisselam, ishte gjallë, por edhe pas vdekjes së Tij.

Nëna jonë, Aishja është një nga shtatë personat që kanë transmetuar më shumë hadithe. Kjo e shpreh qartë rolin e saj në predikimin e Islamit.

Këto të dhëna, tani le t'i konkretizojmë pak më shumë me një/dy shembuj:

Në aktivitetin e predikimit të Islamit, ka dy zonja sahabe që prijnë para të tjerave. Njëra është nëna jonë Aishja, (r.a.) dhe tjetra është Ummu Sherik, (r.a.). Këto dy zonja sahabe zënë vende të ndryshme si “predikuese” në jetën e veçantë të të Dërguarit të Allahut, sallallahu alejhi ve sellem. Detyra që kryen ato në përhapjen e Islamit, përbën një rekord mësimdhënës për ne...

Krahas zgjuarsisë së madhe, aftësisë, intuitës dhe diturisë së nënës sonë Aishes, (r.a.), aktivitetet që realizoi për përhapjen e Islamit, janë kallauzë ndriçues në çështjen e predikimit të Islamit për myslimanët e sotëm. Bindja absolute që tregoi kundrejt ligjeve të Allahut Teala dhe ndaj Pejgamberit, (a.s.), kur shfaqte këtë përpjekje të sigurtë në rrugën e Allahut, është një argument i qartë për bindjen që nëna jonë, Aishja, (r.a.), kishte ndaj Zotit (xh.xh.) dhe ndaj të Dërguarit të Allahut, (a.s.).

Edukimi që Aishja mori nga babai i saj Siddiki Ekber, Ebu Bekri, (r.a.), që në moshë të vogël dhe martesë me të Dërguarin e Allahut, (a.s.), u bënë shkak për zhvillimin, pjekjen dhe thellimin më të madh të saj në aspektin moral e shkencor. Nëna

jonë Aishja, (r.a.), e cila u bë myslimane që në moshë shumë të vogël, në të njëjtën kohë u bë shembull për të gjithë myslimanët me modestinë, mjaftueshmërinë ndaj asaj që i kishte dhënë Zoti dhe bujarinë e saj. Për shkak të besimit të pastër dhe sinqeritetit, gjëja më e rëndësishme për të ishte veprimi në përputhje me kënaqësinë e Allahut të Madhëruar.

Pasi i Dërguari i Allahut, (a.s.), ndërroi jetë, shtëpia e nënës sonë Aishes u bë një qendër shken-core në të cilën vinin shumë njerëz të mëdhenj e të vegjël. Qoftë në çështjet që kanë të bëjnë me gratë apo qoftë me çështjet në lidhje me thellësitë juridike të haditheve dhe ajeteve fisnike, ajo u bë një burim i rëndësishëm dijeje nga e cila përfitonin edhe halifet si Umeri, (r.a.). Ngaqë ajo ishte njëra prej “nënave të besimtarëve”, të gjithë myslimanët burra/gra shkonin te ajo për të zgjidhur problemet dhe i pranonin pa asnjë hezitim mënyrat e zgjidhjeve që u ajo u jepte.

Aishja, (r.a.), që u interesua nga shumë afër me edukimin e grave duke filluar që në kohën e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), me veten e saj dhe me nxënësit që edukoi, tregoi suksesin dhe rëndësinë e të preokupuarit me dije të grave në botën Islame.

Edhe Ummu Sherik, (r.a.), që e pranoi si detyrë predikimin e Islamit, ishte njëra prej grave sahabe që i udhëzoi gratë e Kurejshve duke shkuar shtëpi më shtëpi. Mushrikët (politeistët) u shqetësuan nga këto aktivitete të Ummu Sherik dhe së pari e kërcënuan.

Ata e lanë tre ditë pa ushqim dhe pa ujë në rrënjë e nxehtë të shkretëtirës, por edhe këto tortura, nuk ia shuan dot dashurinë për të predikuar fenë.

Ato ditë myslimanët patën filluar të shpërngulen për në Medinë fshehurazi me lejen e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), sepse ishin lodhur nga torturat në Mekë. Edhe Ummu Sheriku, (r.a.), tashmë dëshironte të shpëtonte nga presionet e politeistëve Mekas dhe ta jetonte e përhapte më lehtë fenë e Allahut Teala. Ajo nuk gjeti asnjë që shkonte në Medinë, për këtë arsye, u bashkua me një familje çifute. Si shpërblim i durimit dhe vendosmërisë që kishte në besim, arriti nderimin e veçantë të Allahut (xh.xh.). Ngjarja ndodhi kështu: Ummu Sherikut, (r.a.), i mbaroi uji. Çifuti e përdori këtë rast dhe i tha se s'do t'i jepte ujë përderisa të mos kthehej nga feja e saj. Edhe gruan e tij e urdhëroi në mënyrë të prerë që të mos e bënte diçka të tillë.

Koha ishte shumë e nxehtë. Udhëtimi po kalonte me shumë vështirësi. Ummu Sherik, (r.a.), ishte këputur. Fuqia i ishte prerë për shkak të etjes. Ecte dhe fliste me vështirësi. Gjendja e dobët e saj i dha

KJO PJATË DO TË MBAROJË(!)

— Psik. Tuba Sëkmen —

shpresë çifutit. Ai mendoi se kishte kapur çastin e duhur dhe pandehte se ajo nuk kishte zgjidhje tjetër përveçse të kthehej nga feja, por Ummu Sheriku kishte një besim shumë të fortë.

Në një gjysmë nate ku dukej sikur kishin mbaruar mundësitë materiale, arriti ndihma e veçantë e Allahut Teala. Në një moment kur të gjithë po flinin, Ummu Sherik ndjeu mbi krahatorin e saj sikur iu vendos ujë. Ajo piu nga ky ujë derisa u ngop. Mbi të gjithë lagu edhe kokën dhe u freskua. Pastaj u thirri shokëve të rrugës për t'i zgjuar. Nga zëri i saj i fuqishëm, kuptohej se ajo kishte gjetur ujë dhe kishte pirë.

Çifuti pandehte se ujin ia kishte dhënë gruaja e tij, për këtë arsye, iu nxeh, i bërtiti dhe i tha i zemëruar:

“Ti ia dhe ujin?”

Ummu Sherik, (r.a.), ndërhyri dhe i tha se kjo ishte një mrekulli nga Allahu Teala dhe se gruaja e tij nuk i kishte dhënë asnjë pikë ujë. Çifuti menjëherë shkoi te lëkurat e ujit. Ai u habit kur pa se ato ishin të lidhura.

Sinqeriteti dhe besimi i pastër i Ummu Sherikut, (r.a.), ndikoi shumë te ai. Fjalët e saj formuan një ngrohtësi në zemrën e tij. Zemra iu hap ndaj dritës së Islamit dhe tha:

“I besova Zotit tënd.”

Bashkë me familjen e tij u bënë myslimanë duke thënë shehadetin së bashku.

Të predikosh Islamit në kohët më të vështira dhe të paguash kundërvlerë për këtë, është një sakrificë që nuk mund ta bëjë çdo njeri. Nënata tona, Hatixhja, Fatimja, Aishja dhe gratë e tjera sahabije, zunë vend në historinë islame si heroina shpirtërore. Edhe sot, çdo grua besimtare, duhet të përpiqet për ta valëvitur flamurin e predikimit që ka marrë prej atyre. Për një njeri që në zemër ka këtë dashuri, nuk ka shumë rëndësi koha dhe vendi. Çdo vend dhe çdo kohë ku gjenden njerëz, është një mundësi për të përhapur fenë e Allahut Teala.

Allahu i Madhëruar mos na ndaftë nga shërbimi në rrugë të Tij! Zoti na tuboftë në Kiamet me robër prej të cilëve është i kënaqur dhe na bëftë prej atyre që marrin shembull prej sakrificave të Aishes dhe Ummu Sherikut! Amin!..

Një nga bazat më të rëndësishme të shëndetit është edhe ushqyerja. Çdo nënë mundohet në maksimum që fëmija i saj në çfarëdo moshe qoftë, të jetë i shëndetshëm. Që fëmijët të mos sëmuren shpesh, që struktura e tyre të jetë sa më e fortë dhe që zhvillimi trupor i tyre të jetë normal, duhet patjetër të ushqehen shëndetshëm.

Kur nuk konsumohen ushqime të shëndetshme dhe kur ekziston pamjaftueshmëria e ushqimit, fëmijët përballen me probleme serioze. Disa nga këto problemeve janë: ngadalësimi i rritjes, rënie pre e infeksioneve, anemi, debulesë, ngadalësim në konceptim, privim nga emocioni dhe ngazëllimi fëmijëror.

Ky rezultat kaq i rëndësishëm në mënyrë të natyrshme e shton shqetësimin dhe ndjeshmërinë e nënës në çështjen e të ushqyerit. Në këtë mënyrë nëna, për t'u mbrojtur nga këto rezultate negative që sjell pamjaftueshmëria e ushqimit, i ndjek me ndjeshmëri gjërat që i hanë dhe që nuk i hanë fëmijët.

Ndërsa te fëmijët, vetëm për t'u treguar njerëzve përreth se ata janë rritur, ekziston dëshira për të bërë të kundërtën e asaj që u kërkohet. Disa nga panoramat që hasim shpesh janë disa momente kur nëna i thotë fëmijës “Mos e bëj!” dhe ai duke e parë në sy, vazhdon ta bëjë akoma, ose kur i thotë “Eja këtu!” dhe ai largohet dinakërisht në drejtim të kundërt. Në këtë mënyrë fëmijët mund t'i lënë prindërit e tyre pa një rrugëzgjidhje.

Gjendja që i kthen përmbys mundin, shpresat dhe dëshirat e nënave në çështjen e ushqyerjes, buron nga kjo tendencë e



fëmijëve. Ata e dinë shumë mirë se çfarë kërkojnë nënat e tyre. Fëmija që kërkon të tregojë se është rritur dhe i merr vetë vendimet, e di më mirë se nëna se sa dëshiron ajo që fëmija ta hajë gjellën me spinaq apo me pras që ka në pjatë.

Në shumë familje tavolina kthehet në një arenë për fëmijët të cilët provojnë të tregojnë veten. Mes fëmijës i cili këmbëngul të mos e hajë ushqimin dhe nënës e cila lufton për ta bërë atë ta mbarojë, fillon “Ndeshja me një portë”. Ndeshja përfundon ose me vjelljen e gjithë ushqimit nga fëmija, ose me të qarët e tij, ose me një karamelë të premtuar pas ushqimit, ose me rebelimin e babait i cili mërzitet nga kaosi. Dhe tavolina ngrihet për t’u takuar në vaktin e ardhshëm.

T’i humbësh oraret e ngrënies të cilat janë të veçanta për pjesëtarët e familjes ku ata kalojnë kohë së bashku me polemika si “e hëngre, se hëngre, e mbarove, se mbarove...”, është shumë e rrezikshme për zhvillimin e identitetit të fëmijës, si dhe për qetësinë dhe lumturinë familjare. Fëmija i cili është mësuar të ketë polemika çdo ditë me prindërit, e vendos këtë në mendjen e tij si një mënyrë komunikimi dhe në të ardhmen fillon ta përçojë këtë polemikë edhe në ambiente të tjera. Fëmija fillon ta tregojë veten duke bërë të kundërtën e asaj që presin prindërit te zgjedhja e shoqërisë, në zakonet e përgjithshme dhe në mënyrën e të mësuarit.

A është e mundur ta ushqesh fëmijën pa hyrë në polemika? Po. Nëse nuk ka ndonjë sëmundje kronike që mund të bëhet shkak për anoreksi, ushqyerja është një proces shumë i këndshëm, sepse njeriu duhet të ushqehet që të jetojë. Që i gjithë organizmi të vazhdojë të jetojë, duhet të ushqehet. Me të vërtetë që një fëmijë i uritur e ha me shumë oreks edhe ushqimin që nuk i pëlqen aspak. Prandaj nënat së pari duhet të heqin dorë nga mënyra e sjelljes “sikur do të vdesin” me fëmijët që nuk kanë ngrënë disa vakte.

Mendimet e hatashme që nënat shpalosin për t’u dhënë fëmijëve dy-tre lugë më tepër ushqim, e shpjegon shumë bukur shkakun që fëmijët janë me anoreksi. Nëse për këtë do të kishte një çmim, patjetër që këtë do e meritonte një gjyshe e ëmbël me të cilën jam takuar. Edhe është i admirueshëm mudi i asaj gjysheje e cila e ndjek vazhdimisht nipin e saj me pjatë në dorë duke i shkuar pas ngado, sa tragjikomik është fakti se në këtë mënyrë ia shton më shumë shqetësimin e të zgjedhurit ushqimin.

Nënat të cilat vrapojnë pas fëmijëve me ushqim në dorë, vendosin në mendjet e fëmijëve mendimin “Sa më vështirë të hash ti, aq më të madh e marr çmimin unë!” Vazhdimisht bëjnë kompromis me

fëmijët që ata të hanë ushqimin; i inkurajojnë ata të hanë ndërkohë që ndjekin televizorin apo luajnë me lodrat e tyre. Fëmijët të cilëve nuk u pëlqen të përtypen, ua përziejnë të gjithë ushqimet dhe ua paraqesin atë në formë qulli. Kur mbaron vakti, stimulohen me çokollata e ëmbëlsira, sikur t’ia kishin dalë një pune shumë të rëndësishme e të vështirë. Në fakt një vakt i gatshëm, i ngrohtë dhe i ushqyeshëm është për ta më shumë se një çmim.

Për sa i përket çështjes së ushqyerjes, përveç se kemi filluar të përballemi shpesh me fëmijë të dobët e me anoreksi, po përballemi edhe me një problem tjetër të fëmijët me mbipeshë të cilët sa vijnë dhe e shtojnë masën e ushqimit që hanë.

Fëmijët obezë pëlqejnë konsumimin e ushqimeve “fast food” dhe nuk mund të qëndrojnë larg ushqimeve të gatshme. Ngrënia zë një pjesë të madhe në argëtimin ditor të tyre. Kur nuk gjejnë diçka me se të merren dhe kur mërziten, nuk përdorin alternativë tjetër dhe mundohen të lumturohen duke ngrënë diçka. Që në foshnjëri fëmijët obezë mësohen me konsumimin e ushqimit më tepër se ç’duhet. Nëse fëmija e mbaron pa problem ushqimin që ka në pjatë, për nënat kjo nënkupton se fëmija akoma nuk është ngopur. Me një pjatë të dytë stomaku i fëmijës zmadhohet.

Fëmijët obezë kërkojnë dhe konsumojnë më tepër. Ndërsa vazhdojnë e shëndoshen, rëndohen dhe nuk mund ecin me ritmin e moshatarëve të tyre. Nuk mund të vrapojnë aq sa ata, nuk mund t’i japin biçikletës si ata dhe nuk mund të veprojnë shkathët. Me shqetësimin se mund të mos jenë të suksesshëm dhe për shkak të përpjekjes së bërë, largohen sa më shumë nga sporti. Për këtë arsye fillojnë t’i dobësojnë lidhjet me shokët dhe gjithë shoqërinë, zgjedhin më tepër vetminë, kalojnë më shumë kohë përpara televizorit dhe mbi kompjuter dhe në këtë mënyrë gjendja e të shëndoshurit kthehet në një lak për ta. Ata fillojnë të bëhen më të ndjeshëm, e kërkojnë lumturinë te ushqimi dhe fillojnë të ndikohen më tepër nga ngjarjet.

Edhe pse problemet shëndetësore që shoqërohen nga obeziteti janë më serioze se problemet që kanë fëmijët me anoreksi, nënat përsëri nuk mund të shpëtojnë nga motivi i të ushqyerit. Fëmijët e shëndoshë nga shoqëria paramendohen si fëmijë të ushqyer më mirë.

Nëse fëmija zhvillimin trupor e ka normal, nëse është aktiv dhe i gëzuar, nuk duhet të shqetësohemi për oreksin e tij, përkundrazi duhet të shqetësohemi për gjendjen fizike dhe shpirtërore të atyre fëmijëve të cilët marrin kilogramë të tepërt, nuk kanë aktivitete dhe bëhen të ndjeshëm e të vetmuar.

FAMILJA BËRTHAMË DHE AJO TRADICIONALE

— Dr. Hysejn Jëllmaz —

Ndryshimet shoqërore, dashje pa dashje, po ndikojnë tek familja duke e shndërruar atë. Me kalimin e kohës, ndryshimi që ka pësuar martesat dhe familja, po i shkatërron kallëpet tradicionale. Së pari, bie në sy zgjedhja e asaj që quhet “familja bërthamë”, e përbërë nga nëna, babai dhe fëmijët. Nganjëherë, hasemi edhe me raste kur lidhjet farefisnore ndikojnë tek familja. Çiftet e ditëve të sotme preferojnë që të ndahen nga prindërit dhe ta ndërtojnë follenë e tyre në një banesë tjetër.

Kemi vënë re se familja tradicionale po humb terren në konkurrencën me familjen bërthamë. Duhet theksuar fakti se ndryshimet nuk kanë ndodhur vetëm në përbërjen e familjes. Ne jemi dëshmitarë të ndryshimeve rrënjësore në rolet e bashkëshortëve. Kjo ka ndodhur si pasojë e ndryshimit të përgjegjësisë të mashkullit dhe të femrës. Ndoshta do të jetë më e saktë sikur të pranojmë se pas disa kohësh kallëpet gjinore mund të zhduken krejtësisht.

Në përbërjen e familjes tradicionale kishte kallëpe të gatshme që jepnin udhëzime duke filluar nga formimi i familjes së re dhe të gjitha stadet ku ajo kalon. Në familjen tradicionale, roli i secilit individ, detyrat dhe përgjegjësisë e tija ishin të parapërcaktuara që në fillim. Roli i dhëndrit, nuses, bashkëshortit, nënës, babait, tezes, xhaxhait, gjyshit, gjyshes, nipit e mbesës mësohej duke u jetuar dhe duke shikuar shembujt e të tjerëve. Të gjitha këto e lehtësonin ndjeshëm jetën e secilit person. Edhe në marrëdhëniet me familjarët dhe rastet e ndryshme si dasma e fejesa, njerëzit dinin si të silleshin në bazë të kallëpeve të gatshme që ekzistonin.





Sigurisht që është e vështirë dhe e dhimbshme që të pranojmë se së bashku me ndryshimet në jetën familjare kanë tronditur edhe lidhjet e bazuara në këto themele. Familja bërthamë e vazhdon jetën e vet në një vend të ri dhe e udhëhequr nga vendimet e veta. Gjithsesi ajo e ka të pamundur që të vazhdojë ekzistencën e vet e pavarur nga traditat, sepse familja e madhe vazhdon të jetojë edhe pse me lidhje pak më elastike. Gjithsesi, edhe pse neve na vjen pak e rëndë, duhet ta pranojmë se njerëzit (në veçanti ato që jetojnë në qytet) po priren gjithnjë e më shumë drejt asaj që quhet familje bërthamë. Kjo familje pranohet si një përbërje e re që i merr vendimet në mënyrë të pavarur dhe që si gjatë momentit fillestar të formimit, ashtu edhe gjatë kohëzgjatjes së martesës, ec në rrugën e vendimeve personale.

Nëse do marrim parasysh të gjitha këto etapa kalimtare do të kuptojnë se, në mënyrë që familja bërthamë të ekzistojë në trajtë të pavarur, duhet që vazhdimisht të krijohet nga e para. Një nevojë e tillë bën që çiftet e reja që janë në fazat e para të krijimit të familjes të hasin vështirësi, probleme, ngatërresa, diskutime dhe mospërputhje mendimesh.

Këto probleme shfaqen në çdo fazë të martesës. Duke qenë se njerëzit nuk i binden më rregullave tradicionale që na paraqisnin kallëp të gatshëm, lehtësisht të kuptueshëm e të praktikueshëm, tani njerëzit përballen me surpriza dhe probleme që kërkojnë zgjidhje në çdo hap që hedhin, duke filluar me kërkimin i dorës së vajzës e duke vazhduar me fejesën e martesën. Bashkëshortët janë vazhdimisht në kërkim të një rruge të re.

Në ditët tona, edhe në rastet kur për zgjidhjen e këtyre problemeve njerëzit drejtohen drejt rregullave tradicionale, prejardhja nga krahina të ndryshme e eliminon këtë mundësi.

Bashkëshortët që janë të detyruar të lodhen për të gjetur rrugëzgjidhje për çdo problem që u del përpara, përballen me një situatë të vështirë. Nga ana tjetër, njerëzit pësojnë zhgënjime të mëdha

kur shikojnë se jeta reale nuk përputhet me idealet e tyre.

Në ditët e sotme martesë krijohet në bazat e vendimeve individuale të çiftit. Për këtë arsye, i jepet shumë rëndësi njohjes paraprake të kandidatëve për martesë. Por në të ardhmen kjo do të krijojë probleme të mëdha në familje. Palët që do të martohen e hedhin hapin e parë duke e njohur shumë mirë njëri-tjetrin, duke ndarë të njëjtat ideale dhe duke pasur pika të përbashkëta në pritshmëritë e tyre. Ndërkohë, me kalimin e kohës ato e shikojnë se idealet nuk realizohen dot dhe kjo gjë mund të sjellë shkatërrimin e ëndrrave. Në mes mendimeve të përbashkëta dhe kthimit të tyre në praktikë mund të ketë humnera të mëdha. Shumë probleme të thjeshta mund të jenë tronditëse dhe zhgënjyese për çiftet e reja. Këto mund të bëhen shkak që martesë të futet në krizë.

Të ndodhur në një situatë të tillë, çiftet e reja janë të detyruara që të gjejnë disa zgjidhje praktike të cilat nganjëherë kanë sukses e herë të tjera jo, duke e çuar çiftin drejt shpifjeve e ngatërresave. Madje, mund të lindin probleme që nuk kanë kthim pas. Këto mund të sjellin divorce e fatkeqësi familjare. Duhet theksuar fakti se çiftet e kanë të vështirë që të përpunojnë zgjidhjen e duhur për çdo problem që i del përpara. Por dihet që formimi i kallëpeve të reja të sjelljes për çdo hap që hedh është shumë i lodhshëm. Zvarritja e çifteve drejt kësaj përgjegjësie është një barrë e rëndë për to.

Mbase arsyet e hasura nga familja bërthamë bëjmë mirë që t'i kërkojmë këtu. Në veçanti numri i rritur i divorceve është një shenjë e qartë e kësaj. Duket hapur që modelet moderne të krijuara në vitet e fundit nuk mund të jenë aq të fuqishme sa modelet tradicionale. Tashmë çdo familje e re gjendet përpara një barre shumë të madhe, asaj të përgjegjësisë të fuqishme para çdo hapi të hedhur. Bashkëshortët e rinj mbështeten tek prindërit e tyre për ndihmë, ndërsa kur nuk e kanë një mundësi të tillë kanë vështirësi të papërkrahshme.

Kakaoja

e dobishme për kujtesën e humbur



Personat që hyjnë në të 50-at dhe 60-at e tyre kanë tendencë të fillojnë t'i humbin disa pjesë të kujtesës së tyre afatshkurtër, por komponentët që gjenden në mënyrë natyrale në kakao mund të ndihmojnë në kthimin prapa të kësaj dukurie.

Hulumtuesit nga Columbia University Medical Center ua kanë dhënë një pije testuese me përmbajtje të flavanolit të kakaos 37 vullnetarëve të shëndetshëm në mes të moshës 50 dhe 69-vjeçare.

Disa morën një dietë me përbërje të lartë të flavanolit dhe të tjerët morën një dietë me përbërje të ulët të flavanolit. Skanimi i trurit ishte bërë para dhe pas periudhës së provës, dhe studiuesit e gjetën një përmirësim të

dukshëm në rajonin dentate gyrus të trurit, i cili është i lidhur me llojin e humbjes së kujtesës që po e studionin.

Hulumtuesit thonë se ky lloj trajtimi nuk është menduar për njerëzit që vuajnë nga Alzheimeri, por për të rriturit e shëndetshëm pa ndonjë çrregullim të njohur të trurit përveç humbjes së zakonshme të kujtesës që ndërlidhet me moshën.

“Nëse një pjesëmarrës e kishte kujtesën e një 60-vjeçari tipik në fillim të studimit, pas tre muajsh ai person mesatarisht e kishte kujtesën e një 30- apo 40-vjeçari tipik,” tha dr. Scott A. Small, një nga studiuesit e përfshirë në studim.

Ai gjithashtu shtoi se një studim më i madh duhet të bëhet për t'i konfirmuar rezultatet, të cilat ekipi i tij po planifikon t'i bëjë. Hulumtimi i ri mund të gjendet në numrin e fundit të “Nature Neuroscience”.



Dobitë e ujit të detit

Jemi në fund të stinës së verës dhe mund ta themi me siguri se këto kohë plazhet janë frekuentuar në maksimum. Por a i njohim ne vlerat e ujit të detit në shëndetin tonë?

Uji i detit përmban 3,5% kripë, pra në një litër ujë deti gjenden të tretura 35 gramë kripë. Veç tyre, në ujin e detit ka dhe një sasi të vogël magnezi, sulfati dhe kalciumi. E vetmja gjë për të cilën nuk na ndihmon dot uji i detit, është hidratimi i trupit, por kjo është diçka shumë e vogël që mund të korrigjohet me konsumin e ujit normal, përpara gjithë përfitimeve që mund të kemi në shëndet.

Së pari, uji i detit pastron lëkurën tonë. Kripërat e tij nën rrezatimin e diellit bashkëpunojnë për pastrimin dhe rigjenerimin e lëkurës. Pikat e zeza në fytyrë, aknet, psoriasis e shumë gjendje të tjera patologjike, mund të eliminohen me ujin e detit.

Së dyti, ndihmon në forcimin e sistemit imun. Gjatë notit, rruazat e kuqe të gjakut rriten 5-20%, ndërsa ato të bardha akoma më tepër duke bërë të mundur forcimin e sistemit imun, sidomos në kushetet e diabetit, sëmundjeve me bazë imune, apo anemisë kur jemi ulje të rruazave të bardha të gjakut.

Së treti, uji i detit redukton ankthin dhe stresin. Duke qenë se përmban magnez, i cili ndihmon në qetësimin e nervave, gjithë personave që bëjnë një jetë stresuese, u rekomandohet të shkojnë në plazh për t'u qetësuar, në mënyrë që të mos marrin barna, të cilat normalisht kanë dhe efektet e tyre anësore.

Së katërti, uji i detit ndihmon në problemet me mushkëritë. Nëse vuani nga astma, kolla, apo nga probleme të tjera shëndetësore të lidhura me mushkëritë, bëni mirë të shkoni në det e të notoni, pasi

do ta menaxhoni mjaft mirë frymëmarrjen tuaj. Nga ana tjetër, prania e kripërave në det, ndihmon në largimin e toksinave dhe elementëve të tjerë që dëmtojnë mushkëritë.

Së pesti, pushimet në det ndihmojnë në normalizimin e problemeve me pagjumësinë dhe depresionin. Duke qenë se deti ndihmon në normalizimin e presionit të gjakut dhe në qetësimin e nervave, ai do t'ju ndihmojë edhe të flini më mirë dhe të përmirësoni humorin tuaj.

Pija ideale

për bark të sheshtë

Largimi i toksinave të dëmshme nga trupi është një funksion i përditshëm i mëlçisë. Kur këto toksina zënë vend në trupin tuaj, mëlçisë i duhet të punojë shumë më tepër për t'i eliminuar.

Ndryshimet në stilin e jetesës dhe zakonet e varfra të të ushqyerit kontribuojnë për të mbledhur toksina të dëmshme dhe trupi kërkon ndihmën dhe mbështetjen tonë për t'u detoksifikuar.

Ju mund ta filloni ditën duke bërë një pije detoks 100% natyrale, që do të eliminojë të gjithë toksinat nga trupi dhe do t'iu sigurojë ushqyesit esenciale që do të rrisin sistemin imunitar dhe metabolizmin.

Duke bërë kështu, trupi juaj do të shpërbëjë dhe do të përthithë më mirë ushqyesit nga ushqimi dhe si rezultat, ju nuk do të shtoni në peshë. Pija detoks do të largojë edhe dhjamen e grumbulluar në pjesën e barkut dhe që lidhet edhe me një sërë problemesh shëndetësore, si: sëmundje kardiovaskulare, diabeti i tipit II dhe presioni i lartë i gjakut.

Mund të provoni tani këtë recetë të bërë në shtëpi dhe të vëreni rezultatet.

Përbërësit

Limon – ½

Kastravec – 1

Xhenxhefil i grirë – 1 lugë çaji

Majdanoz-1 tufë

Ujë i pastër – 1/3 filxhan çaji

Përgatitja

Futini të gjithë përbërësit në një

procesor ushqimi ose blender dhe përziejini.

Sigurohuni që të arrini një përzierje homogjene të butë.

Piheni pijen e përgatitur përditë dhe pikërisht para se të shkoni të flini. Do të vëreni një reduktim të dukshëm të yndyrës në zonën e barkut dhe të belit brenda disa javësh pas një konsumimi të rregullt.





NASA LËSHON ME SUKSES SONDËN QË DO TË PREKË DIELLIN

Sonda diellore Parker, e para anije që do të përshkruajë kurorën e Diellit është lëshuar me shumë sukses 24 orë pas shkëputjes nga baza e Cabo Cañaveral (Florida). Misioni që pretendon të sqarojë misteret që fsheh ylli ynë dhe që është parashikuar që të mbërrijë në muajin nëntor filloi pas 4 përpjekjeve të lëshimit. Raketa Delta IV Heavy e shoqërisë “United Launch Alliance” u shkëput në orën 03.31 me orën lokale që nga baza ajrore e Cabo Cañaveral të Nasës me sondën në bord. Pak minuta nga lëshimi, raketa i shkëputi 3 shtytësit ashtu siç ishte parashikuar. Me parashikimet e motit të favorshme në 95 % dhe pasi zgjidhi problemet që ishin krijuar pas dështimeve të dy herëve të kaluara të lëshimit, Nasa riprogramoi dje fillimin e këtij misioni që ajo e konsideron historike. Sonda pretendon të mbledhë informacion sa më afër Diellit, atë që asnjë anije nuk e ka realizuar deri më tani. Në këtë mënyrë do të kontribuojë në zgjidhjen e çështjeve si ndryshimet e temperaturave të yllit tonë që variojnë nga mbi 15 milionë gradë në qendër dhe deri në 6000 gradë në fotosferë.

Pas shumë vitesh kërkimi ekipi arrit në përfundimin se sonda do të rezistojë ndaj një nxehtësie deri

500 herë nga ajo që u eksperimentua në tokë dhe në këtë mënyrë do të realizojë vëzhgime “in situ”. Bëhet fjalë për një mburojë termike që do të durojë temperatura deri në 1400 gradë dhe do t'i mbajë instrumentet në brendësi të anijes në temperaturë mjedisi deri në 30 gradë. Sonda ka përmasa të vogla 65 kilogramë dhe 3 m lartësi dhe do të mbërrijë në një distancë prej 6 milionë kilometra nga Dielli. Gjithashtu shpejtësia që do të arrijë sonda do të jetë 700 000 km në orë, shpejtësia maksimale që ka arritur deri më tani ndonjë anije e ndërtuar nga njeriu. Një shpejtësi që është e barabartë mes një udhëtimit nga Nju Jorku në Tokio në një minutë dhe që do t'i lejojë sondës të mbërrijë në Diell në nëntor. Sonda do të orbitojë 24 herë Diellin dhe do t'i afrohet gradualisht atij me ndihmën e gravitetit të Afërditës, do të mbërrijë në pikën më të afërt me Diellin në vitin 2025, kur do mundet të mbledhë informacion më me vlerë. Projekti ka kushtuar rreth 1,5 miliardë dollarë do mbajë për herë të parë emrin e një njeriu në jetë, atë të fizikanit amerikan, Eugene Parker, 91 vjeç, i cili zhvilloi në vitet 50 të shekullit të kaluar teorinë e erës diellore.

E KONFIRMUAR: TELEFONI DËMTON SYTË TUAJ!

Nëse shqetësoheni se përdorimi i telefonit të mençur dhe i tabletit mund të jetë i keq për shëndetin tuaj, Men's Health ka një lajm të keq për ju: është definitivisht i dëmshëm.

Hulumtimi i kryer nga Universiteti i Toledos ka zbuluar se drita blu e çliruar nga pajisja juaj shkakton degradim makular dhe mund të përshpejtojë fillimin e verbërisë.

Hulumtimi në mënyrë specifike tregon se ekspozimi i zgjeruar ndaj dritës blu të liruar nga celulari juaj kthen molekulat në retinë e syrit në vrasës qelizor dhe helmues. Procesi pastaj çon në degradimin e makulës së syrit, një nga shkaqet më të mëdha të verbërisë në Amerikë.

Degradimi makular është shkaktohet fotoreceptore që vdesin. Ekspozimi ndaj dritës blu shkakton që retina të sillet ndryshe, duke shkaktuar molekula helmuese. Megjithatë, rezultati i njëjtë nuk ndodh kur kaloni te drita e verdhë, e gjelbër ose e kuqe.

Ndërkohë, mjekët e përfshirë në studim thonë

se për të zbutur efektet e dritës blu duhet të bëni thirrjen e nevojshme dhe të shmangni përdorimin e telefonit tuaj në errësirë. Në krye të kësaj, duhet mbajtur syze dielli që filtrojnë rrezet UV dhe dritën blu kur të jeni jashtë.

Përveç kësaj, kompanitë e telefonive celulare kanë filluar të futin një filtër të dritës blu në ekranet e tyre. Nëse telefoni juaj ka një, ju sugjerojmë ta aktivizoni atë.





SHPEJTËSI REKORD NË GARËN PËR HYPERLOOP

Një tren futurist që udhëton në një tunel special dhe përshkruan distancën nga qyteti Los Angeles për në San Françisko brenda 30 minutash... Kjo ishte ëndrra pesë vite më parë e Elon Musk, themeluesit të kompanisë SpaceX. Me kalimin e viteve, ëndrra e tij po i afrohet realitetit. Para disa ditësh në Los Angeles u zhvillua gara e tretë vjetore për mjetin që do të përdorë tunelin që quhet Hyperloop. Në këtë garë u shënuar një rekord tjetër shpejtësie.

467 kilometra në orë, ky është rekordi i ri i shpejtësisë nga ekipi gjerman WARR Hyperloop, i përbërë nga studentë të inxhinierisë. Kjo ishte gara e tretë vjetore që zhvillohet në qytetin Los Angeles. Më shumë se 600 ekipe nga e gjithë bota morën pjesë në gara. 20 prej tyre arritën finalen ndërsa vetëm tre ishin aq të shpejta, sa të provonin mjetet e tyre në një tunel special mbi 1 kilometër të gjatë. Kriteri kryesor ishte shpejtësia në tunelin me presion të kontrolluar. Florian Janke është përfaqësues i ekipit gjerman WARR Hyperloop.

“Provuam modele të ndryshme, një motor të madh, dy motorë të mëdhenj në të njëjtën shasi, që ishin ide të mira. Përfundimisht zgjodhëm motorë të vegjël që kanë raport të mirë mes fuqisë dhe peshës. Simulimi na tregoi se ky do të ishte varianti më i mirë.”

Inxhinierët thonë se u përballën me vështirësi të papritura, siç ishin pjesët elektronike që nuk ishin të përshtatshme për tunelin me presion të kontrolluar. Antoine Coppens është me ekipin EPFLOOP.

“Përdorëm bateri të tipit D dhe i përshtatëm së bashku në një kuti mbajtëse në një strukturë të bërë me printim 3D që e rrethon kutinë dhe bëmë të gjitha provat e efektshmërisë. Kjo të jep qëndrueshmëri sepse kur bateritë ekspozohen në mjedise me presion, mund të zgjerohen dhe rrezikojnë të shpërthejnë, apo të marrin zjarr. Ndaj kur i mban brenda një foleje, sigurohesh që kjo të mos ndodhë.”

Por ky nuk është i vetmi problem që duan të zgjidhin inxhinierët. Një ekip nga Holanda thotë se një sistem i plotë transporti me hyperloop do të eliminonte fluturimet e shkurtra, si dhe dëmet që i shkaktohen mjedisit. Jelle Van Der Zon është me ekipin Delft Hyperloop.

“Këto mangësi ndikojnë tek fluturimet në distanca të shkurtëra deri në 1 mijë e 500 kilometra. Ne mendojmë se duhet rritur cilësia e transportit, pra do të përdoret sistemi me hyperloop. Mund të lidhim distancat prej 500 kilometrash si Amsterdamin, Brukselin, Parisin apo Berlinin.”

Shefi i kompanisë SpaceX dhe sponsorizues i hyperloop, Elon Musk, thotë se gara është për të thyer kufijtë.

“Gara është për të nxitur njerëzit që të mendojnë për modele të reja transporti, që do të transformojnë rrënjësisht qytetet dhe lëvizjen. Besoj se do të ketë përmirësime rrënjësore.”

Gara e këtij viti tregoi se inxhinierët janë gjithnjë e më pranë kësaj zgjidhjeje.

SAMSUNG: SË SHPEJTI ME EKRANE OLED TË PATHYESHËM.

“Samsung” po vjen me një ndryshim të rëndësishëm sa i takon telefonave. Mësohet se kompania në fjalë po zhvillon një telefon me ekran të pathyeshëm.

Telefoni ka marrë certifikimin e Underwriters Laboratories, që do të thotë se është gati për t'u hedhur në treg. Me telefonat e rinj me ekran të pathyeshëm “Samsung” pritet të zgjerojë tregjet e shitjeve, drejt automobilitave, pajisjeve ushtarake të lëvizshme, lojërave etj.

Ndryshimi i madh në ekranet e telefonave vjen

pasi konsumatorët detyrohen shpesh të ndërrojnë ekranet. Në tremujorin e katërt, shitjet e përgjithshme të njësive të telefonave ranë për herë të parë ndonjëherë, sipas Gartner.

Paneli fleksibël OLED është ndërtuar me një bazë substrate të pathyeshme, tha “Samsung”. Ekranet fleksibël mund të shkatërrohen vetëm kur pësojnë një goditje tepër të rëndë. Mësohet se telefonat e rinj u janë nënshtruar testeve të shumta, si hedhjes dhjetëra herë nga një lartësi deri në 1.2 metra.



KOPSHTI

Aromë Trëndafili



KOPSHTI
“Aromë Trëndafili”!



**Kushte bashkëkohore,
ushqim cilësor dhe i kontrolluar,
staf i kualifikuar, çmime të arsyeshme,
transporti është i garantuar.**

Ju mirëpresim!



1 Staf arsimor cilësor

2 Kushte arsimore sipas standarteve të larta

3 Aktivitete sociale, kulturore dhe sportive

4 Klasa dhe laboratorë të kompletuar

5 Ambiente familjare në konvikt dhe cilësi në ushqim



CIKLI FILLOR

(djem dhe vajza)

NGA KLASA E **1**-RË
DERI NË KLASËN E **5**-TË

“O Zoti ynë! Mos lejo
që zemrat tona
të shmangen
(nga e vërteta),
pasi na ke udhëzuar
në rrugën e drejtë,
dhe jepna mëshirë
prej Teje;
vërtet, Ti je
Dhuruesi i Madh!

(Âl Imran, 8)

